Bilancet vjetore mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti dhe duhet t'i paraqiten Asamblese se zakonshme brenda 31 marsit te vitit pasardhes.


Neni 12

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Asamblea e zakonshme e Ortakeve:

- a) miraton bilancin vjetor;
- b) emeron Drejtoret ose Drejtorin e vetem;
- c) emeron kyetarin e Bordit dhe nese eshte e domosdoshme dhe zevendes kryetarin;
- d) percakton pergjegjesite e Drejtorit;
- e) per shperblimin e Drejtoreve.

Asamblea e zakonshme e Ortakeve thirret nga Drejtori i vetem se paku nje here ne vit me thirrje me shkrim e cila duhet te dergohet te pakten 30 dite perpara me poste, secilit Ortak qe rezulton i rregjistruar ne Librin e Ortakeve te pakten 5 dite perpara dites se komunikimit te thirrjes.



Ne mungese te formaliteteve te mesiperme, Mbledhja e Zakonshme e Asamblese do te konsiderohet si e vlefshme vetem nese ne te do te perfaqesohet i tere kapitali themeltar.

Asamblea e zakonshme e Ortakeve eshte e vlefshme nga ana konstituive me pranine e Ortakeve qe perfaqesojne se paku gjysmen e kapitalit themeltar.

Ajo vendos ne mbledhjen e pare dhe te dyte me shumicen absolute te kapitalit themeltar.

Secili ortak ka te drejten e nje vote per cdo kuote (pjese) qe posedon. Ortaket mund te perfaqesohen nga perfaqesuesit e tyre ligjore ose nga persona te tjere, qe nuk eshte e detyrueshme te jete ortake, neprmjet nje prokure te shkruar per mbledhjen perkatese, persa kohe qe perfaqesuesi i ortakut nuk eshte Drejtori i Pergjithshem, Zevendesit e tij, Kryetari i Bordit Drejtues, Drejtori ose ndonje i punesuar i shoqerise.

Kryesues i Asamblese se Zakonshme eshte kryetari i Bordit Drejtues. Kryetari do te emroje nje sekretare qe mund te mos jete ortake.

Proces-verbali i Asamblese se zakonshme do hartohet nga sekretari dhe kunderfirmoset nga Kryetari.

Rezolutat e miratuara nga Asambleja e Zakonshme jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, edhe per ata qe mungonin ose qe nuk ishin dakort.

Neni 13

ASAMBLEA E JASHTEZAKONSHME


Asamblea e jashtzakonshme e Ortakeve vendos :

- a) per ndryshimin e Kontrates dhe Statutit;
- b) per zmadhimin ose pakesimin e kapitalit ;
- c) per prishjen e shoqerise;
- d) emrimin dhe kompetencat e likuidatoreve;
- e) çeshtje te tjera qe ligji shqiptar mbi shoqerite i percakton si kompetence ekskluzive te Mbledhjes se jashtezakonshme.

Asamblea e jashtzakonshme duhet te thirret ne çdo kohe qe kerkohet, me lajmerim me shkrim te pakten 30 dite para me leter secilit ortak, qe eshte rregjistruar ne librin e Ortakeve, te pakten 5 dite para marrjes se vendimit per thirrjen.

Ky Lajmerim duhet te dergohet ne adresen e treguar ne Librin e Ortakeve.

Asamblea e Jashtezakonshme e Ortakeve ka vlere konstituive dhe vendos me shumice votash prej se paku 3/4 te kapitalit themeltar ne favor te rezolutes.



Çdo Ortak ka te drejten e nje vote per cdo pjese qe posedon. Ortaket mund te perfaqesohen nga persona te trete, qofte edhe jo ortake me prokure me shkrim, per gjithë rastet

kur personi qe perfaqesohet nuk eshte Drejtori i Pergjithshem, zvdrejtori i Pergjithshem, Kryetar i Bordit Drejtues, Drejtor apo nepunes i Shoqerise.

Kryesues i Asamblese se jashtezakonshme eshte Kryetari i Bordit Drejtues ose Drejtori i vetem. Kryetari do te caktoje nje sekretare qe mund te mos jete ortake.

Proces-verbali i Asamblese se jashtezakonshme do te redaktohet nga sekretari dhe kundefirmoset nga Kryetari ose nga Drejtori i vetem.

Rezolutat e Mbledhjes se Jashtezakonshme mund gjithashtu te miratohen nepermjet konsultimit me shkrim te ortakeve, nese ortaket japin pelqimin e tyre me shkrim.

Rezolutat e aprovuara nga Mbledhja e Jashtezakonshme jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, edhe ata ne mungese dhe ne kundersiztim.

Neni 14

PROCES-VERBALET

Mbledhjet si te Asamblese se Zakonshme ashtu edhe asaj te jashtezakonshme duhet te permbledhen ne proces verbalet perkatese.

Vendimet e Asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme te marra ne perputhje me ligjin shqiptar dhe kete statut jane te detyrueshme per te gjithë Ortaket, edhe per ata qe mungojne apo nuk jane dakort.

Proces verbalet e Mbledhjes se Asamblese mbahen nga sekretarja, e caktuar nga Kryetari i mbledhjes, dhe firmosen prej Kryetarit te Mbledhjes.

Neni 15

LAJMERIMI PER THIRRJE

Asambleja e zakonshme apo e jashtezakonshme e ortakeve mund te thirret edhe me faks derguar secilit Ortak, me kusht qe, ne te njejten kohe (ne te njejten dite ose te nesermen) t'ju dergohet thirrja zyrtare me leter rekomande me pergjigje.



Lajmerimi i thirrjes duhet te permbaje:

- a) daten dhe oren e thirrjes, shprehur me numra dhe germa.
- b) vendin e thirrjes shprehur i plote.
- c) rendin e dites ku te specifikohen ceshtje te shenuara me numer rendor.

Ne mungese te formaliteteve te siperpermendura, lajmerimi eshte i pavlefshem.

Neni 16

BORDI DREJTUES

Shoqeria administrohet nga nje Drejtor i vetem, Zt. Francesco Cesarini. Ne çdo rast eshte kompetence e Mbledhjes se zakonshme te Asamblese te zgjedhe Bordin Drejtues.

Bordi drejtues do te perbehej prej njue minimumi prej 3 anetaresh dhe nje maksimumi prej 5 anetaresh. Drejtoret nuk eshte e domosdoshme qe te jene ortake. Emerimi i tyre behet per nje periudhe prej 3 - vjetesh te rinovueshme.

Bordi Drejtues ose Drejtori i vetem, do te mbildhen aq here sa Kryetari ta shohe te domosdoshme dhe sa here qe te kerkohet nga Drejtori i Shoqerise.

Bordi Drejtues ose Drejtori i vetem, do te emeroje, per çdo mbledhje, nje Sekretar qe nuk eshte e domosdoshme te jete anetar i Bordit.

Proces-verbalet e mbledhjes se Bordit Drejtues do te hidhen ne nje liber perkates te vecante dhe do te jene te vlefshem nese jane nenshkruar nga Kryetari dhe sekretari.

Per vlefshmerine e vendimeve te Bordit Drejtues eshte e nevojshme vota shumices se Drejtoreve qe marrin pjese ne mbledhje.

Ne rast doreheqjeje, vdekje apo revokim te nje ose me shume Drejtoresh, keta do te zevendesohen me vendim te Bordit Drejtues ose te Drejtorit te vetem. Zevendesuesit mbeten ne detyre deri ne mbledhjen me te aferme te Asamblese.

Man

NOTI
BIRANE

Bordi Drejtues, ose Drejtori i vetem, kane kompetencat e zakonshme dhe te jashtezakonshme te manaxhimit pervec kompetencave te parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te ketij statuti, qe jane ekskluzivitete te Asamblese se Zakonshme dhe te Jashtezakonshme.

Çdo anetar i Bordit ka nje vote.

Neni 17

KRYETARI

Kryetari i Bordit Drejtues eshte anetar i Bordit Drejtues ose Drejtor i vetem.

Kryetari i Bordit ose Drejtori i vetem zbaton vendimet e mara nga Bordi Drejtues, ose nga Drejtori i vetem, dhe nga Mbledhja e Asamblese.

Ai eshte i emeruar per nje periudhe 3-vjeçare te rinovueshme.


Kryetari ka te drejten e firmes ne Shoqeri, ai do te perfagesoje ligjerisht shoqerine me te tretet dhe organizon aktivitetin e Bordit Drejtues.

Kryetari ka te drejten te delegoje nje pjese te kompetencave te tij, qe lidhen me nje veprim te vetem ose nje sere veprimesh, nje ose me shume perfagesuesve ose Drejtorit te Pergjithshem.

Kryetari ka gjithashtu te drejte te delegoje, nje ose me shume perfagesuesve ligjore, bashkarisht ose veç e veç, pushtete lidhur me firmat e shoqerise. Keto kompetenca do te delegohen me reference te veçante per nje verpim ose nje kategori veprimesh.

Perfagesues te tille do te jene pergjegjes per tejkalimin e funksioneve dhe kompetencave te deleguara atyre.

Ne kete rast perfagesues dhe administrator unik i shoqerise eshte Zt. Cesarini Francesco, shtetas italian, lindur ne Petrela Salto (Rimini), me 12.08.1959, rezident ne Via Belsito N.15 Fiumata (Rimini) Itali.




Neni 18
Drejtori i Pergjithshem

Aktiviteti ekzekutiv i shoqerise drejtohet nga drejtori i pergjithshem, i cili do te emerohet nga Bordi Drejtues dhe qe perfaqeson organin ekzekutiv te shoqerise.
Drejtori i pergjithshem ka kompetence qe:

- a) te zbatoje vendimet e Asamblese, Bordit apo Drejtorit te vetem;
- b) te organizoje dhe programoje punen me qellim qe te realizoje qellimin e aktivitetit te Shoqerise, duke dhene llogari perpara Bordit;
- c) te administroje pasurite dhe pronat e shoqerise, duke perfshire burimet financiare, ne perputhje me vendimet e Bordit Drejtues ose te Drejtorit te vetem;
- d) te manaxhoje dhe kontrolloje aktivitetin e degeve dhe te agjensive te shoqerise;
- e) perfaqeson shoqerine, me nje delegim te veçante te Bordit apo Drejtorit te vetem, perpara Autoritete gjyqesore e arbitrazheve si edhe paleve te treta, si edhe ndaj institucioneve dhe autoriteteve shqiptare dhe te huaja;
- f) i delegon paleve te treta, te caktuar si perfaqesues, nje pjese te kompetencave te tij, me reference te veçante per nje veprim te vetem ose nje sere veprimesh te nje kategorie. Perfaqesues te tille do te jene pergjegjes per tejkalm te funksioneve dhe kompetencave qe i jane deleguar;
- g) te ekzekutoje , ne emer e per llogari te shoqerise, kontratat e te gjitha llojeve;
- h) te beje çdo pagese ne emr te shoqerise, te punesoje ose te pushoje nga puna te punesuarit me perjashtim te manaxhereve, dhe te firmose kontratat perkatese. Drejtori i Pergjithshem eshte i lejuar te beje pagesa dhe te angazhoje pasuri deri ne nje vlere maksimale te caktuar nga Bordi drejtues ose Drejtori i vetem.

Neni 19
Prishja e shoqerise

Shoqeria do te mbyllet ne rast se:

- a) kalon koha e kohezgjatjes se saj;
 - b) kur Shoqeria eshte e pamundur per te realizuar objektin e saj;
 - c) me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te asamblese.
- 



**Neni 20
Likuidimi**

Likuidimi i shoqerise do te behet ne perputhje me Ligjet perkatese shqiptare qe jane ne fuqi ne kohen e likuidimit.

Mbledhja e jashtezakonshme do te percaktoje termat teknike te likuidimit dhe do te emeroje likuidatoren, te cilet nuk kerkohet te jene ortakë, duke percaktuar edhe kompetencat dhe shperblimin e tyre.

PER DI VINCENZO ESTERO S.r.l

**PERFAQESUESI
FRANCESCO CESARINI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTER

Nr.....*9202* *Rep.*

3246 *loel.*

V E R T E T I M

Sot, me date *20.12.85* paraqit perpara meje noteres Z. Francesco Cesarini, shtetas italian, lindur dhe rezident ne Itali, dtl. 1959, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i tij, dhe me deklaroi se sa me siper eshte nje statut i shoqerise " Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.k", firmosur prej tij si perfaqesues i ortakut te vetem, dhe une noterja e gjej ate te rregullt dhe e vertetoj.



STATUT

13264

Neni 1

Forma ligjore dhe emri i shoqerise

" Dv- Focus " Sh.p.k (Shoqeria) ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria eshte person juridik nen ligjet e Republikes se Shqiperise dhe kryen aktivitetin e saj ne perputhje me legjilacionin shqiptar, aktin e themelimit dhe kete statut.

Neni 2

Objekti i shoqerise

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e projektimit dhe ndertimit te konstruksioneve, perfshire dhe qendren tregtare te ndodhur ne Tirane, Republika e Shqiperise ne perputhje me licencen e ndertimit per World Trade Center (WTC Tirana); mbikqyrjen e aktiviteve ndertuese te mesiperme; manaxhimin e çdo ndertese te projektuar dhe/ose ndertuar nga Shoqeria; blerjen, shitjen, dhenien me qira dhe manaxhimin e pasurve te paluajtshme. Shoqeria gjithashtu do te kryeje ne Republikën e Shqiperise, direkt dhe indirekt, aktivitete qe lidhen me projektimin, ndertimin dhe manaxhimin e komplekseve turistike.

Kompania gjithashtu do te kryeje te gjitha ato aktivitete qe jane te domosdoshme per realizimin e objektit te siperpermendur.

Gjithashtu, Shoqeria do te manaxhoje dhe do te kete pjesemarrje ne aktivitete te tjera perveç atyre te perfshira ne paragrafin e pare te ketij neni (neni 2), si direkt ashtu edhe indirekt, dhe do te kryeje investime te çdo tipi ne Shqiperi. Shoqeria ka kompetence edhe te hyje ne joint - venture me partnere Shqipatre dhe /ose te huaj, duke siguruar qe çdo aktivitet i tille nuk bie ndesh me ndonje ligj ne Shqiperi.

Brenda qellimit te ketij statuti, Shoqeria ka kompetence te kryeje, direkt ose indirekt, te gjitha operacionet tregtare, industriale dhe financiare lidhur me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme, qe shihen si te nevojshme per te plotesuar, direkt ose indirekt, projektin e siperpermendur; per kete qellim Shoqeria ka kompetence te krijojë dege ne Republikën e Shqiperise dhe jashte saj dhe njekohesisht te kete pjesemarrje, direkte ose indirekte, interesa, ne shoqeri tregtare, fondacione, shoqata, nderrmarje, joint - vneture shqiptare ose te huaja dhe me partnere shqiptare ose te huaj.

Neni 3

Qendra e shoqerise dhe adresat e ortakeve

Qendra e shoqerise eshte ne Tirane (Republika e Shqiperise) Tirana Trade Center, Rruga e Duresit, Nr. 34.

Shoqeria, me vendim te Bordit te Drejtoreve, ka te drejten te krijojë, transferojë dhe/ose te mbyllë zyra administrative, qendren, dege, zyra perfaqesimi, agjensi, ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

Adresat e ortakeve, ne lidhje me Shoqerine , jane ato te treguara ne Librin e Ortakeve.



Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise eshte 100 vjet. Ortaket kane kompetnce te shtyjne ate dhe te vendosin per mbylljen e shoqerise.

Neni 5

Pergjegjesia e shoqerise

Shoqeria nuk mund te jete pergjegjese per detyrimet e ortakeve.

Neni 6

Libri i Ortakeve

Çdo blerje e titullit te nje ose me shume kuotave te shoqerise duhet te shoqerohet me rregjistrim perkates ne Librin e Ortakeve. Deri ne momentin qe do te behet ky rregjistrim bleresi nuk do te konsiderohet si ortak.

Çdo rregjistrim ne Librin e Ortakeve duhet te tregojë emrin e bleresit, sasine e kuotave dhe aktin e blerjes.

Libri mbahet nga Sekretarja e Shoqerise, e cila duhet ti leshojë kopje çdo ortaku qe e kerkon.

Çdo hyrje ne liber rregjistrohet dhe firmoset nga Kryetari i Bordit Drejtues, pas paraqitjes nga bleresi te aktit qe deshmon pronesine mbi kuotat.

Ne vijim te formaliteteve te mesiperme, çdo ortak duhet te beje rregjistrim e tij edhe ne dosjen e shoqerise prane Rregjistrimit Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, duke pasqyruar

sasine e kuotave qe ai mban ne shoqeri, dhe duke depozituar nje kopje te dokumentit qe evidenton titullin e tij. E njejta procedure do te ndiqet ne lidhje me egzistencen e ndonje pengu mbi kuotat e Shoqerise.

Neni 7

Kapitali Social

Kapitali social i shoqerise eshte dyzete e tete milion e njeqind e dyzete e tete mije lek (48.148.000) i ndare ne 48.148 kuota nga 1000 lek secila.

Neni 8

Transferimi i kuotave

Kushdo qe do te transferoje, per çfare do arsye, çdo kuote e shoqerise qe eshte ne zoterim te tij (te transferuesit) do te njoftoje per kete ortaket e tjere te Shoqerise, me lajmerim rekomande, duke njoftuar emrin e blesesit te mundshem dhe çmimin e rene dakort (Njoftim Transferimi).

Çdo ortak qe merr nje njoftim transferimi duhet te njoftoje pranimin ose refuzimin e tij per transferimin e kuotave, me njoftim rekomande derguar Transferuesit jo me vonë se 30 (tridhjetë) dite pas dates se marrjes se Njoftimit te Transferimit.

Nese ndonje ortak qe e ka marre Njoftimin e Transferimit nuk arrin te njoftoje pranimin ose refuzimin e tij brenda 30 (tridhjetë) ditesh, atehere pelqimi do te konsiderohet i dhene, me kusht qe blesesi te pranoje me shkrim Statutin, Marreveshjen e Joint - Ventures midis Penang Shipbuilding & Construction dhe Di Vincenzo Estero S.r.l lidhur me 29.11.1996, dhe çdo marreveshje tjeter te metejshme te lidhur me ndertimin dhe projektimin e WTC Tirana.

Parashikimet e mesiperme nuk zbatohen nese:

- i) transferimi behet nga njeri ortak tek tjetri; dhe
- ii) transferimi i kuotave behet nga nje ortak i shoqerise tek Business Focus Group dhe/ose IGEFI Group (dhe çdo shoqeri qe kontrollohet direkt ose indirekt respektisht nga Business Focus SDN BDH nga Kuala Lumpur, Malezia dhe IGEFI S.r.l nga S. Giovanni Teationo (CH) Itali), duke siguruar qe ortaku transferues merr persiper te riblejje kuotat e transferuara ne rastin e prishjes te shoqerise blesese ose ne rast se transferuesi humb interesin e tij tek blesesi dhe /ose blesesi humb interesin e tij tek transferuesi.

Transferimi i kuotave nuk mund te behet, kur transferuesit i eshte bere njoftimi i refuzimit, ne perputhje me kushtet e permendura me lart.

Neni 9

Rregjistrimet kontabel

Operacionet kontabel kryhen nga Shoqeria ne perputhje me ligjin mbi kontabilitetin dhe ligjet e tjera te Republikes se Shqiperise dhe do te pasqyrohen besnikerisht ne bilanc.

Neni 10

Operacionet financiare

Shoqeria ka kompetence te marre financime dhe kredi nga çdo banke apo institucion shqiptar ose i huaj ose nderkombetar, shoqeri e trete ose nga ortakët e saj.

Neni 11

Fondi rezerve dhe dokumentat financiare

Shoqeria ke kompetence te krijoje nje fond rezerve dhe fonde te tjera te veçanta.

Perberja, sasia, burimi i fondeve, perdorimi dhe rregullimi i secilit fond do te percaktohet nga Bordi Drejtues ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

Pasurite e Shoqerise pasqyrohen ne bilanc duke pasqyruar vlerat e shprehura ne monedhen shqiptare dhe ne \$ US amerikan.

Bilanci dhe pasqyrimi i humbjeve dhe fitimeve te Shoqerise do te pergatiten nga Bordi Drejtues ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise

Viti financiar mbyllet me 31 Dhjetor te vitit ne vazhdim, dhe do te dergohet ne Mbledhjen e Asamblese se Zkonshme me 31 Mars te vitit ne vazhdim ose ne nje date te mevonshme qe Bordi i Drejtoreve do te percaktoje ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

Neni 12

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese

Mbledhja e zakonshme e asamblese:

- a) aprovon bilancin vjetor te pergatitur nga Bordi i Drejtoreve;
- b) emeron anetaret e Bordit te Drejtoreve;
- c) emeron kryetarin e Bordit te Drejtoreve dhe dhe zevendes kryetarin nese eshte e nevojeshme;
- d) percakton pergjegjesite e anetareve te Bordit te Drejtoreve;

e) vendos per shperblimet e anetareve te Bordit te Drejtoreve.

Asambleja e Zakonshme thirret nga Kryetari i Keshillit Administrativ, ose Drejtori i Vetem, te pakten nje here ne vit, me njoftim me shkrim te pakten 21 - dite perpara dates se mbledhjes, ortakeve te cilet jane te rregjistruar ne Librin e Ortakeve te pakten 30 - dite perpara dates se fiksuar per mbledhje.

Ky lajmerim do te dergohet ne adresen e ortakeve te treguar ne Librin e Ortakeve.

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Ortakeve konsiderohet e vlefshme kur ne te perfaqesohet te pakten 1/2 e kapitalit social dhe merr vendime te vlefshme kur keto miratohen nga shumica e kapitalit te perfaqesuar ne mbledhje.

Ne mungese te formaliteteve te mesiperme mbledhja do te konsiderohet e vlefshme nese i tere kapitali social perfaqesohet ne mbledhje.

Çdo vendim i marre ne mbledhjen e pare apo te dyte aprovohet me shumice absolute te kapitalit social.

Çdo aksion te jep te drejten e nje vote. Ortaket kane te drejte te perfaqesohen nga perfaqesuesit e tyre te ligjshem ose nga çdo person qe nuk eshte e domosdoshme te jete ortak, nepermjet nje prokure ne forme te shkruar per mbledhjen konkrete.

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese drejtohet nga Kryetari i Bordit te Drejtoreve. Kryetari emerion nje sekretare qe nuk eshte e domosdoshme te jete ortak.

Verbalet e mbledhjes firmosen nga sekretarja dhe kryetari.

Vendimet e Asamblese jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, per ata qe kane qene prezent dhe ata qe nuk kane qene.

Neni 13

Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e Jashtezakonshme vendos per keto probleme:

- a) amendamentet e kontrates dhe statutit;
- b) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit;
- c) prishja e shoqerise;
- d) emerimi dhe kompetencat e likuidatoreve;
- e) probleme te tjera te cilat ligjet ne Republiken e Shqiperise ja njohin si ekskluzive asamblese se jashtezakonshme.

Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme behet sa here eshte e nevojshme, duke lajmeruar ne forme te shkruar te pakten 21 - dite perpara dates se fiksuar per mbledhje,

ortakeve te cilet jane rregjistruar ne Librin e Ortakeve te pakten 30 dite perpara dates se fiksuar per mbledhje.

Ky njoftim duhet te dergohet ne adresen e treguar ne Librin e Ortakeve.

Mbledhja konsiderohet e vlefshme kur ne te perfaqesohet te pakten 1/2 e kapitalit social dhe merr vendime te vlefshme kur keto aprovohen nga shumica e kapitalit te pjesemarres ne mbledhje.

Çdo aksion te jep te drejten e nje vote. Ortaket mund te perfaqesohen nga çdo person, i cili nuk eshte e domosdoshme te jete ortak, nepermjet nje prokure te shkruar per mbledhjen perkatese.

Kryetari i Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme eshte Kryetari i Bordit te Drejtoreve. Kryetari emerohet nje sekretare e cila mund te mos jete ortak.

Proces verbalet e mbledhjes se jashtezakonshme mbahen nga sekretarja dhe firmosen prej saj dhe kryetarit.

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim te ortakeve, kur ortaket japin miratimin me shkrim.

Vendimet e marra nga Mbledhja e Jashtezakonshme jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, si ata qe jane prezente dhe ata qe nuk jane.

Neni 14

Proces verbalet

Mbledhja e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Asamblese se Ortakeve do te pasqyrohet ne proces verbalet perkatese.

Vendimet e marra ne Asamblese e Zakonshme ose te Jashtezakonshme, ne perputhje me ligjet ne Republiken e Shqiperise dhe kete statut, jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, prezente ose jo ne mbledhje.

Proces verbalet e mbledhjes se zakonshme ose te jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve mbahen nga sekretarja e emeruar nga Kryetari i Mbledhjes, dhe firmosen prej saj dhe Kryetarit.

Neni 15

Thirrja e Mbledhjes

Asambleja e Zakonshme ose e Jashtezakonshme mund te thirren edhe me faks derguar te gjithë ortakeve, por duke derguar njekohesisht kete njoftim edhe me leter rekomande, jo me vone se nje dite me pas.

Njoftimi i thirrjes duhet te permbaje:

- a) kohen dhe daten e mbledhjes, te shprehur ne numra dhe fjale;
- b) vendin e mbledhjes, te shprehur ne menyre te plote;
- c) problemet qe do te jene ne rendin e dites, duke i specifikuar dhe shoqeruar me numer rendor.

Njoftimi do te jete ne anglisht.

Ne rast te mosperputhjes me ndonje nga formalitet e siperpermendura, njoftimi eshte i pavlefshem. Pamvaresisht nga kjo, Mbledhja do te konsiderohet e vlefshme nese ne te perfaqesohet i tere kapitali social.


Neni 16
Bordi Drejtoreve

Shoqeria do te administrohet nga Bordi i Drejtoreve. Anetaret e Bordit do te emerohen nga Mbledhja e Zakonshme e Asamblese. Bordi i Drejtoreve do te perbehet nga 6(gjashte) persona.

Drejtoret mund te mos jene ortake. Mandati i tyre vazhdon per 3-vjet dhe eshte i rinovueshem.

Bordi Drejtoreve do te mblidhet sa here qe Kryetari do ta quaje te nevojshme dhe sa here qe do te kerkohet nga ndonje nga Drejtoret.

Bordi Drejtues do te caktojte nje sekretare, per çdo mbledhje, e cila mund te mos jete anetare e Bordit.

Proces verbalet e Bordit do te mbahen ne nje liber te veçante dhe do te jene te vlefshme vetem nese firmosen nga sekretarja dhe Kryetari.

Mbledhja e Bordit te Drejtoreve konsiderohet e vlefshme kur ne te marrin pjese te pakten tre Drejtore dhe vendimet konsiderohen te vlefshme kur merren me shumice te votave te Drejtoreve qe marrin pjese ne mbledhje.

Ne rast doreheqjeje, vdekje, ose revokim te nje ose me shume anetareve, ata do te zevendesohen me vendim te Bordit te Drejtoreve. Zevendesuesit mbeten ne detyre deri ne mbledhjen me te afert te asamblese.

Keshilli Administrativ ka te gjitha kompetencat e zakonshme dhe te jashtezakonshme te manaxhimit perveç atyre qe neni 12 dhe 13 ia njeh Asamblese se Zakonshme.

Çdo anetar i Keshillit ka nje vote.

Neni 17

Kryetari i Bordit te Drejtoreve

Kryetari i Bordit te Drejtoreve eshte anetar i tij.

Ai zbaton vendimet e marra nga Bordi dhe Asambleja e Zakonshme dhe e Jashtezakonshme. Ai zgjidhet per 3 - vjet, te rinovueshme.

Kryetari ka te drejten e firmes se shoqerise., ai eshte perfaqesuesi ligjor i saj ndaj te treteve dhe organizon aktivitetin e Bordit te Drejtoreve.

Kryetari, ne lidhje me veprime te vecanta ose kategori veprimesh, ka kompetence te deleguara pjese te kompetencave te tij, perfshire edhe kompetencen per te perfaqesuar Shoqerine, Drejtoreve te Manaxhimit te Perbashket.

Kryetari ka gjithashtu kompetence ti deleguara Drejtoreve te Manaxhimit te Perbashket kompetencat lidhur me firmen e Shoqerise. Keto kompetenca do te delegohen me referim specifik per veprime te vecanta ose kategori veprimesh dhe do te ushtrohen bashkarisht nga Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket.

Keta Drejtore te Manaxhimit te Perbashket do te jene pergjegjes per teljkalim te kompetencave te deleguara atyre.

Neni 18

Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket

Veprimtaria operative e Shoqerise do te drejtohet nga Drejtore e Manaxhimit te Perbashket qe do te emerohen nga Bordi i Drejtoreve. Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket perfaqesojne instancen ekzekutive te Shoqerise dhe duhet te kryejne detyrat e tyre bashkarisht.

Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket kane keto kompetenca te perbashketa:

- a) zbatojne vendimet e Bordit te Drejtoreve dhe vendimet e Asamblese se Zakonshme dhe te Jashtezakonshme;
- b) organizojne dhe racionalizojne punen me qellim qe te realizojne synimet e Shoqerise, dhe raportojne per kete ne Bordin e Drejtoreve;
- c) manaxhojne pasurite dhe pronat e Shoqerise, duke perfshire burimet financiare, ne perputhje me instruksionet e Bordit te Drejtoreve;
- d) manaxhojne dhe kontrollojne aktivitetet e degeve dhe agjensive te Shoqerise;
- e) perfaqesojne Shoqerine, me delegim te vecante te Kryetarit te Bordit te Drejtoreve, perpara autoriteteve juridike dhe te arbitrazhit dhe te treteve, si dhe perpara Autoriteteve dhe Institucioneve shqiptare dhe te huaja;

f) ti delegojne paleve te treta, te caktuara si perfaqesues, pjese te kompetencave te tyre, me referim specifik per veprime te veçanta ose kategori veprimesh. Keta perfaqesues do te jen pergjegjes per tejkalim te kompetencave te deleguara atyre;

g) ekzekutojne, ne mer dhe per llogari te Shoqerise, kontratat e çdo lloji;

h) te bejne çdo pagese per llogari te Shoqerise, marrin dhe shkarkojne te punesuar per Shoqerine dhe te firmosin kontratat perkatese. Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket kane kompetence per te bere pagesas deri ne nje maksimum te percaktuar nga Bordi i Drejtoreve.

Neni 19 **Bordi i Revizoreve**

Revizoret e brendshem dhe ata te jashtem do te emerohen nga Mbledhja e Zakonshme e Asamblese per nje periudhe 6 - vjeçare, te rinovueshme. Ata do te jene ekesperte kontabel te autorizuar ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

Neni 20 **Mbyllja e shoqerise**

Shoqeria do te mbyllet ne rastet kur:

- a) plotesohet afati i fiksuar per kohezgjatjen e saj;
- b) Shoqeria nuk ka realizuar objektin e saj;
- c) vendos Mbledhja e Jashtezakonshme e Ortakeve.

Neni 21 **Likuidimi**

Likuidimi i shoqerise do te behet ne perputhje me legjilacion shqiptar ne fuqi ne kohen e likuidimit.

Asambleja e Jashtezakonshme do te percaktoje temat teknike te likuidimit dhe do te emeroje nje ose me shume likuidatore, dhe do te percaktoje kompoentecat dhe shperblimet e tyre.

Per Di Vincenzo Estero s.r.l

Penang Shipbuilding & Construction

Antonio Napoleone

Thangaya A/L Munusamy

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

Nr.....Rep
1258

V E R T E T I M

Sot, me date 29.1.1997 (netedhjete e shtate), ditën e Merkure, para meje, Noteres se Dhomes se Notereve ne Tirane, Shpresa Kurti, me seli ne Rrugen e Durresit, mu paraqiten:

1. Shoqeria Di Vincenzo Estero S.r.l, shoqeri e se drejtes Italiane, me qender ne Via Aterno, No. 8, S.Giovani Teatino (CH), Itali, perfaqesuar nga Z. Antonio Napoleone ne baze te vendimit te ortakeve te " Di Vincenzo Estero " s.r.l, me no. pasaporte : 232962 K
2. Shoqeria Penang Shipbuilding & Construction, shoqeri e se drejtes Maleziane, me qender ne Ming Building, kati i 11-te, Jalan Bukit Nanas, 50250 Kuala Lumpur, Malezi, perfaqesuar nga Z. Thangaya A/L Munusamy, ne baze te vendimit te drejtorise se kesaj shoqerie ne baze te Nenit 98 te Stautit te kesaj shoqerie, me no. pasaporte : A. 7392013. Te lartpermendurit jane madhore e me zotesi te plote juridike, te cilet me deklaruan ne prani te perkthyeses Enyal Shuke, se sa me siper eshte Statuti i ri i Shoqerise i redaktuar jashte kesaj zyre, ne gjuhen angleze, dhe i nenshkruar perpara noteres. Une noterja e vertetoj ate rregullisht.

Perkthyes

Notere

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES

Nr. 1748 Rep
NF.....Kol



VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Enyal Shuke, banuese ne Tirane, e njohur prej meje personalisht, e cila perktheu dokumentin sa me siper njelloj me originalin nga Anglishtja ne Shqip, dhe nenshkroi para meje rregullisht.

Tirane, me 18.02.1997

NOTERE
SHPRESA KURT
NOTERE



[Handwritten signature]

Akti i shitjes se kuotave dhe kredive



Midis shoqerise DI VINCENZO ESTERO S.r.l., me seli ne S.Giovanni Teatino (CH) ne Via Aterno n.78 Kodi fiskal 04115911002 dhe NIPT-i 01767350695 L. 100.000.000 (Lireta njeqind milion)te derdhura plotesisht,regjistruar me numer 234668/1996 te Regj. te Shoqerive te CHIETI-t, e perfaqesuar nga Inxh. Giovanni Di Vincenzo, lindur ne Chieti me 8 shtator 1952 e banues per shkak te detyres ne S.Giovanni Teatino (CH),ne via Aterno n. 78, sipermarres, qe nenshkruan kete kontrate ne cilesine e Administratorit te Vetem dhe perfaqesues ligjor te Di Vincenzo Estero S.r.l., qe pasketaj do te quhet vetem "Di Vincenzo" ose "Shoqeria ceduese" dhe shoqeria " NEW PARADISE INTERNATIONAL S.R.L" me seli ne Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa n.87, kodi fiskal e NIPT 02862300247, kapitali shoqeror e deklaruar E.90.000 (nentedhjete mije Euro) i derdhur plotesisht, regj. me nr.43998/2000 ne regj. e shoqerive te Vicenzes, ketu perfaqesuar nga Z.Giovanni Panni, lindur ne Tezze Sul Brenta me daten 27 maj 1946, sipermarres, ne cilesine e administratorit te vetem, e te perfaqesuesit ligjor te shoqerise se siperpermendur me banim per shkak te detyres ne Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa n.87,Shoqeri pasketaj e quajtur thjesht "Shoqeri Marrese ose Blerese". Me seli ne Tezze sul Brenta (VI) ne via Villa n.83. eshte lidhur ne date 20 korrik 2000 nje "Kontrate Paraprake" me objekt shitjen e kuotes qe perfaqeson te gjithë kapitalin shoqeror te Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.k., nje shoqeri te se drejtes shqiptare me seli ne Tirane(Shqip) ne Rr.Babe Rexha nr.31, regjistruar ne Gjykatën e Tiranës (Shqiperi) me nr.13264/3-6527, date 29/04/99, Kodi fiskal 3706145 e NIPT IVA J72207013A (pasketaj e quajtur shkurtimisht "DI VINCENZO ALBANIA", pervec kredive te "DI VINCENZO" kundrejt "DI VINCENZO ALBANIA", sic jane detajuar ne listen ne lidhjen "B" te ketij akti;

- qe "Kontrata Paraprake" eshte regjistruar ne Pescara, ne date 26 korrik 2000 me nr.5430, Seria 3c

- qe shoqeria Panni S.r.l., duke perfituar nga cilesia qe rrjedh nga "Kontrata Paraprake", me letren e saj te dates 13.09.2000 ka caktuar shoqerine New Paradise International Srl.,sic eshte pershkruar sa siper per lidhje e kontrates perfundimtare te shitblerjes:

- qe shoqeria New Paradise International S.r.l sipas deklarates se perfaqesuesit te saj ligjor pranon caktimin e nenhyrjen ne menyre te pakondicionuar te Panni S.r.l. ne detyrimet te marra nga kjo e fundit me hartimin e kesaj kontrate paraprake.

- qe palet kane ndermend te permbushin, ashtu si efektivisht po bejne me kete akt ekzekutimi, per detyrimet e marra persiper me perseritjen paraprake, qe i lidhet ketij akti nene germen "A", per t'u bere pjese

perberese e thelbesore parashtrohet bihet dakort e l
si me poshte:



Neni 1
Vlera e parashtimeve

Parashtrimet, sic paraqiten me lart, perbejne perberese dhe thelbesore te ketij akti dhe kane vleren e nje pakti.

Neni 2
Objekti i cedimit

Me ane te kesaj kontrate "DI VINCENZO" cedon dhe shet "SHITESIT", qe blen:

(a) kuoten perfagesues te te gjithë kapitalit shoqeror te "Di Vincenzo Albania", nje shoqeri sipas ligjit shqiptar, me seli ne Tirane, ne Rr.Babe Rexha n.31, Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës (Shqiperi) me nr.13264/3-6527 date 29 prill 1999, Kodi fiskal 3706145 e NIPT J72207013A;

(b) kredi per nje shume te pergjithshme US\$ 527.420 (peseqind enjezet eshtatemije katerqindenjezet) pervec shumes prej Lireta italiane 927.109.337 (lireta italiane nenteqindenjezeteshtatemilionenjqindenentemijeetreqind tridhjeteeshtate) sic jane parashtruar ne detaje ne lidhjen nen germen "B" te kesaj kontrate.

Neni 3
Cmimi i Kuotes

Cmimi i shitblerjes se "Kuotes" sipas gernes (a) te nenit dy paraprires, percaktohet ne shume US\$ 700.000 (shtateqindmije dollare amerikane (vetem per qellimin e formaliteteve te regjistrimit te ketij shkrimi ekuivalente ne lirete 1.534.631.000 (njemiliard peseqindetridhjetekater milione gjashteqind etridhjet e njemije). Cmimi i shitblerjes se kredive sipas gernes (b) te nenit dy paraprires eshte percaktuar ne shumen e US 965.000 (nenteqindegjashte dhjetepesemije dollare amerikane) ("Cmimi i Kredive"). (per qellimet vetem te formaliteteve te regjistrimit te ketij shkrimi, ekuivalent ne lireta 2.115.598.450 (dymiliardenjqindepesembedhjetmilione pese qindnentedhjetetetemijeekaterqindepesedhjete)

Cmimi i pergjithshem i shitblerjes ("Cmimi i Pergjithshem percaktohet nga Palet ne shumen prej US 1.665.000 (njemiliongjashteqindegjashtedhjetepesemije dollare amerikane) (ekuivalente ne lireta 3.650.229.450 (tremiliarde gjashteqindepesedhjetemilionedyqindenjezet enentemijeekateqindepesedhjete).

Cmimi "i pergjithshem" , per nje kapar neto ne lireta 400.000.000 (lireta katerqindmilione) te paguara me nenshkrimin e "Kontrates Paraprake", kthimi i te ciles kompensohet me pagesen bere "DI VINCENZO" e cmimit

elivalent, nga Panni S.r.l. per "DI VINCENZO" lqe perfshin shumen qe mbetet prej 1.482.559 dollare amerikane shume eshte paguar me pare nga shoqeria blerese per "Di Vincenzo", e cila me nenshkrimin e ketij akti leshon kuitance saldoje.

Neni 4

Deklarata e garanci te paleve

4.1 Perfagesuesi ligjor e "DI VINCENZO" deklaronte garanton:

- a) qe shoqeria e perfagesuar eshte themeluar rregullisht sipas legjislacionit Italian;
- b) qe nenshkrimi i kesaj kontrate nuk bie ndesh me asnje dispozite te vete statutit dhe me asnje ligj Italian;
- c) qe perfagesuesi i nenshkruar eshte paisur me te gjitha fuqite dhe e autorizimet e nevojshme per nenshkrimin e kesaj kontrate dhe qe kjo kontrate eshte e vlefshme dhe detyruese per "DI VINCENZO"
- (d) qe Shoqeria perfagesuese eshte titullare eskuzive e kuotes se ceduar;
- (e) qe kuota nuk eshte object pengu dhe eshte e lire nga cdo lloj titulli e natyre ne favor te te treteve;
- (f) qe kredite pjese e objektit te shitblerjes sipas nenit dy paraardhes germa (b) jane likuide (me para ne dore) dhe te kerkueshme dhe jane te lira nga cdo lloj barre
- (g) qe nuk ekzistojne kredi te tjera te "DI VINCENZO" per "DI VINCENZO ALBANIA" pervec atyre te treguara ne Lidhjen "C" te kesaj kontrate;
- (h) qe "DI VINCENZO ALBANIA" nuk ka borxhe te metejshme ne lidhje me ato qe jane ne dokumentat e shkruara kontabel dhe te permbledhura ne Prospektin bashkangjitur nen germen "B".
- (i) qe kontabiliteti i "DI VINCENZO ALBANIA" eshte mbajtur duke respektuar ligjin shqiptar;
- (j) qe , pas ekzekutimit per procesin me Z. Antonin Paloka kunder "DI VINCENZO ALBANIA", per veprim rivendikimi me objekt parcelen 642 te truallit ne pronesi te shoqerise "DI VINCENZO ALBANIA" process qe ne daten e nenshkrimit te ketij akti eshte ende ceshtje e hapur para Gjykates shqiptare te Kasacionit (ne vijim "Procesi Paloka"), nuk pret zgjidhje kunder "DI VINCENZO ALBANIA" procese te nxitura nga te trete.

Para organeve gjyqsore shqiptare per te cilat "DI VINCENZO" eshte ne dijeni.





Perfaqesuesi ligjor i "DI VINCENZO" garanton, per teper, qe nuk ka asnje kontrate ne vazhdim me te arrete (persona ose shoqeri) me perjashtim te kontrates ne vazhdim me KPMG Albania, e ngarkuar per mbajtjen e kontabilitetit e kompetencat e te ciles do te qendrojne ne ngarkim te Shoqerise ceduese deri ne kete date "DI VINCENZO" eshte e ende e detyruar per pagesen e te gjitha detyrimeve fiskale.

Te maturuara deri ne daten e lidhjes se kesaj kontrate. "DI VINCENZO" obligohet perfundimisht, me kerkese te "SHOQERISE BLERESE" te perserise kete akt edhe para nje noteri te Tiranës te zgjedhur nga Palet.

4.2 Perfaqesuesi ligjor i "SHOQERISE BLERESE" deklaron e garnaton:

(a) qe Shoqeria e perfaqesuar eshte themeluar rregullisht sipas ligjit Italian;

(b) qe nenshkrimi i ketij akti nuk bie ndesh me asnje dispozite te vete statutit as edhe me ndonje te ligjit Italian;

(c) qe perfaqesuesi i nenshkruar eshte paisur me te gjitha fuqite dhe

autorizimet e nevojshme per nenshkrimin e ketij akti, dhe se ky akt eshte i vlefshem dhe detyrues per shoqerine marrese;

(d) qe Shoqeria marrese eshte ne dijeni te plote te objektit te ketij cedimi dhe ta pranoje ate ne gjendjen qe ajo ndodhet, duke hequr dore per heqjen e cdo kundershimiti.

(e) deklaron dhe garanton marrjen persiper ne ngarkim eskuziv te shoqerise se perfaqesuar cdo rrezik eventual, si dhe cdo kosto e shpenzim eventual qe ka lidhje e eshte rezultat i ceshtjes Paloka dhe te heqe dore paraprakisht nga cdo pretendim qe la lidhje me ndryshimet eventuale te "Cmimit te pergjithshem" ne vijim te rezultatit te procesit te siperremundur.

(f) Te kete vision te qarte te projekteve arkitektonike e te dokumentave qe kane lidhje me lejen e ndertimit te leshuar nga Komuna e Tiranës per realizimin e nje pasurie te palujtshme mbi truallin ne pronesi te "DI VINCENZO ALBANIA" per t'i aprovuar e per t'i gjetur te pershtatshem e te mjaftueshem;

(g) Te kete marre vision per gjendjen kontabel te "DI VINCENZO ALBANIA" me 30 shtator 2000 (bashkalidhur nen germen "B")

(h) Te marre ne ngarkim te vet cdo lloj kostoje e detyrim qe ka lidhje me kryerjen e punimeve paraprake ne perputhje me sa parashikohet.

Nga neni dy i paraprakes bashkangjitur.



Neni 5
Kryerje e formaliteteve ne Shqiperi

Ne kontekst me kete akt te nenshkruar nga perfaqesuesi i "DI VINCENZOs", e ne menyre me precise i Zoterinjve Dal Prato Luciano, Agat Aldo e i nenshkruari, "SHOQERIA BLERESE" detyrohet te kryeje emerimin e menjehershem te administratoreve te rinj e te njoftoje autoritetet kompetente shqiptare per ndryshimin e organit administrativ.

Bleresi detyrohet gjithashtu te kryeje cdo komunikim te nevojshem cdo autoriteti publik shqiptar, duke perfshire ato fiskale, qe kane lidhje me kete akt, duke cliruar "DI VINCENZO" dhe administratoret qe japin doreheqjen nga cdo pasoje qe ka lidhje me njoftimin e munguar ose jo perfekt Bleresi detyrohet ende, nen pergjegjesine, kujdesin e shpenzimet e tij per kalimin e lejes se ndertimit pas ndryshimit te emertimit te shoqerise sipas parashikimit. "DI VINCENZO" per sa i takon kompetences se saj, eshte disponibel te ofroje bashkepunimin e saj "Shoqerise Blerese", ne rast se eshte e nevojshme, per permbushjen e formaliteteve te nevojshme per kalimin e lejes se ndertimit.

Se fundi "Shoqeria Blerese" detyrohet te adoptoje brenda 12 muajsh, duke perjashtuar gjykimin dhe perzgjedhjen e shoqerise cedente, nga data e ketij akti dispozitat e nevojshme per modifikimin e emertimit te "DI VINCENZO ALBANIA" duke adoptuar nje emertim sipas pelqimit te saj qe nuk permban referimin "DI VINCENZO".

Neni 6
Modifikime te kontrates dhe selise se "Palet"

Cdo lloj modifikimi bere ketij shkrimi privat duhet bere ne forme te shkruar dhe duhet te jete nenshkruar nga te gjitha "Palet".


Per efektet e kesaj kontrate "Palet" zgjedhin selite e meposhtme:

- DI VINCENZO ESTERO S.r.l. via Aterno n.78, 66020
S.Giovanni Teatino (CH):tel> 0039 085 44681. fax: 0039
085 4468211

- New Paradise International S.r.l. : via Villa n.87,
Tezze sul Brenta.(VI) Tel 0420/539696; Fax: 0424/89642.

- Modifikimi i selise do te jete e vlefshem vetem se do t'i komunikohet pales tjeter me leter rekomande A.R.

Neni 7
Perkufizimi i Mosmarreveshjeve dhe ligji i Aplikuar



7.1 Cdo lloj mosmarreveshje lidhurme interpretimit, vlefshmerine dhe/ose ekzekutimin e ketij shkrimi privat do te lihet ne kompetence eskluzive te nje Kolegji Arbitrash te perbere nga tre arbitra, te zgjedhur mes eksperteve te fushes juridike e teknike, dy per tu emeruar nga palet dhe i treti, me funksionin e Presidentit, per t'u emeruar ne marreveshje te te pareve ose ne mos arritje te marreveshjes, nga Kryetari i Gjykates se Kietit (Itali), i cili do te emeroje edhe arbitrin per palen qe nuk e ka zgjedhur ate Brenda 20 diteve qe nga berja e kerkeses.

7.2 Pala qe ka ndermend te promovojte gjykimin e arbitrave duhet te jape njoftim me shkrim pales tjetere prane selise se zgjedhur sipas ketij dokumenti privat te shkruar per objektin e mosmarreveshjes dhe caktimin e arbitrit te vet. Brenda 20 (njetzet) diteve nga marrja e ketij njoftimi pala e thirrur ne gjykim te arbitrave duhet te caktojte arbitrin e saj.

7.3 Kolegji i Arbitrave do ta kete seline ne Kieti e do te mbahet ne gjuhen Italiane. Ligji qe zbatohet eshte ai Italian.

7.4 Vendimi do te merret Brenda 90 (nentedhete) dite nga data e kostituimit te Kolegjit. Arbitrat do te vendosin sipas te drejtes, sipas ritualit dhe vendimi do te njihet nga palet si manifestim i vullnetit te tyre dhe nuk do te kundershtohet, pervecse ne rastet e parashikuara nga ligji Italian.

Ky akt perbehet prej 7 neneve, pervec lidhjeve te tjera, qe pasi nenshkruhen jane pjeseperberese dhe thelbesore te ketij akti, nga germa A tek C, sic jane paraqitur ne vijim, nenshkruhet ne Pescara ne Piazza Unione prane lokalit te Bankes se Romes.

Me 2 (dy) Tetor te vitit 2000 (dymije)

DI VINCENZO ESTERO S.R.L. /nenshkrimi

NEW PARADISE INTERNATIONAL S.R.L./nenshkrimi



Bashkalidhur:

- (A) Kontrata paraprake e 20 korrik 2000
- (B) Lista e detajuar e kredive te "DI VINCENZO" per "DI VINCENZO ALBANIA"
- (c) Situata kontalibe e "DI VINCENZO ALBANIA" m 30 Shtator 2000

Rep. Nr. 4870

Vertetim Firme

Une i nenshkruari, Dr. Giovanni Di Pierdomenico, Noter banues ne Cepagate regjistruar ne Dhomen e Distrikteve Noteriale te Teramos e Peskares, pa ndihmen e deshmintareve dhe ne marreveshje te perbashket midis tyre dhe me miratimin tim, kane hedhur nenshkrimet e tyre ne fund te ketij dokumenti me me shkrim qe paraprin dhe ne ane te cdo faqeje qe eshte bashkangjitur

- Di Vincenzo Giovano, lindur ne Kieti me 8 shtator 1952, sipermarres qe ka marre pjese ne kete shkrim me emrer dhe per llogari dhe interes te shoqerise

- DI VINCENZO ESTERO S.r.l, me seli ne S. Giovanni Teatino (CH) alla via Aterno n.78, ku banon per shkak te detyres, Kodi fiskal 04115911002 dhe NIPT 01767350695 kapitali shoqeror L. 100.000.000 (lireta njeqind milione) i derdhur, regjistruar me nr. 234668/1996 te Regj, te Shoqerive te Chietit qe ka nenshkruar aktin e mesiperm ne cilesine e Administratorit te Vetem e ligjor te shoqerise se siperpermendur:

- Di Vincenzo Giovanni, lindur ne Chieti me 8 shtator 1952, sipermarres qe merr pjese ne kete dokument te shkruar ne emrin, vend dhe llogari eskuzive te shoqerise:

- DI VINCEZO ESTERO S.r.l., me seli ne S. Giovanni Teatino (CH) alla via Aterno n.78, ku ka residencen per shkak te detyres, Kodi fiskal 04115911002 dhe NIPT 01767350695 me kapital shoqeror Lireta 100.000.000 njeqind milione) te derdhur plotesisht, regjistruar me nr 234668/1996 ne Regjistrin e Shoqerive te Chieti-t, qe ka nenshkruar aktin qe paraprin ne cilesine e tij te Administratorit ligjor te shoqerise se siperpermendur.

- Panni Giovanni, lindur ne Tezze Sul Brenta me dt. 27 maj 1946, sipermarres qe merr pjese ne kete akt jo si person por ne emer, vend, per llogari dhe interes eskuziv te shoqerise:

"NEW PARADISE INTERNATIONAL S.R.L" me seli ne Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa n.87, ku ka residencen per shkak te detyres, Kodi fiskal e NIPT 02862300247, kapital shoqeror i deklaruar E.90.000 (nentedhjetemije E), i derdhur E.27.000 (njezeteshtate mije Euro) regjistruar, me nr.43998/2000 ne Regjistrin e Shoqerive te Vincencas ne cilesine e administratorit te vetem e te perfaqesuesit ligjor te shoqerise se siperpermendur, per identitetin



personal te te cileve une Noteri u sigurova.

Pescara, Piazza Unione n. , prane ambienteve te
Bankes se Romes S.p.a sot me dy tetor dymije (02-10-2000)

Firma / timbro

Kaliopi Pulaj
KALIOPI PULAJ
PERSHËRËS I NOTERIT
INDOR TRANSLATOR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
NR. 590P REP.

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses **Kaliopi PULAJ**, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje, e cila deklaroi se ka perkthyer sa me siper, njelloj me originalin nga italisht ne shqip dhe nenshkroi rregullisht para meje.

Tirane me 07.12.,2000

NOTER
Suprese Kurti
Suprese



AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"NEW PARADISE INTERNATIONAL"
Repubblica Italiana

Viti 2000 (dymije), date 7 (shtate) e muajit Gusht.

Ne Bassano del Grappa , ne studion time ne via Verci, n. 21.

Perpara meje dr. GIUSEPPE FIETTA, noter, banues ne Bassano del Grappa dhe rregjistruar ne Ruolo del Colleggio Notarile dei Distretti Riuniti di Vicenza e Bassano del Grappa, pa pranine e deshmitareve, per te cilet paraqitesit me akord te perbashket dhe me miratimin tim kane hequr dore, jane paraqitur zoterinjte:

PANNI GIOVANNI, lindur ne Tezze sul Brenta (VI) me 27 maj 1946, banues ne Tezze sul Brenta (VI) Via Villa n. 136, sipermarres,

Kod Fiskal PNN GNN 46E27 L156T;

TELLATIN ROSA, lindur ne Tezze sul Brenta (VI) me 29 tetor 1949, banues ne Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 136, sipermarrese,

Kod Fiskal TLL RSO 49R69 L156A;

PANNI CHIARA, lindur ne Bassano del Grappa (VI) me 25 mars 1974, banuese ne Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 136, sipermarrese,

Kod Fiskal PNN CHR 74C65 A703L;

PANNI LORETTA, PANNI CHIARA, lindur ne Bassano del Grappa (VI) me 16 mars 1976, banuese ne Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 136, sipermarrese,

Kod Fiskal PNN LTT 76C56 A703W;

PANNI KETTY PANNI CHIARA, lindur ne Bassano del Grappa (VI) me 16 janar 1971, banuese ne Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 136, sipermarrese,

Kod Fiskal PNN KTY 71A56 A703R;

e cila deklarom se merr pjese ne kete akt, pervec per veten e saj, edhe si Presidente e Keshillit te Administrimit, perfaqesuese ligjore, e shoqerise:

"PANNI s.r.l."

me seli ne Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 85, me kapital themeltar prej Lire 40.000.000 (dyzetmilione);

regjistruar ne Rregjistrin e Ndermarrjeve te Vicenza-s n. 178092;

Kod Fiskal dhe NIPT 00868310244;

e autorizuar ne kete akt, si edhe ne kontraktimin e Vendimit te Keshillit te Administrimit ne daten e sotme dhe vendimin e asamblese se zakonshme te ortakeve ne daten e sotme.

Zoterinjte e pranishem, qytetare italiane, per identitetin e te cileve dhe zotesine juridike te te cileve, une Noteri ja i sigurt, bien dakort dhe lidhin sa me poshte:

- 1) Eshte formuar nga zoterinjte panni Giovanni, Tellatin Rosa, Panni Ketty, Panni Chiara, Panni Loretta dhe shoqerise "PANNI SRL" nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e quajtur:

"NEW PARADISE INTERNATIONAL SRL"

- 2) Shoqeria eshte formuar sipas te gjitha normave qe permban ky akt dhe atyre te caktuara ne Statutin social, qe eshte nenshkruar nga paraqitesit dhe nga une, Noteri, bashkengjitur me kete akt si A), si pjese perberese dhe themelore, lezuar nga une Noteri perpara te gjithe paraqitesve.

- 3) Shoqeria ka per objekt:

A) - komercializimi, importi, eksporti edhe per komisione, agjensi dhe perfaqesi me ose pa depozita, te mallrave dhe materialeve te ndermarrjeve porositese, te lendeve te par a, gjysem te gatshme, makineri, aparatur a mekanike, pneumatike, oleodinamike dhe elektrinike;

B) – blerja, shitja, shkembimi, ndertimi, ristrukturimi per vete dhe per te tretet te fabrikateve urbane, industriale, tregtare dhe drejtuese;

- blerja, shitja, shkembimi i terreneve duke kryer cdo punim, vepra dhe impiante per vleresimin e tyre;

- administrimi direkt dhe indirekt i fondeve dhe pasurive bujqesore.

Shoqeria, per arritjen e e qellimit social mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale dhe imobilare dhe gjithashtu mund te kryeje jo si aktivitet kryesor, plotesues dhe prodhues dhe gjithashtu me perjashtim te shprehur per cdolloj aktiviteti te kryer per publikun, operacione financiare dhe imobilare, duke dhene dorezani dhe garanci ne favor te te treteve, si edhe te marre, vetem me qellimin e investimit te qendrueshem dhe jo tesi ne menyre direkte ashtu edhe ne menyre indirekte, pjesmarrje ne shoqeri italiane dhe te huaja, duke patur

si objekt te ngjashem ose te lidhur me te sajin, permec limiteve te vena nga neno 2361 i K.C.

- 4) Kohezgjatja e shoqerise eshte fiksuar nga data e sotme deri me 31.12.2050 (tridhjetenje dhjetor dymijepesedhjete).

Asamblea e jashtezakonshme e ortakeve mund te vendose shkrijen e Shoqerise edhe perpara mbarimit te afatit ose mund ta zgjase ate.

- 5) Selia e shoqerise eshte: Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 87.

Shoqeria mund te hapi dhe te mbylli seli secondare, filiale, perfaqesi, zyra, agjensi si ne Itali, ashtu edhe jashte saj.

- 6) Kapitali themeltar i shoqerise eshte Euro 90.000 (nentedhjetemije euro) dhe eshte i ndare ne kuota sipas ligjit, marre persiper dhe nenshkruar nga ortaket si me poshte:

PANNI GIOVANNI

- Euro 12.150 (dymbedhjetemijenjeqindepesedhjete euro) baraz me 13,5%

TELLATIN ROSA

- Euro 12.150 (dymbedhjetemijenjeqindepesedhjete euro) baraz me 13,5%

PANNI KETTY

- Euro 12.150 (dymbedhjetemijenjeqindepesedhjete euro) baraz me 13,5%

PANNI CHIARA

- Euro 12.150 (dymbedhjetemijenjeqindepesedhjete euro) baraz me 13,5%

PANNI LORETTA

- Euro 12.150 (dymbedhjetemijenjeqindepesedhjete euro) baraz me 13,5%

Societa' "PANNI SRL"

- Euro 29.250 (njezetentemijedyqindepesedhjete euro) baraz me 32,5%

Merret parasysh qe 3/10 e kapitalit themeltar i barabarte me Euro 27.000 (njezeteshtatemije) jane derdhur prane filialit te Tezze sul Brenta della Banca Popolare

di Marostica ne daten e sotme.

Viti i pare kontabel do te mbyllet me 31.12.2000 (tridhjetenje dhjetor dymije).

- 7) Per administrimin e shoqerise ne kohe te papercaktuar emerohet nje Administrator i Vetem ne personin e Panni Giovanni, i cili duke pranuar detyren qe i ngarkohet, deklararon dhe konfirmon se me nenshkrimin e ketij akt themelimi, nuk ekzistojne pengesa ne drejtim te tij per marrjen e detyres,

8) Z. Giovanni Panni vazhdon te jete personi i autorizuar per ndjekjen e procedurave dhe formaliteteve te nevojshme per themelimin e ligjshem te shoqerise dhe eshte i autorizuar te terheqe 3/10 prane filialit te Tezze sul Brenta te Bankes se siperpermendur dhe te fuse ne kete akt themelimi dhe ne statutin bashkengjitur te gjithë shtesat, heqjet ose modifikimet qe mund te kerkohen nga Autoriteti Gjyqesor kompetent.

9) Shpenzimet perkatese te aktit jane ne ngarkim te shoqerise dhe mendohet te kapin shifren prej Lire 4.500.000 (katërmilione pesëqindmije lira).

Me kerkese, une Noteri kam marre aktin ne fjale qe lexohet nga une per te gjithë paraqitesit, te cilet deklarojne miratimin e tyre.

Aktio eshte shkruar nga une dhe shtypur nga nje person qe gezon besimin tim nen mbikqyrjen time ne flete, ne te cilat ze gjashte pjese te plotea dhe deri ne kete pke te kesaj faqe.

Nenshkruar: Panni Giovanni

Nenshkruar: Tellatin Rosa

Nenshkruar: Panni Ketty

Nenshkruar: Panni Loretta

Nenshkruar: Panni Chiara

Nenshkruar: Giuseppe Fietta Noter

Shtojca A) n. 90.707 rep e n. 26.101 racc.

STATUTO

KREU I

EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1) Eshte krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin:

“NEW PARADISE INTERNATIONAL SRL”.

Neni 2) Shoqeria ka seline ne Tezze sul Brenta (VI), Via Villa n. 87.

Shoqeria mund te krijojë seli dytesore, filiale, perfaqesi, zyra, agjensi si ne Itali, ashtu edhe jashte saj.

Neni 3) Shoqeria ka per objekt:

A) - komercializimi, importi, eksporti edhe per komisione, agjensi dhe perfaqesi me ose pa depozita, te mallrave dhe materialeve te ndermarrjeve porositese, te lendeve te par a, gjysem te gatshme, makineri, aparatur a mekanike, pneumatike, oleodinamike dhe elektrinike;

B) – blerja, shitja, shkembimi, ndertimi, ristrukturimi per vete dhe per te tretet te fabrikateve urbane, industriale, tregtare dhe drejtuese;

- blerja, shitja, shkembimi i terreneve duke kryer cdo punim, vepra dhe impiante per vleresimin e tyre;

- administrimi direkt dhe indirekt i fondeve dhe pasurive bujqesore.

Shoqeria, per arritjen e e qellimit social mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale dhe imobilare dhe gjithashtu mund te kryeje jo si aktivitet kryesor, plotesues dhe prodhues dhe gjithashtu me perjashtim te shprehur per cdolloj aktiviteti te kryer per publikun, operacione financiare dhe imobilare, duke dhene dorezani dhe garanci ne favor te te treteve, si edhe te marre, vetem me qellimin e investimit te qendrueshem dhe jo tesi ne menyre direkte ashtu edhe ne menyre indirekte, pjesmarrje ne shoqeri italiane dhe te huaja, duke patur si objekt te ngjashem ose te lidhur me te sajin, permec limiteve te vena nga neno 2361 i K.C.

Neni 4) Kohezgjatja e shoqerise eshte fiksuar nga data e sotme deri me 31.12.2050 (tridhjetenje dhjetor dymijepesedhjete).

Asambleja e jashtezakonshme e ortakëve mund të vendosë shkrijën e Shoqërisë edhe përpara mbarimit të afatit ose mund ta zgjasë atë.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 5) Kapitali themeltar është Euro 90.000 (nëntëdhjetemijë euro) dhe ndahet në kuota sipas dispozitave ligjore.

Ortakët mund të kryejnë derdhje ose në llogarinë themeltare, ose në kuota të kapitalit themeltar që zoterojnë. Me qëllim ndjekjen e qëllimit social, shoqëria gjithashtu, mund të marrë të hua nga vete ortakët pa interesa, me detyrimin e rimborsimit në kohë dhe me kushtet e parashikuara nga normativa në fuqi në fushën e kursimeve. Neqoftese financimi nuk do të jetë pa interesa, për këtë të fundit do të kërkojë një vendim specifik.

Neni 6) Quota janë të transferueshme *mortis causa*. Në rastin e transferimit ndërmjet personave të gjallë me titullin duhet të ofrohen paraprakisht ortakëve të tjerë.

Jane të vlefshme të gjitha shitjet e bera jo sipas procedurave të kalimit të sipërpermendura, kur për të merret miratimi i të gjithë ortakëve.

Ortaku që mendon të shesë kuota duhet të japë komunikimin me shkrim për ortakët e tjerë në shtyllë të tyre që figurojnë në Librin e Ortakëve me leter rekomanduese me konfirmim marrje, duke specifikuar emrin/emrat e blerësit, kushtet, termat dhe menyrat e blerjes.

Ortakët kanë të drejtën e parablerjes për kuota objekt i shitjes, në mënyrë proporcionale me kuota të zotëruara nga ato vete dhe nga kuota të zotëruar nga ortakët që duan të ushtrojnë këtë të drejtë.

Me këtë qëllim, kur e drejta e parablerjes ushtrohet vetëm nga disa ortakë, ortaku që kërkon të shesë duhet të ofrojë kuota jo të zgjedhshme ortakëve që kanë ushtuar të drejtën e parablerjes, në mënyrë që parablerja të ushtrohet e tëra.

Neqoftese asnjë nga ortakët nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes ose dëshiron ta ushtrojë vetëm pjesërisht për kuota objekt i blerjes, ose kur nuk ka asnjë përgjigje për ortakun që dëshiron të shesë brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes së rekomandueses me konfirmim a.r., ortakët e tjerë, ortaku që dëshiron të shesë mund të kalojë të treta të treguar nga ai vete kuota në fjalë, përveç kur, gjithmone

ne limitin e tridhjetë diteve nga data e marrjes së rekomandese, ortaket e tjere bashkarisht dhe me unanimitet kanë evidentuar një bleres tjetër të cilit duhet të kalojnë kuotat, në kushtet dhe në menyrat e treguara në komunikimin e ortakeve të tjere.

Shitja të bashkeshorti dhe afermit të shkallës së parë, ose të ortaket, nuk le vend për të drejtën e parablerjes në favor të ortakeve të tjere.

KREU III

ASAMBLEA

Neni 7) Asambleja e Ortakeve thirret në përputhje me ligjin, nga Keshilli i Administrimit ose nga Administratori i Vetem pranë selisë sociale ose diku tjetër, por në Itali.

Asambleja duhet të thirret nga Keshilli i Administrimit ose nga Administratori i Vetem me leter rekomande, derguar ortakeve të pakten të tërë para mbledhjes në selinë e tyre që figuron në librin e Ortakeve.

Asambleja e Ortakeve është gjithësesi e vlefshme në të gjitha efektet edhe nëse nuk është mbledhur sipas formaliteteve të kërkuara, atëherë kur përfaqësohet i gjithë kapitali themeltar dhe janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Keshillit të Administrimit ose Administratori i Vetem dhe Kolegji Sindakal nëq është emeruar.

Asambleja duhet të mbledhet të pakten një herë në vit për miratimin e bilancit. Gjithashtu mund të thirret në seli të zakonshme çdo herë që organi Administrativ e quan të nevojshme, si edhe në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Në letren e thirrjes duhet të përcaktohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes, si edhe rendi i ditës.

Neni 8) Kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamble ortaket e regjistruar në librin e ortakeve.

Ortaket mund të kanë të përfaqësohen me emerim të shkuar sipas nenit 2372 të Kodit Civil përveç kufizimeve të parashikuara dhe atyre të vendosura nga ligji.

Neni 9) Asambleja drejtohet nga Presidenti i Keshillit të Administrimit ose nga Administratori i Vetem.

Në rast mungese ose pengese të këtij të fundit, Asambleja zgjedh Presidentin e vet.

Neni 10) Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.

Asambleja e zakonshme vendos me voten ne favor te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit themeltar.

Per vlefshmerine e vendimeve te asamblese se jashtezakonshme kerkohet vota ne favor e ortakeve qe perfaqesojne te pakten 2/3 e kapitalit themeltar.

KREU IV

ADMINISTRIMI

Neni 11) Shoqeria do te administrohet nga nje Keshill Administrimi i perbere nga dy deri ne gjashte vete ose nga nje Administrator i Vetem.

Mund te zgjidhen Administratore edhe jo-Ortake. Keshilli i Administrimit ose Administratori i Vetem qendron ne detyre tre vite financiare (cdo Administrator mund te rizgjidhet) ose ne kohe te papercaktuar.

Neqoftese Keshilli i Administrimit ose Administratori i vetem emerohen me kohe te pacaktuar mund te revokohen ne cdo moment nga ana e asamblese, pervec lajmerimit.

Neni 12) Organit Administrativ i kalohen te gjitha kompetencat ne administrimin e Shoqerise. Ajo mund te kryeje odolloj akti qe i perket administrimit e zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe te beje cdo gje qe eshte e mundur ose e nevojshme per arritjen e qellimit social qe nuk eshte, nga ligji ose nga statuti, e drejte e asamblese. Ajo mund te emeroje drejtores, prokurues.

Ne rastin kur shoqeria drejtohet nga nje Keshill Administrimi, ky i fundit thirret nga Presidenti ose ne rast pengese nga nje Administrator tjetere qe kryen kete funksion, te gjitha heret qe do te quhet e nevojshme dhe cdo here qe kerkohet nga te pakten gjysma e pjesmarresve.

Lajmerimi i mbledhjes duhet te dergohet me poste te pakten pese dite perpara dates se fiksuar per mbledhje dhe ne rast urgence me ane te telegramit, por gjithmone ne me nje paralajmerim prej njezetekater oresh.

Keshilli vendos me shumicen e votave te pjesmarresve; ne rast barazie vlen vota e Presidentit, ne rastin kur Keshilli eshte i perbere nga me shume se dy anetare.

Neni 13) Presidentit te Keshillit te Administrimit ose Administratorit te Vetem i takon te nenshkruaje dhe te perfaqesoje Shoqerine kundrejt te treteve dhe ne gjykim, me te drejten e promovimit te veprimeve, procedurave dhe instancave juridike apo

administrative, si edhe te bie ne ujdj, te pajtoje brenda limiteve te fuqise se tyre sic eshre fiksuar ne paragrafin e mesiperm.

Keshilli i Administrimit mund te delegoje atributet e tij nje Komiteti Ekzekutiv te perbere nga disa nga anetaret e tij ose nje ose me shume anetare, duke percaktuar limitet e delegimeve qe mund ti leshohen edhe per ceshtje te evecanta.

Administratoret e Deleguar do te kene edhe prokuren relative te perfaqesimit.

Neni 14) Administratorit te Vetem ose pjestareve te Keshillit te Administrimit, pervec pageses se shpenzimeve te bera per ushtrimin e funksioneve te tyre, mund ti caktohet edhe nje shume fikse vjetore, ne nje shume te vetem ose sipas muajit ose pranise, sipas menyres se pjesmarrjes ne fitimet e vitit financiar, percaktuar nga Asamblea e ortakeve.

Asamblea e ortakeve, gjithashtu, mund te vendose pagesen e nje shume ne perfundim te mandatit ne formen e fondeve rezerve ne para ose ne police sigurimi.

KREU V

VITI FINANCIAR – BILANCI – TE ARDHURAT

Neni 15) Viti financiar mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Me mbylljen e cdo viti financiar Keshilli i Administrimit ose Administratori i Vetem kryen plotesimin e bilancit dhe te formaliteteve te metejshme duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Asamblea per miratimin e bilancit do te mblidhet brenda kater muajve nga mbyllja e vitit financiar. Kur kerkohet nga nevoja te vecanta asamblea mund te mblidhet brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 16) Te ardhurat neto te cdo viti financiar, duke zbritur sa i perket rezerves ligjore siaps art.2430 C.C, ndahen midis ortakeve ne porporcion me kuotat qe zoterojne, pervec kur vendoset ndryshe nga ana e asamblese.

KREU VI

KOLEGJI SINDAKAL

Neni 17) Kolegji Sindakal , i emeruar ose i detyrueshem nga ligji, eshte i perbere nga tre Kryetare efektive dhe dy zevendes te zgjedhur midis Revizoreve Kontabel, te emeruar dhe funksionale sipas ligjit..

KREU VII

ZGJIDHJA - LIKUJDIMI

Neni 18)

Duke arritur ne cdo kohe dhe per cdolloj motivi zgjidhjen e Shoqerise, asamblea do te vendose menytrat e likujdimit dhe do te beje emerimin e nje ose me shume likujduesve duke percaktuar fuqite e tyre.

KREU VIII

KLAUZOLA E ARBITRAZHIT

Neni 19) Zgjidhja e cdo mosmarreveshje qe mund te dale midis ortakeve dhe/ose midis shoqerise dhe ortakeve do ti kalohet nje Kolegji arbitral te perbere nga tre anetare, dy te emeruar nga secila pale dhe i treti, me marreveshje te perbashket, nga arbitrat e caktuar, ose ne mungese, nga Presidenti i Gjykates kompetente per territorin.

Kolegji Arbitral do te gjykoje brenda gjashtedhjete diteve, sipas se drejtes dhe ne rruge normale edhe shpenzimet dhe kompetencat qe i takojne arbitrave.

Kur njera nga palet nuk ben emerimin e arbitrit te saj brenda dhjete diteve nga ftesa per nje gje te tille, emerimin do te beje Presidenti i Gjykates kompetente per territorin.

KREU IX

DISPOZITA FINALE

Neni 20) Persa i perket asaj qe nuk eshte shprehur ne kete kontrate, do ti referohet ketij statuti, dispozitave te Kodit Civil dhe ligjeve te vecanta ne kete fushe.

Nenshkruar: Panni Giovanni
Nenshkruar: Tellatin Rosa
Nenshkruar: Panni Ketty
Nenshkruar: Panni Loretta
Nenshkruar: Panni Chiara
Nenshkruar: Giuseppe Fietta Noter


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
No. 8052 Rep.

Tirane, me 21.07. 2006

VERTETIM NENSHKRIMI

Vertetohet firma e perkthyeses Edlira HYSENI, e njohur personalisht prej meje, e cila me deklaroi se perktheu ne shqip njelloj me originalin dokumentin e mesiperm dhe une noteria vertetoj nenshkrimin e saj.

NOTERE
RUKO SAKO



REPUBLIKA E SHOIPËRISË

Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk

V E N D I M

I

ASAMBLESE SË ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "DI Vincenzo Estero Albania" SHPK



Sot, më datën 21, Korrik 2006 (dymijë e gjashtë), në Selinë e Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, të ndodhur në adresën : bulevardi "Bajram Curri", Godina "European Trade Center" prapa Piramidës, Tiranë, Shqipëri, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie.

Janë të pranishëm :

- 1. Z. Giovanni Panni**, i datëlindjes 27, Maj 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm, dhe të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, me banim për shkak të detyrës në Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa Nr. 136, Itali, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor për të vepruar në emër dhe për interes të Ortakut të Vetëm Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l, shoqëri e të drejtës Italiane,
- 2. Z. Genc DULAKU**, i biri Nikos dhe i Lirikës i datëlindjes 19, Dhjetor 1967 lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën: Ruga "Pjetër Bogdani", Pall. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me **Nr.Z0600471**, në cilësinë e Administratorit Ligjor të Shoqërisë "Edil Al it" Shpk, në cilësinë personit të ftuar.
- 3. Znj. Ardita PELINKU**, e datëlindjes 20, Tetor 1970, në cilësinë e përkthyeses të Gjuhës Italiane, në cilësinë e përkthyeses së Gjuhës Italiane, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i Pasaportës me **Nr.Z0324743**.

Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, është regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr 13264, datë 10. 01. 1996. me Seli të saj në adresën : "Dëshmorët e 4 Shkurit", Pall. 27, Shk. 1, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

Me anë të Vendimit Nr. 15971/5, datë 11. 01. 2001, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është bërë regjistrimi i Aktit Noterial, Kontratës së Shitjes së Kapitalit dhe Kredive të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, me Nr. 4870, datë 02. 10. 2000, të redaktuar nga Noteri i Pecares-Itali dhe Nr.5913/642, datë 07. 12. 2000, të Zyrës së Noterisë Tiranë, nëpërmjet së cilës është realizuar blerja e 100 % (njëqind përqind), të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, prej Ortakut të Vetëm Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l., si dhe janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin në Regjistrin Tregtar shqiptar të kësaj Kontrate, ku si Ortak i Vetëm i saj, tashmë është Shoqëria "NEW Paradise

International" S.r.l, e cila zotëron 100% (njëqind përqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin e saj.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Shoqëria "New Paradise International" S.r.l., me Vendimin Vendimin e Asamblesë së Ortakëve, të datës 07, Korrik 2006, nënshkrimet e të cilave janë vërtetuar me Vërtetimin noterial Nr. 169975 repertori, datë 17.07.2006, të Noterit Giuseppe Fietta, Vicenza Itali, asambleja ka vendosur të autorizojë **Z. Giovanni Panni**, i datëlindjes 27, Maj 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm, dhe të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, me banim për shkak të detyrës në Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa Nr. 87, Itali, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në interes dhe për llogari të Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l. për të transferuar 100%(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar ose 100 (njëqind) kuotave të shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" shpk si dhe shitjen e boxhit të shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" shpk.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Shoqëria "NEW Paradise International" S.r.l, i përfaqësuar nga Z.Giovanni Panni, e cila zotëron 100 % të kuotave të kësaj shoqërie, i mbledhur rregullisht dhe në gjendje për të vendosur mbi rendin e ditës :

- 1. TRANSFERIMI I 100 % TË KAPITALIT THEMELTAR, TË SHOQËRISË "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" SHPK.**
- 2. SHITJA E BORXHIT QË SHOQËRIA "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" SHPK, KA NDAJ SHOQËRISË "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S.R.L.**

- Ortaku i Vetëm, Shoqëria "NEW Paradise International" S.r.l, për arsye objektive largohet nga Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, duke miratuar transefimin e kapitalit të zotëruar respektivisht prej tij, dhe që përfaqëson 100 % (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 100 (njëqind) kuota, është plotësisht dakort dhe vendos që t'ia shesë kuotat e tij Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, e cila pranon dhe ble 100 % (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, ose 100 (njëqind) kutota, të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, me një çmim total në vlerën prej prej € 997.230,00 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë Euro).
- Ortaku i Vetëm, Shoqëria "New Paradise International" S.r.l, vendos t'i shesë borxhet që Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka ndaj Shoqërisë "New Paradise International" Shpk, me një çmim nominal në shumën prej Euro 1.002.770,00 (një milion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë Euro), siç paraqiten rregullisht në kontabilitetin e të dy shoqërive dhe objekt i shitjes së mëparëshme të datës 02/10/2000 përpiluar pranë Zyres Noteriale të Pescara-s.
- Transferimi i 100 % (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 100 (njëqind) kuota, dhe e borxheve të parashikuara në pikën 2 të rendit të ditës, do të bëhet nëpërmjet kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit para noterit, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme :
- Ortaku i ri, Shoqëria "Edil Al IT" Shpk, do të likujdojë brenda dhe jo më vonë se data 21 (njetzet e një) Korrik 2006, një shumë totale (çmimi i kuotave të kapitalit plus borxhit) të barabartë me €2,000.000 (dymilion Euro), nëpërmjet Raiffeisen Bank Shqipëri, të hapur pranë Bankes Cassa di Risparmio di Padova e Rovigo AG. Bassano del Grappa; IBAN IT25 N062 2560 1601 0000 0114 692; BIC IBSPIT2P 541, nga përfaqësuesi Ortaku i Vetëm, Shoqëria "New Paradise International" S.r.l .




- Dokumenti i vetëm zyrtar, i cili do të vërtetojë shlyerjen e kësteve të çmimit, do të jetë dokumenti bankar (konferma bankare), i cili lëshohet nga banka për çdo pagesë të Ortakut të ri Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, në favor të Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l, në ekzekutim të kësaj kontrate.
- Pas shitjes së kuotave, dhe likuidimit total çmimit ë kapitalit dhe të çmimit të borxhit nga Blerësi, Ortak i Vetëm i kësaj shoqërie do të bëhet Shoqëria Edil Al IT" shpk, e cila do të bëhet pronare e vetem në kapitalin e Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, me 100%(njëqindpërqind), të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë. Duke mos pasur gje tjetër për të cilën duhet të merrej një vendim, Ortaku i Vetëm e deklaron të mbyllur asamblenë. Ky vendim u hartua në dy kopje në gjuhën shqipe dhe italiane.
- Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Regjistrimit Tregëtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrimit tregëtar.
- I bashkëngjitet këtij vendimi :
 - Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l., i datës 07, Korrik 2006, nënshkrimet e të cilëve janë vërtetuar me Vërtetimin noterial Nr. 169975 repertori, datë 17.07.2006,

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" SHPK

Shoqëria "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S. R. L.

PËRFAQËSUAR NGA :

Z. Giovanni Panni



*Perkthyer nga
Ardita Pelumbi*




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. 8038 **REP.**
Nr. 1305 **KOL.**

V È R T E T I M

Sot, më datë 21/07/2006 (dymijë e gjashtë), përpara meje **Ruko Sako**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Krugën e "Durrësit", u paraqit personalisht :


SHOQËRIA "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S. R. L., shoqëri e të drejtës tregtare Italian, me seli në Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa n. 87, Itali, me Kod Fiskal e Nipt 02862300247, kapitali Shoqëror e deklaruar E. 90,000 (Nëntëdhjetë mijë Euro) i derdhur plotësisht, regj. Nr. 43998/2000 në regj. e shoqërive të Vecenzes, këtu përfaqësuar nga **Z. Giovanni Panni**, i datëlindjes Maj, 27. 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm, dhe të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, me banim për shkak të detyrës në Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa Nr. 87, Itali, identifikuar nëpërmjet Pasaportë personale me Nr. n. 046885VR;

SHOQËRIA "EDIL AL IT" SHPK, person juridik shqiptar, i regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 5319, datë 06.07.1994, me Kod fiskal Nr.3606732, dhe me NIPT J61911003I, i përfaqësuar nga Administratori Ligjor i Shoqërisë **Z. Genc DULAKU**, i biri Nikos dhe i Lirikës i datëlindjes 19. 12. 1967 lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën: Ruga "Pjetër Bogdani", Pall. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me **Nr.Z0600471**, **Znj. Ardita Pelinku**, e datëlindjes 20/10/2006, në cilësinë e Përkthyesit të gjuhës Italianë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i Pasaortës me Nr. Z0324743

të cilët më deklaruan se dokumenti i bashkëngjitur këtij Vërtetimi është një Vendim i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Sh. P.K, i hartuar dhe i nënshkruar në me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe unë, noterja e vërtetoj nënshkrimin e tyre rregullisht sipas ligjit.

N O T E R E

Ruko SAKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 8238 REP.
Nr. 1306 KOL.

B 269/7



KONTRATE SHITJE
TE KUOTAVE TE KAPITALIT

Në Tiranë, sot më datë 21, Korrik 2006(dymijë e gjashtë), ditën e Premte, përpara meje noteres **Ruko SAKO**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme :

SHITËSI : SHOQËRIA "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S. R. L. , shoqëri e të drejtës tregtare Italian, me seli në Tezze sul Brenta (VI) rruga Villa n. 87, Itali, me Kod Fiskal e Nipt 02862300247, kapitali Shoqëror e deklaruar E. 90,000 (Nëntëdhjetë mijë Euro) i derdhur plotësisht, regj. Nr.280156 në regj. e shoqërive të Vecenzes, këtu përfaqësuar nga **Z. Giovanni Panni**, i datëlindjes 27, Maj 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm, dhe të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, me banim për shkak të detyrës në Tezze sul Brenta (VI) rruga Villa Nr. 136, Itali, identifikuar nëpërmjet Pasaportë personale me Nr. 046885VR, i cili nuk di shqip, i shoqëruar nga Përkthyesja e Gjuhës Italiane **Z. Ardita PELINKU**, e datëlindjes 20, Tetor 1970, në cilësinë e përkthyeses të Gjuhës Italiane, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtëse e Pasaportës me Nr.Z0324743, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "**Pala SHITËSE**".

BLERËSI : SHOQËRIA "EDIL AL IT" SHPK, person juridik shqiptar, i rregjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 5319, datë 06.07.1994, me Kod fiskal Nr.3606732, dhe me NIPT J61911003I, i përfaqësuar nga Administratori Ligjor i Shoqërisë **Z. Genc DULAKU**, i biri Nikos dhe i Lirikes i datëlindjes 19, Dhjetor 1967 lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën: Ruga "Pjetër Bogdani", Pall. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me **Nr. Z 0600471**, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "**Pala BLERËSE**".

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, në prani edhe të përkthyeses se gjuhes italiane Z. Ardita Pelinku, Unë noteria konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë KONTRATË SHITJEJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT, sipas kushteve, afateve dhe kriterëve të mëposhtëme :

KUSHTE PARAPRAKE


Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr 13264, datë 10. 01. 1996. me Seli të saj në adresën : "Dëshmorët e 4 Shkurit", Pall. 27, Shk. 1, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Me anë të Vendimit Nr. 15971/5, datë 11. 01. 2001, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është bërë regjistrimi i Aktit Noterial, Kontratës së Shitjes së Kapitalit dhe Kredive të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, me Nr.4870, datë 02. 10. 2000, të redaktuar nga Noteri i Pescares-Itali dhe Nr. 5913/642, datë 07. 12. 2000, të Zyrës së Noterisë Tiranë, nëpërmjet së cilës është realizuar blerja e 100 % (njëqind përqind), të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk" Shpk, prej Ortakut të Vetëm Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l , si dhe janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin në Regjistrin Tregtar shqiptar të kësaj Kontrate, ku si Ortak i vetëm i saj, tashmë është Shoqëria "New Paradise International" S.r.l, e cila zotëron 100% (njëqind përqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin e saj.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Shoqëria "New Paradise International" S.r.l, për arsye objektive kërkon të largohet nga shoqëria dhe është plotësisht dakort që t'i shesë kuotat e tij në Shoqërinë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, së bashku me kreditet sipas kushteve dhe afateve të mëposhtëme.

Shoqëria "New Paradise International" S.r.l., shoqëri e së drejtës Italiane, me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve, të datës 07, Korrik 2006, nënshkrimet e të cilëve janë vërtetuar me Vërtetimin noterial Nr. 169975 repertori, datë 17.07.2006, të Noterit Giuseppe Fietta, Vicenza Itali, asambleja ka vendosur të autorizojë Z.Giovanni Panni, i datëlindjes 27, Maj 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm, dhe të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, me banim për shkak të detyrës në Tezze sul Brenta (VI) rruga Villa Nr. 87, Itali, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në interes dhe për llogari të Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l. për të transferuar 100%(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar ose 100 (njëqind) kuotave të shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania"shpk si dhe shitjen e boxhit të shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" shpk.

Meqë ekzistojnë kushte paraprake, palët me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë kontratë për



Shitjen e Pjesëve të Kapitalit Themeltar (këtej e tutje si "Kontrata") sipas kushteve të mëposhtëme :

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

NENI -1- OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, pala Shitëse Shoqëria "New Paradise International" S.r.l, e cila zotëron 100 % (Njëqind përqind) të kuotave të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, me dëshirën e saj dhe kërkesën e blerësit, i shet dhe i transferon palës Blerëse, Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, e cila pranon dhe ble 100 % (Njëqind përqind) të pjesëve të kuotave në kapitalin e Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, të zotëruara nga Shitësi tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të tretëve, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to.

NENI -2- ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGIMIT

2.1. Pjesët prej 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk të zotëruara prej Shitësit, shiten (transferohen) tek Blerësi Shoqëria "Edil Al It" Shpk e cila pranon t'i blejë kundrejt çmimit në total prej € 997,230/00 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë Euro), vlerë për të cilin Blerësi nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi të.

2.2. Palët kontraktore në marrëveshje të përbashkët bien dakort, që dokumenti i vetëm zyrtar, i cili do të vërtetojë shlyerjen e çmimit, do të jetë konferma e transfertës bankare të pakthyeshme, e cila lëshohet nga banka për pagesën e bërë prej palës Blerëse, në favor të Shitësit, në ekzekutim të kësaj kontrate. Një kopje e faturës Bankare do t'i bashkangjitet kontratës.

2.3. Palët kontraktore, bien dakort që me *shlyerjen totale vlerave të parashikuara në nenin 2 dhe 3 të kësaj kontrate, pala Blerëse të depozitojë paranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, faturat përkatëse (konfermat bankare), dhe kjo e fundit të bëjë kalimet përkatëse.*

NENI 3 - DETYRIME TË TJERA

3.1 Pala blerëse merr përsipër të likujdojë borxhin që Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka kundrejt Shoqërisë "New Paradise International" SRL, të barabartë me një shumë prej Euro 1.002.770,00 (një milion e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë Euro) e regjistruar kjo në llogaritë e të dyja shoqërive, sipas deklaratës noteriale të datës 02.10.2000, pranë zyrës noteriale Pescara-s, Itali.

3.2. Palët kontraktore në marrëveshje të përbashkët bien dakort, që dokumenti i vetëm zyrtar, i cili do të vërtetojë shlyerjen e borxhit, do të jetë konferma e transfertës bankare të pakthyeshme, e cila lëshohet nga banka për pagesën e bërë prej palës Blerëse, në favor të Shitësit, në ekzekutim të kësaj kontrate. Një kopje e faturës Bankare do t'i bashkangjitet kontratës.



2. 3. Palët kontraktore, bien dakort që me *shlyerjen totale vlerave të parashikuara në nenit 2 dhe 3 të kësaj kontrate, pala Blerëse të depozitojë parandë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, faturat përkatëse (konfermat bankare), dhe kjo e fundit të bëjë kalimet përkatëse.*

NENI -4- DEKLARATA DHE GARANCI TË PALËVE


4.1 Përfaqësuesi Ligjor, **Z. Giovanni Panni**, i datëlindjes Maj, 27. 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm të Shoqërisë "New Paradise International" S. R. L., deklaron dhe garanton :

që shoqëria e përfaqësuar është themeluar rregullisht sipas të regjistracionit Italian.

- që nënshkimi i kësaj kontrate nuk bie ndesh me asnjë dispozitë të vetë statutit dhe me asnjë akt ligjor Italian.
- që përfaqësuesi i nënshkruar është i pajisur me të gjitha të drejtat dhe autorizimet e nevojshme për nënshkrimin e kësaj kontrate dhe që kjo kontratë është e vlefshme dhe detyruese për Shoqërinë "New Paradise International" S. R. L.
- që Shoqëria "New Paradise International" S. R. L, është pronare e vetme eskuzive e kuoave objekt i kësaj kontrate shitje.
- Që kuotat objekt kontrate, nuk janë objekt pengu dhe janë të lira nga çdo lloj titulli e natyre të të tretëve.
- Nëse do të gjykohet e nevojshme Shoqëria New Paradise International" S.R.L. do të marrë të gjitha masat që pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitjeje të Kuotave, para noterit shqiptar, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për depozitim e saj në Gjykatë, në zyrën e regjistrimit tregtar të shoqërive të Vicensës , Itali.
- Palët bien dakort se duke filluar nga data e regjistrimit të kësaj kontrate në gjykatë, Blerësi zëvendëson de juro Shitësin në drejtimin dhe administrimin e Shoqërisë, dhe duke filluar nga kjo datë ka të drejtë të arkëtojë kreditë si dhe të impenjohet të paguajë detyrimet që lindin që nga kjo datë kundrejt Shoqërisë.
- Në momentin që Shitësit arkëton çmimin e sipërpërmendur, ai humbet çdo të drejtë pronësie, mbi shoqërinë dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i të gjithë kapitalit të Shoqërisë.

4.2 Përfaqësuesi Ligjor, **Z. Genc Dulaku**, i datëlindjes Dhjetor, 19. 1967, lindur në Tiranë, Shqipëri në cilësinë e administratorit të ligjor të Shoqërisë "Edil Al It" Sh. P. K., deklaron dhe garanton :

- që shoqëria e përfaqësuar është themeluar rregullisht sipas të legjislacionit Shqiptar.
- që nënshkimi i kësaj kontrate nuk bie ndesh me asnjë dispozitë të vetë statutit dhe me asnjë akt ligjor Shqiptar.
- që përfaqësuesi i nënshkruar është i pajisur me të gjitha të drejtat dhe autorizimet e nevojshme për nënshkrimin e kësaj kontrate dhe që kjo kontratë është e vlefshme dhe detyruese për Shoqërinë "Edil Al It" Shpk.
- Që kjo kontratë është e vlefshme dhe detyruese për shoqërinë Blerëse "Edil Al. IT" Shpk.



- Që shoqëria "Edil Al. It" Shpk, është në dijeni të plotë të objektit të kësaj kontrate shitblerjeje të 100 % (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk., dhe ta pranojë atë në gjendjen që ajo ndodhet, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet e shitësit të sanksionuar në këtë kontratë, duke hequr dorë për heqjen e çdo kundërshtimi.
- Që Bleresi garanton Shitësin se pranon dispozitat e parashikuara në statutin e shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk " Shpk dhe garanton respektimin e plote te tyre.
- 3 Në këtë vision për gjendjen kantabël të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk., dhe ta pranojë atë në gjendjen që ajo ndodhet, duke hequr dore nga çdo perjashtim dhe per kete deklaron se merr përsiper çdo borxh dhe /ose pasiv që do të rezultojë për të shkuarën, të tashmen apo në të ardhmen duke e liruar plotësisht shitësin.

NENI -5- GARANCITË

5.1 Bleresi garanton Shitesin se pranojnë dispozitat e parashikuara në statutin e shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk " Shpk dhe garanton respektimin e plote te tyre.

5.1 Në momentin që Shitësi arkëton çmimin e sipërpërmendur, ai humbet çdo të drejtë pronësie, për drejtimin e shoqërisë dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi bëhet pronar i vetëm i ligjshem i të gjithë kapitalit të Shoqërisë.

NENI -6- BAZA LIGJORE



Kjo Kontratë, të drejtat dhe detyrimet e palëve do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 "Mbi shoqërite tregëtare „ dhe Ligjit Nr. 7667, datë 28. 01. 1993 Për regjistrin tregtar.

NENI -7- TRASHËGIMNIA DHE CEDIMI

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlerfshme midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre.

NENI -8- PËRMBAJTJA E KONTRATËS, NDRYSHIMET DHE SELITË E PALËVE

Çdo lloj kërkese për modifikim, për efekt të kësaj kontrate Palët zgjedhin selitë e mëposhtëme :

  5

1. Shoqëria „New Paradise International“ S.R.L“ në adresën : via Villa nr. 87, Tezze sul Brenta. (VI) Tel. +390424539696, Fax+390414536923, Itali.

Shoqëria E“Edil Al It „ Shpk në adresën : Rruga : “Perlat Rexhepi” pranë Karlsberg, Godina e re, Kat II, Tel: + 355 4 232452 / 271884 / 271885, Fax: +355 4 234941, e-mail: info@edilalit.com.al, Tiranë, Albania.

Modifikimi i selisë do të jetë i vlefshëm vetëm se do t`i komunikohet palës tjetër me letër rekomande A.R.

NENI -9- SHPENZIMET DHE TAKSAT

Shpenzimet legale dhe kontabile ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë kontratë, janë në ngarkim të pales blerëse.

NENI -10- ORIGJINALET

I bashkengjiten kësaj kontrate dhe përbëjnë pjesë integrale e saj :

- Çertifikata e Shoqërisë New Paradise International“ S.R.L, e lëshur nga Dhoma e Tregëtisë Industrisë Artizanatit Bujqësisë Vicenza, me Ceë. 7653/2006/CVI0529, datë 13. 07.2006.
- Vendim datë 07.07, 2006, i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “New Paradise International” S.r.l, me Nr. 169975 repertori, datë 17.07.2006, të Noterit Giuseppe Fietta, Vicenza Itali
- Vendim I Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “Edil Al-It” Shpk nr. Rep.7843 e nr.Kol.1274, para noterës Ruko Sako.

Kjo Kontratë hartohet ne 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të cilave u është bashkëlidhur versioni në gjuhën Italiane, të gjitha të nënshkruara nga palët në datën __.__.2006, për çdo mosmarëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose ekzekutinin e kësaj kontrate, versioni shqip do të jetë i vetimi version me efekt juridik provues për palët.

Une, Noterja, pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë palëve këtë kontratë, në prani të Përkthyesit të gjuhës Italiane_____ të njohur personalisht prej meje, konstatova se ata e gjetën përmbjatjen e saj, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, duke e nënshkruar atë

rregullisht para meje dhe unë Noteri i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

PALËT KONTRAKTORE


SHITËSI

SHOQËRIA "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S.R.L

Përfaqësuar nga :

Administratori Ligjor

Z. Giovanni Panni,





BLERËSI

SHOQËRIA "EDIL AL IT" SHPK

Përfaqësuar nga :

Administratori Ligjor

Z. Genc Dulaku



Z.

Përkthyes

**Ruko SAKO
NOTERE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk

V E N D I M

I

ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "Di Vincenzo Estero Albania" SHPK

Sot më datë 21. 03 2005, në Selinë e Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, të ndodhur në adresën : "Dëshmorët e 4 Shkurit", Pall. 27, Shk. 1, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie.

Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr 13264, datë 10. 01. 1996. me Seli të saj në adresën : "Dëshmorët e 4 Shkurit", Pall. 27, Shk. 1, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Shoqëria "New Paradize International" S.r.l, e cila zotëron 100 % të kuotave të kësaj shoqërie, në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7638, datë, 19. 11. 1992,

VENDOSI :

Ndryshimin e Selisë së Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk të ndodhur në Rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurit", Pall. 27, Shk. 1, Ap. 3, Tiranë, në adresën e mëposhteme :

- Bulevardi "Bajram Curri", Godina "European Trade Center" me 17 Kate, prapa Piramidës, Tiranë, Shqipëri.



Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregëtar, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në kolonën e regjistrimit tregëtar.

ORTAKU I VETËM

I SHOQËRISË "Di Vincenzo Estero Albania" SHPK

Shoqëria "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S. R. L.

PËRFAQËSUAR NGA :


Z. Giovanni Panni


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 499 REP.
Nr. — KOL.

V È R T E T I M

Sot, më datë 25. 03. 2005 (dymijë e pesë), përpara meje Artan Treska, Noterit pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Bull. "Bajram Curri", u paraqit personalisht :

SHOQËRIA "NEW PARADISE INTERNATIONAL" S. R. L. , shoqëri e të drejtës tregtare Italian, me seli në Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa n. 87, Itali, me Kod Fiskal e Nipt 02862300247, kapitali Shoqëror e deklaruar E. 90,000 (Nëntëdhjetë mijë Euro) i derdhur plotësisht, regj. Nr. 43998/2000 në regj. e shoqërive të Venczes, këtu përfaqësuar nga **Z. Giovanni Panni**, i datëlindjes Maj, 27. 1946, lindur në Tezze Sul Brenta, Itali në cilësinë e administratorit të vetëm, dhe të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, me banim për shkak të detyrës në Tezze sul Brenta (VI) alla via Villa Nr. 87, Itali, i cili më deklaroi se, sa më sipër është një Vendim i Ortakut të Vetëm dhe unë, Noteri e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTER

NOTER
ARTAN TRESKA
RR. BAJRAM CURRI
TEL. 0682140355.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 5913 REP

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

NR. 642 KOL

KONTRATE SHITJE-KAPITALI

Sot me date 07 Shkurtor 2000, ditën e Enjte, ne Dhomen e Noterise Tirane para meje noteres Shpresa Kurti, u paraqiten personalisht:

SHITES : SHOQERIA "DI VINCENZO ESTERO" shpk, me administrator Z.GIOVANNI DI VINCENZO,,e regjistruar ne regjistrin e Shoqerive te Chietit-Itali me Nr.234668/1996,me Kod Fiskal 04115911002,me seli ne S.Giovanni,si ortake e vetme e Shoqerise "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, regjistruar ne Gjykatën e rrethit Tirane me Vendimin Nr.13264/3 date 29.04.1999, e perfaqesuar nga Z.LUCIANO DAL PRATO,me pashaporte Nr..

BLERES: SHOQERIA " NEW PARADISE

INTERNATIONAL" perfaqesuar nga administratori unik

Z.GIOVANNI PANI,regjistruar ne Regjistrin Tregtar Nr.43998/2000 date 12.09.2000 te Vincenzas-ITALI,me Kod Fiskal e NIPT 02862300247,me seli ne Tezze sul Brenta Via Villa 87 Cap 36056, me pashaporte Nr.046885 V.

Te lartepemendurit jane madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se:

"SHOQERIA "DI VINCENZO ESTERO" shpk perfaqesuar nga Z.LUCIANO DAL PRATO, deklaroi se i shet me vullnet te lire dhe te plote Shoqerise italiane "NEW PARADISE INTERNATIONAL:" shpk,e cila pranoi ta blere,te gjithë kapitalin e shoqerise me vlere 111.845.000(njeqindenjembdhjetmiljon e teteqindedyzet e pesemije) leke, ku perfshihet pasuria e lujteshme dhe e palujteshme, te ndodhur ne Shqiperi,se bashku me te drejtat dhe detyrimet e shoqerise "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk. Ne marreveshje te perbashket te paleve çmimi i shit-blerjes eshte caktuar 1.665.000(njemiljon e gjashteqindgjashtedhjetepesemije) dollare USD, nga te cilat 700.000(shtateqindmije) dollare USA eshte paguar per likujdimin total te kuotave,ndersa 965.000(nendeqindgjashtedhjetepesemije) dollare USD jane paguar per likujdimin e kreditimeve te "DI VINCENZO ESTERO"srl ndaj "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk,shume te cilen e kane likujtuar me njeri tjetrin jashte kesaj zyre.Me kete shitje ortaku Shoqeria "DI VINCENZO ESTERO" shpk e humbat te drejten e pronesise mbi

SHOQERIA "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" sh.p.k

VENDIMI I
ASAMBLESE SE
JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE

Sot me date 28.10.2000 (dymije), Shoqeria "New Paradise International" Sh.p.k, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer 43998/2000 ne Vicenza, date 12.09.2000, me Kod Fiskal 02862300247, e perfaqesuar nga administratori unik GIOVANNI PANNI, i cili ne baze te nenit 12 te Statutit te Shoqerise ka te drejte te kryeje cdo lloj veprimi per perfaqesimin e shoqerise ne marrjen e vendimeve te asamblese se zakonshme e te jashtezakonshme, si ortak e vetme e SHOQERISE "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk. e regjistruar prane Gjykates se rrethit Tirane, Regjistrin Tregtar, me Vendimin Nr.13264/3 date 29.04.1999, me seli ne Tirane, rruga "Bab Rexha", Nr.31, me Nipt J72207013A, organizon mbledhjen e jashtezakonshme te Shoqerise "Di VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, me rend dite:

1.-Depozitim prane Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane te aktit te shitblerjes se kapitalit me Nr.4870 Rep., date 02.10.2000 te bere nga Noteri Z.GIOVANNI DI PIERDOMENICO, Noter ne Pescara-ITALI, me vlere 1.665.000 (njemiljon e gjashteqindgjashtedhjet e pesemije) dollare USD nga shoqeria "Di Vincenzo Estero" shpk, nga te cilat 700.000 (shtateqindmije) dollare USD jane paguar per blerjen totale te kapitalit te Shoqerise, ndersa 965.000 (nendeqindgjashtedhjetepesemije) dollare USD jane paguar per likuidimin e kredive qe "DI VINCENZO ESTERO" srl ka pasur ndaj "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, duke u bere ortak i vetem i kesaj shoqerie; shoqeria "New Paradise International" shpk.

2.-Kapitali i Shoqerise do te jete ne shumen 111.845.000 (njeqindnjemdhjetmiljon e teteqindedyzetepesemije) leke..


3.-ADMINISTRATORET e Shoqerise "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk do te jene te jashtem Z.ADRIAN DULAKU dhe Z.MATTEO SCALCO, te cilet vetem per shitjen e pallateve duhet te neneshkruajne te dy ne te njejten kohe.

4.Objekti i Shoqerise mbetet ajo e Shoqerise "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk.

5.Afati i Shoqerise do te jete ai i percaktuar nga Shoqeria "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk, deri ne 50 vjet.

6.Seli e Shoqerise do te ndryshohet nga adresa egzistuse "Bab Rexha", Nr.31 ne adresen : Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pall.27, shkalla 1, Ap.3, TIRANE. Ne perfundim te mbledhjes se jashtezakonshme, u vendos te miratohet sa siper dhe per neneshkrimin e kerkese per depozitim te dokumentave prane Regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane emerohet Z.ADRIAN DULAKU, i cili ka te drejte qe te beje dhe veprimet per depozitim e dokumentacionit prane asaj Gjykate.

SHOQERIA "DI VINCENZO ESTERO ALBANIA" shpk
ORTAKU I VETEM
SHOQERIAS "NEW PARADISE INTERNATIONAL" shpk



PROCESVERBAL I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE
ORTAKUT
TE
DV-Focus SH.P.K.

Në vitin 1999 në ditën e martë të muajit Janar më
 në Tiranë, në praninë e Noterisë Publike, Shprehe Jaurb
Noteria Publike caktoi fruktlyesën, dhe Sijetllaus Rokanë në
kapacitetin e tij si përkthyes, në prezencën edhe të anëtarëve të
poshtëshënuar të *Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.K.*, një shoqeri e cila
ekziston sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Di Vincenzo Estero S.r.l., përfaqësohet nga Z. Giovanni Di Vincenzo në
kapacitetin e tij si administrator i vetëm i shoqerise.

Z. Giovanni Di Vincenzo është caktuar që të drejtojë mbledhjen dhe dhe ai
fton të poshtëshënuarin Luciano Dal Prato të veprojë si sekretar.

Kryetari i mbledhjes përcakton se i gjithë kapitali i ortakut është paraqitur,
dhe kësisoj deklaron se mbledhja është e mirëqënë dhe se ajo mund të
diskutojë mbi këto çështje

AXHENDA

1. Amendamente ndaj Neneve të Statutit, duke përfshirë ndërrimin e emrit të shoqerisë nga DV Fokus Sh.p.k. në Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.k.
2. Caktimin e anëtarëve të Bordit të Drejtuesëve dhe të Kryetarit të saj.
3. Caktimin e Bordit të Revizionimit.
4. Të tjera.

Duke kaluar në çështjen e parë të axhendës, Kryetari informon se me
Marëveshjen e Transfertave të Aksioneve e nënshkruar më 26.01.1999,
kompania Penang Shipbuilding & Construction ("PSC") ia ka shitur Di
Vincenzo Estero S.r.l ("DVE") të gjitha kuotate shoqerise DV Fokus Sh.p.k. Si



pasoje e kesaj Marrëveshjeje Di Vincenzo Estero S.r.l është pronari i të 100% të kapitalit të Shoqerise.


Kryetari propozon që:

a) Nenet e Statutut të DV FOCUS Sh.p.k. të ndryshohen si më poshtë:

STATUTI

Neni 1

Emri dhe forma ligjore e Shoqerise



Shoqeria "Di Vincenzo Estero Albania" Sh.P.K. e quajtur shkurtimisht "D.V.E. Albania Sh.P.K;" u themelua në formën e një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqeria është një person juridik në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, që kryen aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, Veprës së Inkoperimit dhe Neneve të Shoqerise që vijojnë.

Neni 2

Objekti i Shoqerise

Shoqeria do të kryejë projekte dhe ndërtime ndërtesash, do të kryejë zbatimin e ndërtimit; menaxhimin e ndonjë ndërtese e cila është projektuar dhe/ose ndërtuar nga Shoqeria; do të marrë, shesë, japë me qera dhe do të menaxhojë tokën, ndërtesat, asetet e lëvizshme dhe të palëvizshme.

Për të përmbushur objektin e sipërpërmendur, Shoqeria ka gjithashtu të drejtë që të kryejë aktivitete që rrjedhin dhe kanë lidhje me të.

Më tej, Shoqeria ka të drejtë të menaxhojë dhe të marrë pjesë në aktivitete të tjera përveç atyre që përfshihen në paragrafin e parë të këtij neni (2), qofshin ato direkte apo indirekte, dhe të bëjë investime të çdo lloji në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqeria ka gjithashtu të drejtë për t'u futur në xhoint-vençërs (ndërmarrje të përbashkëta) me partnerë të huaj dhe/ose

Shqipëtarë, me kusht që aktivitetet e tilla të mos bien ndesh me zbatimin e legjislacionit shqipëtar.

Brenda kuadrit të këtyre Neneve të Shoqerise, të gjitha veprimet financiare, industriale, tregëtare dhe komerciale që kanë të bëjnë me pronat e lëvizshme dhe të palëvizshme të cilat vlerësohen si të dobishme për të kryer, në mënyrë direkte apo indirekte, objektin e sipërpërmendur; për këto qëllime, Shoqëria ka të drejtë që të ngrejë degë në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë shtetit dhe gjithashtu të ketë interesa ose pjesëmarrje, në mënyrë direkte apo indirekte, në kompani, fondacione, shoqata, ndërmarrje të tjera shqipëtare dhe të huaja, dhe në Xhoint Vençërs të inkorporuara ose të painkorporuara me palë Shqipëtare dhe të huaja.

Neni 3

Zyra e Regjistruar - Rezidenca e Shoqerise

Zyra e regjistruar e Kompanisë është në Tiranë (Republika e Shqipërisë), Rr. Babë Rexha 31, 1, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Shoqëria, me vendim të Bordit të Drejtuesëve ose të Drejtorit të Vetëm, ka të drejtë që të krijojë, transferojë dhe/ose të mbyllë çdo zyrë administrative, zyrën qendrore, zyrat respektive dhe agjensitë në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë shtetit.

Rezidencat e ortakut, përsa i përket marrëdhënieve të tyre me Shoqërinë, janë rezidencat të treguara në Librin e Ortakut.

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqerise

Kohëzgjatja e Shoqërisë është 100 (njëqind) vjet. Ortaket kanë të drejtë ta rrisin kohëzgjatjen e Shoqërisë ose të vendosin për shpërbërjen e saj.

Neni 5

Detyrimet e Shoqerise

Shoqeria nuk mban përgjegjësi për detyrimet e ortakut të saj.

Neni 6

Libri i ortakut

Çdo e drejtë blerëse për një apo më shumë kuota te shoqerise duhet të kryhet në përputhje me rregjistrimin përkatës në Librin e Ortakeve; deri sa të jetë kryer rregjistrimi në fjalë, ai nuk do të konsiderohet ortak.

Çdo rregjistrim në Librin e Ortakeve duhet të tregojë emrin e blerësit, sasinë e aksioneve që zotëron blerësi dhe prokurën e blerjes.

Libri mbahet nga sekretari i Kompanisë, i cili duhet të nxjerrë informacion prej tij për çdo ortak që do të kërkojë.

Çdo regjistrim në libër shkruhet dhe firmoset nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Shoqerise me paraqitjen, nga blerësi i interesuar, e një dokumenti që dëshmon pronësinë e kapitalit.

Përveç formaliteteve të mësipërme, secilit ortak i kërkohet gjithashtu që të regjistrohet në Regjistrin e Shoqerise në Gjykatë të Tiranës, sasinë e kuotave që ai ka në Shoqeri, duke paraqitur në Regjistrin e përmendur një kopje të dokumentit që dëshmon pronësinë e tij. E njëjta procedurë duhet të ndiqet në lidhje me çdo angazhim për çdo ortak te shoqerise.

Neni 7

Kapitali i Ortakut

Kapitali kuotave te shoqerise eshte njëqinenjimbëdhjetmilionetetëqindedyzetepesëmijë (111,845,000) lek i ndarë në 111,845 aksione me nga 1,000 lek secili.

Neni 8

Transferta e Kuotave

Kushdo që kërkon të transferojë, për cilëndo arsye, çdo kuot te shoqerise që posedohet prej tij ("Transferuesi Kërkues") duhet që t'ua bëjë të ditur synimin

e tij anëtarit (anëtarëve) të tjerë të Shoqërisë me anën e postës rekomande, duke treguar emrin e personit potencial që do t'i niset transferta dhe çmimin e rënë dakord ("Njoftimi i Transfertës").

Çdo anëtar që merr Njoftimin e Transfertës duhet të lajmërojë për refuzimin apo pranimin për sa i takon transferimin e kuotes, me letër rekomande që duhet t'i dërgohet Transferuesit e Interesuar jo më vonë se sa 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së Njoftimit të Transfertës.

Në qoftë se ndonjë anëtar që merr Njoftimin e Transfertës nuk kthen përgjigje as pozitive dhe as negative brenda periudhës së 30 (tridhjetë) ditëve të mësipërme, atëhere pranimi do të merret si i mirëqenë, me kusht që personi marrësi mundshëm pranon me shkrim Nenet e Shoqërisë.

Klauzolat e mësipërme nuk janë të zbatueshme në rastin e transferimit të aksioneve nga njëri anëtar tek tjetri.

Në qoftë se Transferuesit të Interesuar i jepet një përgjigje mospranimi nga njëri prej Ortakeve në bashkëvajtje me kushtet dhe termat e parashtuara mësipër, atëhere ortaku në fjalë do t'i ofrohen çdo njërit prej Ortakeve që nuk është dakord për transfertën ndaj marrësit të synuar me çmimin e ofruar nga ky i fundit për marrjen e aksioneve të përmendura. Në rast refuzimi, Aksioneri që kërkon t'i transferojë kuoten e tij do të jetë i lirë që t'ia shesë ato një pale të tretë.

Neni 9

Regjistrimet e Llogarive

Veprimet e llogarisë kryhen nga Shoqëria sipas klauzolave mbi llogarinë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe pasqyrohen me besnikëri në bilancin vjetor.

Neni 10

Transaksionet Financiare

Shoqeria ka te drejte qe te marrë kredi dhe financim nga çdo bankë ndërkombëtare, të huaj dhe lokale, dhe nga institucione financiare, shoqeri e tretë si edhe nga ortakët e saj.

Neni 11

Fondi Rezervë dhe Deklarata Financiare

Shoqeria ka të drejtë që të krijojë një një Fond Rezervë dhe fonde të tjera speciale.

Bordi i Drejtorëve ose Drejtori i Vetëm do të caktojë përbërjen, sasinë, dhe burimin e fondeve, përdorimin dhe rregulloren e secilit fond në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Asetet e Shoqerise pasqyrohen në bilancin të shprehura në monedhën shqiptare dhe në një monedhë tjetër të huaj sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve, duke përfshirë midis tyre edhe monedhën EURO.

Bilanci dhe llogaria e fitimit dhe humbjes së Shoqerise përgatiten nga Bordi i Drejtorëve ose Drejtori i Vetëm në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Viti fiskal i Kompanisë mbaron më 31 dhjetor të secilit vit dhe bilanci përkatës duhet të dorëzohet në Mbledhjen e Zakonshme të Ortakeve për miratim përpara 31 marsit të vitin që pason, ose në një datë të mëvonshme të cilën e vendos Bordi i Drejtorëve apo Drejtori i Vetëm në përputhje me ligjshmërinë shqipëtare.

Neni 12

Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve

Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve:

- (a) aprovon bilancin vjetor;
- (b) cakton anëtarët e Bordit të Drejtorëve ose Drejtorin e Vetëm;

(c) cakton Kryetarin e Bordit të Drejtorëve dhe, nëse është e nevojshme, Zëvendës Kryetarin;

(d) përcakton përgjegjësitë e Drejtorëve;

(e) vendos për pagesën e Drejtorëve.

Kryetari i Bordit të Drejtorëve, ose Drejtori i Vetëm, do të thërrasë Mbledhjen e Zakonshme të Ortakeve të paktën një herë në vit, me anën e njoftimit me shkrim, që do të dërgohet me postë rekomande, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para datës së planifikuar të mbledhjes, dërguar ortakeve të cilët kanë qënë të regjistruar në Librin e Ortakeve të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së fiksuar për mbledhjen.

Një lajmërim i tillë do të dërgohet në adresën e rezidencës që është shënuar në Librin e Ortakeve.

Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve zhvillohet kur përfaqësohet të paktën 1/2 (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, dhe merr vendime kur këto të fundit miratohen nga shumica e kapitalit të kuotes se Ortakeve që marrin pjesë në mbledhje.

Në rastet kur nuk bihet dakord me ndonjërin nga formalitetet që përmenden më sipër, Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve konsiderohet si e mirëqenë, nëse përfaqësohet i gjithë kapitali.

Çdo rezolutë që del nga takimi i dytë ose i parë aprovohet nga shumica absolute e kapitalit që merr pjesë në mbledhje.

Çdo kuote i jep të drejtën një vote. Ortaket mund të përfaqësohen nga përfaqësuesët e tyre ligjorë ose nga ndonjë person tjetër, të cilit nuk i kërkohet të jetë ortak, duke paraqitur dokumentin me shkrim për mbledhjen përkatëse.

Kryetari i Mbledhjes së Zakonshme të Ortakeve është Kryetari i Bordit të Drejtorëve, ose Drejtori i Vetëm. Kryetari do të caktojë një sekretar të cilit nuk i kërkohet që të jetë Ortak.

Procesverbali i Mbledhjes së Zakonshme do të mbahet nga sekretari dhe do të firmoset nga Kryetari.

Vendimet e aprovuara nga Mbledhja e Zakonshme e Ortak janë të detyrueshme për të gjithë Ortaket, pavarësisht nëse ata mungojnë ose nuk janë dakord.

Neni 13

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Ortakeve

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Ortakeve merr vendime për këto çështje:

- (a) amendamentet e Neneve të Shoqerise;
- (b) rritjen apo uljen e kapitalit të ortakeve;
- (c) shpërbërjen e shoqerise;
- (d) caktimin e fuqive të likuidatorëve;
- (e) çështje të tjera të cilat ligjet e Republikës së Shqipërisë i përshkruajnë ekskluzivisht për Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Ortakeve;

Mbledhje e Jashtëzakonshme e Ortakeve duhet të thirret sa herë që është e nevojshme, me lajmërim me shkrim që iu dërgohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së caktuar të mbledhjes, Ortaket e të cilët kanë qënë të regjistruar në Librin e Ortakeve të paktën 20 (njëzetë) ditë para datës së caktuar të mbledhjes.

Një lajmërim i tillë do të dërgohet në adresën e treguar në Libërin e Oratkeve.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Ortakeve quhet e vlefshme kur Ortaket që përfaqësojnë të paktën 1/2 (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, dhe merr

vendime të vlefshme kur këto të fundit aprovohen nga shumica e kapitalit të Ortakeve të pranishëm në mbledhje.

Çdo kuote i jep të drejtën një vote. Ortaket mund të përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre ligjorë ose nga ndonjë person tjetër, të cilit nuk i kërkohet që të jetë ortak, duke paraqitur një dokument me shkrim në mbledhjen përkatëse.

Kryetari i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Ortakeve është Kryetari i Bordit të Drejtorëve, ose Drejtori i vetëm. Kryetari do të caktojë një sekretar të cilit nuk i kërkohet të jetë ortak. Procesverballi i Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Ortakeve do të mbahet nga sekretari dhe do të firmoset nga Kryetari.

Rezolutat e Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Ortakeve mund të aprovohen gjithashtu me konsultim me shkrim të ortakeve, në qoftë se të gjithë aksionerët e japin pëlqimin e tyre me shkrim.

Vendimet e aprovuara nga Mbledhja e Jashtëzakonshme e Ortakeve janë të detyrueshme për të gjithë ortaket, pavarësisht nëse ata mungojnë apo nuk janë dakord.

Neni 14

Procesverbalet

Mbledhja e Jashtëzakonshme ose e Zakonshme do të mbahet me procesverbale përkatëse.

Rezolutat e aprovuara në Mbledhjen e Jashtëzakonshme dhe të Zakonshme, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe këto Nene të Shoqërisë janë të detyrueshme për të gjithë Ortaket, pavarësisht nëse mungojnë apo nuk janë dakord.

Procesverbalet e Mbledhjeve të Jashtëzakonshme dhe të zakonshme mbahen nga sekretari i caktuar nga Kryetari i Mbledhjes, dhe firmosen nga Kryetari i mbledhjes.

Neni 15

Thirrja e Mbledhjes

Mbledhja e Jashtëzakonshme dhe e Zakonshme e Ortakeve mund të thirret gjithashtu edhe me letër faks që i dërgohet secilit ortak, me kusht që, në të njëjtën kohë lajmërimi i parashkruar të dërgohet edhe me letër rekomande, të paktën të nesërmen.

Duke patur në konsideratë se Shoqeria formohet nga ortake të huaj, Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve mund të zhvillohet ose në Shqipëri ose jashtë shtetit.

Lajmërimi me shkrim për mbajtjen e mbledhjes duhet të përbajë këto të mëna:

- (a) kohën dhe datën e mbledhjes, të shprehura në shifra dhe fjalë;
- (b) vendin e mbledhjes, të shprehur në mënyrë të plotë;
- (c) pikat e rendit të ditës, të specifikuara dhe të rrjeshtuara me rend numerik.

Lajmërimi do të bëhet në gjuhën angleze.

Në rastet kur nuk bihet dakord me ndonjërin nga formalitetet e mësipërme, lajmërimi quhet i pavlevshëm. Pavarësisht nga kufizimi i mësipërm, Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve quhet ligjrisht e mbledhur, në qoftë se përfaqësohet i gjithë kapitali.

Neni 16

Bordi i Drejtorëve -- Drejtori i Vetëm

Shoqeria menaxhohet nga Bordi Drejtues ose nga Drejtori i Vetëm.

Mbledhja e Zakonshme e ortakeve ka të drejtë të caktojë anëtarët e Bordit Drejtues dhe Kryetarin e saj ose alternativisht një Drejtor të Vetëm.

Bordi i Drejtorëve do të përbëhet nga një minimum prej 3 (tre) dhe nga një maksimum prej 5 (pesë) anëtarësh. Drejtorëve nuk iu kërkohet që të jenë ortake.

Caktimi i drejtorëve apo i drejtorit të vetëm bëhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare, nëse nuk ripërtërihet. Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve ka të drejtë të revokojë emërimin e njërit apo më shumë Drejtorëve dhe të Drejtorit të Vetëm para datës së mbarimit të afatit të detyrës.

Bordi i Drejtorëve do të thirret sa herë që Kryetari e quan të nevojshme dhe sa herë që kërkohet nga ndonjëri nga Drejtorët e Shoqerise.

Bordi i Drejtorëve ose Drejtori i Vetëm do të caktojë, në çdo mbledhje, një sekretar të cilit nuk i duhet të jetë anëtar i Bordit.

Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve ose të vendimeve të Drejtorit të Vetëm duhet të shkruhen në një libër të veçantë dhe do të jenë të vlefshëm vetëm në qoftë se firmosen nga Kryetari dhe nga Sekretari.

Bordi i Drejtorëve është i vlefshëm kur merr pjesë në mbledhje shumica e drejtorëve dhe merr vendime të vlefshme kur këto të fundit aprovohen nga shumica e Drejtorëve që marrin pjesë në mbledhje.

Në raste dorëheqjeje, vdekje, apo revokimi të njërit apo më shumë drejtorëve, Drejtorë të tillë do të zëvendësohen me anën e një vendimi të Bordit të Drejtorëve. Anëtarët zëvendësues qëndrojnë në detyrë deri në Mbledhjen e ardhshme të Zakonshme të ortakeve.

Bordi i Drejtorëve, ose Drejtori i Vetëm, ka fuqi të plotë menaxhuese, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme me përjashtim të asaj që parashtrohet në nenin 12 dhe 15 në lidhje me fuqinë e Mbledhjes së Zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Ortakeve.

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve mund të mbahen në Shqipëri ose jashtë shtetit.

Secili anëtar i Bordit të Drejtorëve ka të drejtën vetëm të një vote.

Neni 17

Kryetari

Kryetari i Shoqerise është Kryetari i Bordit të Drejtorëve dhe ai është anëtar i Bordit, ose Drejtori i Vetëm.

Ai zbaton vendimet e marra nga Bordi i Drejtorëve dhe nga Mbledhjet e Jashtëzakonshme dhe të Zakonshme të Ortakeve.

Kryetari ka firmën e Shoqerise dhe është përfaqësuesi ligjor i Shoqerise para palëve të treta. Kryetari organizon veprimtarinë e Bordit të Drejtorëve.

Kryetari, në marrëdhënie me akte të vetme apo kategori aktesh, ka të drejtë delegojë tek persona të tretë, gjithashtu jo nëpunës të Shoqerise, një pjesë të fuqisë së tij, duke përfshirë fuqinë për të përfaqësuar Shoqerine.

Neni 18

Menaxheri i Përgjithshëm

aktiviteti i operacioneve të shoqerise, me vendim të Bordit të Drejtorëve ose të Drejtorit të Vetëm, kryhet nga Menaxheri i Përgjithshëm.

Menaxheri i Përgjithshëm do të emërohet nga Bordi i Drejtorëve ose nga Drejtori i vetëm.

Menaxheri i Përgjithshëm, në qoftë se emërohet, përfaqëson trupin ekzekutiv të shoqerise dhe mund të fuqizohet nga Bordi i Drejtorëve ose nga Drejtori i Vetëm për:

- a) të zbatuar vendimet e Bordit të Drejtorëve ose të Drejtorit të Vetëm dhe vendimet që aprovohen nga Mbledhja e Jashtëzakonshme dhe e Zakonshme e Aksionerëve;
- b) të organizuar dhe gjykuar punën për të realizuar qëllimin e shoqerise, duke i raportuar Bordit të Drejtorëve apo Drejtorit të Vetëm;
- c) të menaxhuar asetet dhe pronat e Kompanisë, duke përfshirë burimet financiare, në përputhje me udhëzimet e Bordit të Drejtorëve ose të Drejtorit të Vetëm;

d) të menaxhuar dhe kontrolluar aktivitetet e degëve dhe agjensive të shoqërisë;

e) të përfaqësuar Shoqërisë në përfaqësime specifike të Kryetarit të Bordit të Drejtorëve ose të Drejtorit të Vetëm, para Autoriteteve të arbitrazhit dhe juridike dhe para palëve të treta, si edhe para Autoriteteve dhe Institucioneve të huaja dhe shqipëtare.

f) të deleguar tek palë të treta, të caktuara si përfaqësuese, pjesë të fuqisë së tyre, me përkatësi specifike për akte të veçanta ose kategori aktesh. Përfaqësuesë të tillë kanë përgjegjësi sipas shkallës së funksioneve dhe fuqisë që iu është deleguar;

g) të ekzekutojë, me emrin dhe për Shoqërisë, kontrata të çdo natyre dhe lloji;

h) të bërë çdo pagesë të detyrueshme për Shoqërisë, të marrë në punë dhe të largojë nga puna punonjës të Shoqërisë dhe të firmosë kontrata e duhura.

Menaxheri i Përgjithshëm ka fuqinë të bëjë pagesa deri në një sasi maksimale që caktohet nga Bordi i Drejtorëve dhe nga Drejtori i Vetëm.

Neni 19

Bordi i Revizionimit

Mbledhja e zakonshme e Ortakeve ka të drejtë të emërojë një Bord Revizionimi.

Në qoftë se ngrihet, Bordi i Revizionimit është i përbërë nga tre revizorë dhe dy revizorë alternativë.

Revizorët dhe Revizorët Alternative do të emërohen nga Mbledhja e Zakonshme e Ortakeve për një periudhë prej tre vjetësh, dhe mundet që të ri-emërohen. Si Revizorët ashtu edhe Revizorët Alternativë duhet të jenë ekspertë llogarije.

Bordi i Revizionimit do të ketë detyrën për të kontrolluar operacionin dhe menaxhimin e Shoqërisë në përputhje me Nenet e Shoqërisë, me ligjet e

herëpashërëshme në fuqi në Shqipëri dhe me me parimet përkatëse ndërkomëtare të llogarisë.

Bordi i Revizionimit do të raportojë direkt të dhënat dhe opinionet tek Ortaket.

Neni 20

Mbyllja

Shoqeria do të mbyllet në rast:

- (a) të mbarimit të afatit të caktuar për vjetërsinë e saj;
- (b) kur shoqeria nuk është në gjendje të realizojë objektin e saj;
- (c) të vendimit të Mbledhjes së Jashtëzakonshme për këtë qëllim.

Neni 21

Likujdimi

Likujdimi i Shoqerise do të bëhet në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë që janë në fuqi në kohën e likujdimit.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Shoqerise do të përcaktojë kushtet teknike të likujdimit dhe do të caktojë një apo më shumë likujdatorë, të cilëve nuk iu kërkohet të jenë ortake, të caktojë fuqinë dhe pagesën e tyre.

Hartuar, lexuar dhe ekzekutuar në Tiranë më _____

Pas një diskutimi të gjatë Mbledhja e Jashtëzakonshme e Ortakeve.

APROVON

Propozimin e mësipërm siç është formuluar nga Kryetari.

Me propozimin e Kryetarit, një kopje e Neneve të Shoqerise së Kompanisë po bashkangjitetet këtu poshtë Aneksit "A".

Bordi i Drejtorëve përbëhej nga tre anëtarë.

Pas një diskutimi të gjatë Mbledhja e Jashtëzakonshme e ortakeve

APROVON

Të ngrejë një Bord Drejtorësh të përbërë nga tre anëtarë dhe cakton drejtorët e poshtëshënuar:

- Giovanni Di Vincenzo, lindur në Chieti (Itali) më 08/09/1952, nr. i pasaportës italiane 453416, shtyreje e afatit më 07/04/95.
- Luciano Dal Prato, lindur në Faenza (Itali) më 24 mars 1948, nr. i pasaportës italiane 581510M, lëshuar më 27.03.1995.
- Aldo Agata, lindur më 04.06.1947 në Santa Maria a Vico, nr. i pasaportës italiane 710807*, lëshuar më 14.06.1993

Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakeve, njëzëri, gjithashtu

APROVON

Të emërojë Z Giovanni Di Vincenzo Kryetar të Bordit të Drejtorëve.

Duke kaluar në pikën e tretë të rendit të ditës, Kryetari propozon që ta shtyjë caktimin e anëtarëve të revizionimit.

Duke mos patur gjë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, mbledhja mbyllet në

SEKRETARI

KRYETARI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 459 rep.
Nr. _____ kol.

VERTETIM

Sot, me daten 26.01.1999 (njezete e gjashte janar nje mije e nenteqind e nentedhete e nente), dite e marte, para meje Noteres se Dhomes se Notereve Tirane, Shpresa Kurti, me seli ne Krugen e Durrës, m'u paraqit ortaku i vetem i shoqerise DV-Focus, perfaqesuar nga Giovanni Di Vincenzo, perfaqesues me prokuren No.22362, date 14.01.1999, te vertetuar nga noteri i Peshkës, me pasaporte me No.453416G, ne prani te perkthyeses Svetllana Roko, me deklaroi se sa siper eshte nje proces-verbal i asamblese se jashtezakoneshme, i redaktuar jashte kesaj zyre, ne gjuhen angleze, te cilen e nenshkruan me vullnetin e tij te lire dhe te plote ne Zyren e Noterise Tirane. Une, noterja e vertetoj rregullisht.

Perkthyes: Svetllana Roko



NOTERE



Shpresa KURTI



DI VINCENZO ESTERO Sh.p.k.

Shoqeri me nje ortak
Via Aterno No.78.Loc.Sambuceto
66020 - SAN GIOVANNI TEATINO (CH)

Kapitali social: L.100.000.000 i.v
Regjistruar ne Regjistrin e Ndermarrjeve te Chieti-t ne No.234668/1996
Kodi fiskal 04115911002 - Pjesa e TVSH 01767350695

PROÇES-VERBAL I ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TË ZAKONESHME

Ne daten 28 te muajit dhjetor 1998, ne oren dhjete e tridhjete, prane selise legale, u mblodh Asambleja e Zakoneshme e Shoqerise.

Ne baze te Statutit Social , president eshte Administratori Unik, Ing.Giovanni Di Vincenzo, ndersa, per te kryer funksionin e sekretarit, eshte thirrur Z.Luciano Dal Prato.

Presidenti e konsideron mbledhjen te vlefshme, duke qene se eshte i perfaqesuar i gjithe kapitali social, dhe pikerisht:

IGEFI S.r.l. me seli legale ne San Giovanni Teatino (CH), lokaliteti Sambuceto ne rrugen Aterno No.78, me personin e Z. Dino Di Vincenzo.

Presidenti

deklaron se

Asambleja eshte mbledhur ne menyre legale dhe te vlefshme per te diskutuar dhe vendosur mbi sa me poshte vijon:

RENDI I DITES

1) Blerja e kuotave sociale, qe perbejne 80% te kapitalit social te DV-Focus Sh.p.k., Tirana (Albania) dhe nenshkrimin e akteve qe lidhen me të.

Heqja dore nga veprimi gjyqesor i ndermarre prane Gjykates se Tiranes kunder Shoqerise Maleziane Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD, Kuala Lumpur.

2) Te ndryshme dhe eventuale

Presidenti shtron piken e pare te Rendit te Dites.

1. Objekti - Blerja e kuotave sociale, qe perbejne 80% te kapitalit social te DV-Focus SH.p.k, Tirana (Albania) dhe nenshkrimi i akteve qe lidhen me të. Heqja dore nga veprimi gjyqesor i ndermarre prane Gjykates se Tiranes kunder Shoqerise Maleziane Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD, Kuala Lumpur.

E merr fjalen Presidenti per t'i kujtuar ortakut te IGEFI-t se qysh nga muaji nentor 1996 Shoqeria kishte marre iniciativen per te zhvilluar nje projekt te ri ne Shqiperi, projekt i cili kishte te bente me realizimin e nje kompleksi ndertimor, te quajtur World Trade Center Tirana.

Shoqeria, nepermjet deges qe kontrollohet prej saj, DVE Sh.p.k-Tirana (Albania), kishte pas bledhur me pare terrenin prej rreth 4.000 meter katrore, terren i cili ndodhet ne qendren historike te kryeqytetit shqiptar.

Ne muajin nentor 1996 Shoqeria nenshkroi me Shoqerine maleziane Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD nje marreveshje, e cila parashikonte nje seri detyrimesh reciproke, midis te cilave:

- Shitjen nga DVE S.r.l. tek Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD te 80% te kuotave qe perbenin kapitalin social te Shoqerise DVE Sh.p.k-Tirana;

- Ndryshimin, per pasoje, te Statutit social te DVE Sh.p.k. me ndryshimin e bazes sociale nga DVE Sh.p.k. ne DV-Focus Sh.p.k.;

- Rritjen,e kapitalit social te DV - Focus Sh. p. k. deri ne 7 milione dollare USA, nepermjet akteve te mevonshem, qe do te behej sipas nje plani definitiv, me qellim qe t'i siguronin shoqerise burimet financiare minimale te domosdoshme per te nisur projektin;

- Njohjen nga ana e Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD ne favor te DVE S.r.l. te nje kompensimi per aktivitetin e kryer tashme prej DVE S.r.l., prej 1.400.000 USD, qe do te ishte si kunderpagese per derdhjen nga ana e Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD te kuotes (20%) qe i perket DVE per çdo rritje te kapitalit social deri ne arritjen e shumes prej 7.000.000 USD.

- Pagimin DVE S.r.l. te kredive financiare dhe tregtare qe rrjedhin nga shpenzimet e bera deri ne ate moment per zhvillimin e projektit.

Ne muajt janar e shkurt 1997 ne Shqiperi u kryen operacionet e transferimit te 80% te kapitalit social, modifikimi i Statutit Social te DVE Sh.p.k. (e cila qysh atehere do te quhej DV-Focus Sh.p.k.) dhe rritjet e para te kapitalit social.

Pas nisjes se fazes se pare te nderhyrjes, ortakut i ri malezian nuk i vazhdoi me detyrimet e tij dhe qe ne ate moment zhvillimi i projektit u nderpre.

Shoqeria DVE S.r.l. u perpoq per nje kohe te gjate t'i kerkonte ortakut malezian te kryente detyrimet e veta, por perpjekjet e saj nuk dhane rezultat.

Ne gjysmen e dyte te vitit 1998 Shoqeria u detyrua pastaj te ndermernte nje nje akt legal prane Gjykates se Tiranes, ne menyre qe te mund t'i shlyheshin kreditimet e veta.

Ndërkohe qe procesi gjyqesor kishte filluar, ortakut malezian Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD manifestoi gadishmerine e tij per nje zgjidhje kompromisi, e cila përfshikon kryesisht pikat e meposhteme:

1. Kthimin DVE S.r.l te kuotave sociale, te cilat perbejne 80% te kapitalit social te DV - Focus Sh.p.k. me çmimin prej nje dollar amerikan;
2. Heqjen dore nga ana e DVE te vazhdimet te procesit gjyqesor prane Gjykates se Tiranes kunder ortakut malezian;
3. Heqjen dore nga ana e DVE nga pretendimi ndaj çdo lloj kompensimi tjeter te çfaredo lloji e natyre, duke perfshire aty edhe kompensimin prej 1.400.000 USD.

Gjate diteve te kaluara vazhduan tratativat me ortakun malezian ne menyre qe brenda nje kohe te shkurter te arrihet ne perfeksionimin e marreveshjes.

Presidenti ben leximin e plote te projekt dokumentave qe jane duke u perpiluar.

Ne fund te prezantimit te tyre, pas nje diskutimi te gjere, Asambleja e zakoneshme

aprovon me unanimitet:

a- qe te arrihet ne nje marreveshje kompromisi me ortakun malezian me termat e permendura me lart;

b - te riblihen prej Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD kuotat qe perbejne 80% te kapitalit social te DV-Focus SH.p.k. me çmimin prej nje dollar amerikan;

c - t'i behet prokure e veçante Administratorit Unik, Ing. Giovanni Di Vincenzo, lindur ne Chieti (Itali) me 8/9/1952 dhe banues ne Pescara, Strada Vicinale Francescone No.19, me pasaporte No.453416G, leshuar nga Kuestura e Pescara-s me 4/4/1990, per te vazhduar tratativat me Shoqerine Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD me qellim per te arritur ne nje marreveshje kompromisi, per te nenshkruar te gjitha aktet e nevojeshme per perfeksionimin e marreveshjes se kompromisit dhe per blerjen e kuotave sociale, duke i dhene njekohesisht mandat te plote per te perfunduar operacionin, me premtimin per te ratifikuar e quajtur te vlefshem veprimet e tij.

f- t'i behet prokure e veçante Administratorit Unik, Ing. Giovanni Di Vincenzo, te identifikuar si me siper, per te marre pjese ne Asamblene e Jashtezakoneshme te ortakeve te DV-Focus Sh.p.k. per modifikimin e Statutit social te kesaj shoqerie, me mundesine per te emeruar administratoret e rinj te se njejtes shoqeri.

Meqenese nuk kishte asgje tjeter per te vendosur dhe duke qene se askush nga te pranishmit nuk e kerkoi fjalen, Presidenti e deklaroi asamblene te mbyllur, ne oren dymbedhete, pasi u perpilua dhe u lexua e aprovua ky proçes-verbal.

SEKRETARI

Luciano Dal Prato

Firma

PRESIDENTI

Giovanni Di Vincenzo

Firma

Prokura eshte legalizuar tek noteri, me 14/1/1999, i cili ka vene shenimin e meposhtem:

Kopja eshte e njejte me tekstin qe ndodhet nga faqja 001 deri ne faqen 006 te librit te Proçes-verbaleve te Asambleve te shoqerise **DI VINCENZO ESTERO S.r.l**, me seli legale ne San Giovanni Teatino (CH), lokaliteti Sambuceto, ne rrugen Aterno No.78, vertetuar e mbajtur ne perputhje me normat e ligjit.

Pescara, piazza della Rinascita N.24, me 14/01/1999.

Firma + Vula

12
KALISHI
PESHKOPË
LEBAJ

REVOKIMI I MARREVESHJES

Kjo **MARREVESHJE** bëhet në Tiranë (Republika e Shqipërisë) më.....

të vitit 1999,

midis:

njërës palë, **PENENG SHIPBUILDING & CONSTRUCTION SDN BHD**, një kompani që ekziston në bazë të ligjeve të të Malajzisë dhe që e ka qendrën e aktivitetit të biznesit të saj në katin e 11të, të ndërtesës Ming Buiding, Jalan Bukit Nanas, 50250 Kuala Lumpur, Malajzi, (më poshtë do të quhet shkurtimisht si "PSC");

dhe

palës tjetër **DI VINCENZO ESTERO S.R.L.**, një kompani që ekziston sipas ligjeve të Italisë dhe që e ka zyrën e saj të regjistruar në adresën Via Aterno No. 78, S. Giovanni Teatino (CH), Itali (më poshtë do të quhet shkurtimisht si "DVE"),

Më poshtë PSC dhe DVE individualisht do të trajtohen si "Pala" dhe kolektivisht si "Palët",

NDERSA:

- (A) Palët kishin hyrë në një Marrëveshje Xhoint Veçër më 29të nëntor 1996 (këtëj e tutje do të quhet si "Marrëveshja Xhoint Veçër") me synimin e ndërtimit dhe menaxhimit të qendrës komerciale dhe të biznesit që do të vendosej në Tiranë, Shqipëri (këtëj e tutje do të quhet si "Projekti WTC");
- (B) Në përputhje me Marrëveshjen Xhoint Veçër, Projekti WTC do të realizohet nga Palët nëpërmjet veprimeve të përbashkëta të një kompanie që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë e

njohur si Di Vincenzo Estero Sh.p.k; në atë kohë kompania zotërohej plotësisht nga DVE (këtej e tutje e quajtur si " **Kompani e Projektit**");

- (C) Di Vincenzo Estero Sh.p.k. më vonë u riquajt si DV Focus (Albania) Sh.p.k; (këtej e tutje e quajtuar si "DV-Focus);
- (D) Në vazhdim të Marrëveshjes Xhoint Vençër, Palët kishin ekzekutuar Marrëveshjen e Transferimit të Aksioneve më 29^{të} janar, 1997 dhe DVE kishte transferuar tek PSC pronësinë ligjore të (80%) tetëdhjetë për qind të aksioneve të Kompanisë së Projektit (këtej e tutje do të quhen si "Aksionet PSC");
- (E) Palët ishin futur në një Marrëveshje Depozitim-Tërheqjeje më 29 të janar, 1997 me qëllim që të rregullonin të drejtat dhe mundësitë e depozitimeve -tërheqjeve sipas termave dhe kushteve të parashikuara në Marrëveshjen Xhoint Vençër.
- (F) Më pas kanë lindur mosmarrëveshje midis Palëve për sa i takon kryerjes së Projektit WTC për rrjedhojë DVE ka ndërmarrë masa ligjore kundër PSC duke e hedhur atë në gjykatën e Republikës së Shqipërisë;
- (G) Prandaj Palët hyjnë në këtë marrëveshje duke rënë dakord së bashku për t'i zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me termat dhe kushtet të përfëshira këtu.

ESHTE RENE DAKORD si më poshtë:

NENI 1

PERKUFIZIME

Ndarja 1.1 Përkufizimi i termave

Kur përdoren në këtë Marrëveshje, termat e përkufizuara më sipër do të kenë të

njëtin kuptim, dhe termat e më poshtme do të kenë kuptimin që përcaktohet si vijon:

Revizorë do të thotë anëtarët e Bordit të brendshëm të Revizorëve të Kompanisë së Projektit të caktuar nga PSC në bashkëvajtje me Marrëveshjen e Xhoint Vençërit.

Grupi BF do të thotë PSC, Business Focus SDN BHD dhe çdo kompani që kontrollohet në mënyrë direkte apo indirekte nga Business Focus SDN BHD të Kuala Lumpurit (Malajzi).

Drejtorët do të thotë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë së Projektit të caktuar nga PSC sipas Marrëveshjes Xhoint Vençër.

Grupi IGEFI do të thotë DVE dhe çdo kompani tjetër që kontrollohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga IGEFI S.r.l. e S. Giovanni Teatino (CH), Itali.

Proçeset do të thotë çdo proçeset gjyqësore dhe arbitrazhi i filluar nga DVE, dhe/ose nga çdo Kompani e Grupit IGEFI kundër PSC dhe/ose çdo kompani e Grupit BF dhe në pritje për t'u zgjidhur nga çdo gjykatë apo panel arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë, ose në çdo vend tjetër.

Marrëveshjet WTC do të thotë të gjitha Marrëveshjet e nënshkruara midis

Palëve në Lidhje me Projektin WTC, duke përfshirë amendamentet përkatëse, me fjalë të tjera:

- a. Marrëveshjen Xhoint Vençër të datës 29^{të} janar, 1997;
- b. Marrëveshjen e Depozitimeve-Tërheqjeve të datës 29 të janar, 1997;
- c. Marrëveshjen e Transferimit të Aksioneve të datës 29 të janar, 1997;

d. Marrëveshjen suplementare të datës 27^{të} mars, 1997.

Ndarja 1.2 Titujt-Referenca-Persona-Njëjës-Shumës

- (1) Në këtë marrëveshje, me përjashtim të rasteve kur konteksti ka kuptim të ndryshëm, fjalët që tregojnë numërin njëjës do të përfshijnë edhe numërin shumës dhe anasjelltas, dhe fjalët që tregojnë persona duke përfshirë korporatat, partnershipe, dhe persona të tjerë legalë.
- (2) Referenca ndaj fjalëve "Nen", "Ndarje", "Aneks" ose "Afat" do të interpretohet në lidhje me atë "Nen", "Ndarje", "Aneks" apo "Afat" të veçantë të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Ndarjet në kryeradhë janë bërë vetëm për lehtësi dhe nuk do të kenë ndonjë ndikim në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 2

DETYRIMET

Duke patur parasysh miratimin e DVE për të revokuar dhe anuluar të gjitha Marrëveshjet e WTC në vijim të Ndarjes 4.1 dhe njëkohësisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pranimin e PSC për revokimin dhe anulimin e Marrëveshjeve të WTC, PSC do t'i transferojë aksionet e saj që përfaqësojnë (80%) tetëdhjetë për qind të kapitalit të aksioneve në DV-Focus me vlerën në USD Një Dollar (US\$ 1,00) vetëm kur dhe nuk ka ndonjë detyrim, premtim, pengesë apo ndonjë të drejtë obliguese dhe Palët do të ekzekutojnë Marrëveshjen e Transferimit të Aksioneve dhe do të finalizojnë të gjitha formalitetet që kërkohen nga ligjet e Republikës së Shqipërisë për qëllimin e regjistrimit dhe perfeksionimit të Transfertës së Aksioneve dhe me të cilin akt nuk do të ketë më asnjë pretendim nga secila palë kundër tjetrës në lidhje me revokimin dhe anulimin e Marrëveshjeve WTC në përputhje me Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 3

PERFAQESIMI I PERGJITHSHEM DHE GARANCITE

Ndarja 3.1 Garancitë dhe Përfaqësimet e PSC

- (1) PSC është një korporatë e regjistruar sipas rregullave dhe që ekziston në përputhje me ligjet e Malajzisë dhe që ka autoritetin dhe fuqinë korporuese për të ekzekutuar dhe kryer këtë Marrëveshje dhe për ta bërë biznesin e saj si deri më sot.
- (2) Kjo Marrëveshje përbën një marrëveshje të PSC me fuqi legale dhe të detyrueshme, dhe ekzekutimi dhe/ose kryerja e kësaj Marrëveshjeje nga PSC në përputhje me termat e saj nuk bijnë ndesh dhe nuk është në kundërvajtje me ndonjë angazhim legal kontraktual ose me ndonjë angazhim që ekziston deri në datën e mësipërme.
- (3) Sipas të dhënave të PSC, dhe përveç Proceseve, nuk ka ndonjë padi, çështje, proces që të përbëjë rrezik, apo në pritje për gjyq, para ndonjë agjensie administrative, apo ndonjë panel arbitrazhi ose qeveritar i cili nëse do të vendoste kundra do të dëmtonte materialisht aftësinë e PSC për ta zbatuar këtë marrëveshje sipas kushteve dhe termave të parashtruara këtu, dhe /ose të ndikonte për keq në kapacitetin e PSC për ta ekzekutuar këtë marrëveshje.
- (4) As ekzekutimi, bërja apo regjistrimi i kësaj Marrëveshjeje as edhe ndonjë transaksion i parashikuar këtu as edhe besnikëria ndaj termave të këtueshme nuk çënon ose nuk do të shkelë ndonjë klauzolë të ligjit, statutit, dekretit apo rregullores ndaj të cilës PSC është subjekt apo ndaj ndonjë gjykimi, dekreti ose urdhëri juridik i aplikueshëm për PSC.
- (5) Nënshkruesi për PSC zotëron të gjithë fuqinë, autoritetin, legjitimitetin dhe autorizimin e nevojshëm që kërkohet nga ligjet dhe rregulloret e Malajzisë, dhe nga nën-aktet e PSC, për ta ekzekutuar këtë

marrëveshje vërtetësisht dhe në mënyrë të ligjshme në emër të PSC dhe të kushtëzohet PSC vërtetësisht dhe legalisht sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

- (6) PSC nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje, me ndonjë palë të tretë, duke përfshirë Gupin BF, me anën e të cilës ajo të ketë caktuar ndonjë nga të drejtat apo pretendimet e saj, që dalin prej, ose përndryshe që kanë lidhje me ekzekutimin, bërjen dhe mbylljen e Marrëveshjeve WTC.

- (7) Qysh nga ekzekutimi i Marrëveshjes Xhoint Vençer, Drejtorët dhe PSC nuk kanë hyrë në ndonjë marrëveshje materiale në emër të Kompanisë së Projektit e cila të ndikonte sadopak mbi pozitën e Kompanisë Projektit.

Ndarja 3.2 Garancitë dhe përfaqësimet e DVE

- (1) DVE është një korporatë origjinale, përshtatshëmrisht e regjistruar që ekziston sipas ligjeve të Italisë dhe ka autoritetin dhe fuqinë korporuese për ta ekzekutuar dhe kryer këtë marrëveshje dhe për të vazhduar biznesin e saj si deri më sot.
- (2) Kjo Marrëveshje është një marrëveshje e DVE e detyrueshme, e zbatueshme dhe legale dhe ekzekutimi dhe/ose zbatimi nga DVE i kësaj Marrëveshjeje në përputhje me termat e parashtruara në të nuk bijnë në kundërshtim dhe nuk shkel ndonjë angazhim legal kontraktual ose ndonjë angazhim që ekziston në datën e përmendur.
- (3) Sipas të dhënave të DVE, nuk ka ndonjë padi, proces, procedurë apo arbitrazh në pritje ose që të përbëjë rrezik, para ndonjë gjykate, agjensie administrative, organizmi qeveritar apo arbitruer i cili nëse do të vendoste kundër do të dëmtonte materialisht aftësinë e DVE për ta zbatuar këtë kontratë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në

të, dhe/ose të kishte ndikim negativ mbi kapacitetin e DVE për të ekzekutuar këtë Marrëveshje.

- (4) As ekzekutimi, mbrojtja apo regjistrimi i kësaj Marrëveshjeje as edhe ndonjë transaksion i parashikuar këtu as përmbushja e termave të këtueshme nuk cënon dhe nuk do të shkelë ndonjë klauzolë të ligjit, statutit, dekretit, rregullit apo rregullores ndaj të cilës DVE është subjekt as dhe të ndonjë gjykimi, dekreti apo urdhëri juridik të aplikueshëm për DVE.
- (5) Nënshkruesi për DVE ka të gjitha fuqitë, autoritetin, legjitimitetin dhe autorizimet e nevojshme që kërkohen nga ligjet dhe rregulloret e Italisë, dhe nga nën-aktet e DVE, për ta ekzekutuar këtë Marrëveshje vërtetësisht dhe ligjëshmërisht në emër të DVE dhe të jetë e detyrueshme legalisht dhe vërtetësisht për DVE sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
- (6) DVE nuk ka hyrë në ndonjë Marrëveshje, me ndonjë palë të tretë, duke përfshirë Grupin IGEFI, me anën e të cilës ajo të ketë caktuar ndonjë nga të drejtat e saj ose pretendimet e saj, që rrjedhin prej andej, ose sidoqë të jenë të lidhura me ekzekutimin, kryerjen dhe mbylljen e Marrëveshjeve WTC.

NENI 4

DETYRIMET

Ndarja 4.1. Revokimi i Marrëveshjeve WTC

- (1) Me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje Palët e këtueshme janë dakord reciprokisht dhe në përputhje me njëra tjetrën që të gjitha Marrëveshjet WTC do të revokohen dhe anulohen dhe do të quhen të pavlefshme dhe nuk kanë asnjë lloj ndikimi të mëtejshëm në lidhje sa më poshtë:

- a. Marrëveshja e Transferimit të Aksioneve së bashku me formalitetet përkatëse që kërkohen për transferimin e caktuar të të drejtës së aksioneve do të finalizohen njëkohësisht me Marrëveshjen e Revokimit.
- b. Të gjithë Drejtorët dhe Revizorët e Brendshëm të caktuar nga PSC do të japin dorëheqje me ekzekutimin e Marrëveshjes së Revokimit.

Palët e këtushme deklarojnë se secila Palë nuk ka dhe nuk do të ketë pretendime të mëtejshme të çfarëdolloji kundra tjetrës në lidhje me të gjitha Marrëveshjet WTC.

Me këtë akt DVE dhe PSC prishin në mënyrë të pakthyeshme të gjitha të drejtat dhe pretendimet e saj reciproke (duke përfshirë shpenzimet legale) që burojnë nga/ose që përndryshe kanë lidhje me ekzekutimin, bërjen, mbylljen dhe/ose revokimin e Marrëveshjeve WTC.

OBLIGIMET E DVE

Ndaria 4.2 Përfundimi i Proceseve

- (1) Me ekzekutimn e kësaj Marrëveshjeje Revokimi, të Marrëveshjes së Transferimit të Aksioneve dhe finalizimit të formaliteteve përkatëse, DVE në të njëjtën kohë do të përfundojë dhe tërheqë Proceset tashmë të hapura në Gjykatën e Tiranës dhe çdo hap apo veprim tjetër ligjor i cili është marrë ose do të ndërmerret kundër PSC, duke depozituar në çfarëdo gjykate kompetente apo paneli arbitrazhi petitionet përkatëse, paralajmërimin e prishjes së kontratës, dorëheqjet dhe çdo lloji tjetër dokumenti apo deklarate e cila mund të jetë e nevojshme për qëllimet e realizimit të synimeve të përmendura.

- (2) DVE nuk do të ketë të drejtën që të ketë pretendime ndaj PSC për ndonjë shpenzim të bërë nga DVE në lidhje me Proceset dhe mbylljen e Proceseve.

Ndarja 4.3- Anulimi i pretendimeve

- (1) Në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, DVE do të heqë në mënyrë të parevokueshme të gjitha pretendimet dhe të drejtat kundër Drejtorëve, Revizorëve, Grupit BF, agjentëve, shërbyesëve dhe/ose avokatëve, të cilat mund të dalin në lidhje me egzekutimin dhe/ose kryerjen e Marrëveshjeve WTC. Për rrjedhojë DVE heq dorë nga padi para çfarëdo gjykate apo panel arbitrazhi kundër çdonjërit prej Drejtorëve, Grupit BF, PSC, shërbyesëve të saj, agjentëve dhe/ose avokatëve në lidhje me Projektin WTC.
- (2) Në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, PSC heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe pretendimet e saj (duke përfshirë pa ndonjë paragjykim shpenzimet e gjyqit) kundër Kompanisë së Projektit, që dalin nga, ose sidoqë të kenë lidhje me kryerjen dhe mbylljen e Marrëveshjeve WTC.

Ndarja 4.4 Dëmshpërblimi

Në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, DVE do të kompensojë dhe mbrojë Drejtorët, Revizorët, Grupin BF, PSC, shërbyesit e saj, agjentët dhe/ose avokatët nga çdo pretendim, dëmtim, , borxh, gjykim apo shume nga çdo palë, duke përfshirë organizma qeveritare apo gjysëm-qeveritare, të cilat mund të dalin në lidhje me operacionin e DV-Focus.

Ndarja 4.5 Kostot dhe tarifa e stampës

Në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, DVE do të mbulojë të gjitha kostot dhe tarifat e stampës që mund të dalin në lidhje me

tokën e e zotëruar nga Kompania e Projektit, ekzekutimi i Marrëveshjeve të Transferimit të Aksioneve, dorëheqja e Drejtorëve dhe Revizorëve të Brendshëm dhe në lidhje me ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje.

NENI 5

TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Ndarja 5.1 Transerimi i aksioneve

- (1) Duke patur parasysh revokimin e DVE ndaj të gjitha Marrëveshjeve WTC në lidhje me Ndarjen 4.1 dhe njëkohësisht me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, PSC do t'i transferojë aksionet e saj tek DVE që përfaqësojnë (80%) tetëdhjetë për qind të kapitalit të aksioneve në DV-Focus në vlerë në USD Një Dollar (US\$1.00) vetëm kur nuk ekziston ndonjë detyrim, premtim, pengesë ose ndonjë e drejtë tjetër obliguese dhe Palët do ta ekzekutojnë Marrëveshjen e Transferimit të Aksioneve (këtej e tutje e atashuar si "Aneksimi A") dhe do të finalizojnë të gjitha formalitetet që kërkohen sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me qëllim që të kryhet regjistrimi dhe perfeksionimi i Transferimit të Aksioneve.
- (2) PSC angazhohet që të mos u japë palëve të treta të drejtën e përparësisë dhe/ose të drejtat e opsioneve për të blerë Aksionet e PSC.
- (3) Me ekzekutimin e Marrëveshjes së Transferimit të Aksioneve dhe finalizimin e formaliteteve përkatëse që kërkohen, nuk do të ketë më pretendime të tjera ose të mëtejshme kundra Drejtorëve, Revizorëve, Grupit BF, PSC, shërbyesëve të saj, agjentëve dhe/ose avokatëve.
- (4) Me ekzekutimin e Marrëveshjes së Transferimit të Aksioneve dhe finalizimin e formaliteteve përkatëse, DVE dhe PSC janë dakord së bashku të anulojnë dhe revokojnë garancinë korporuese të hartuar

nga Business Focus SDN BHD dhe e njëjta do t'i jepet menjëherë PSC nga DVE.

- (5) Njëkohësisht me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje Drejtorët dhe Revizorët e Brendshëm të DV-Focus të caktuar nga PSC do të japin dorëheqjen nga zyrat e tyre përkatëse dhe dorëheqja e të cilëve do të pranohet nga DVE.

NENI 6

JURIDIKSIONI DHE LIGJI APLIKUES

Ndarja 6.1 Ligji aplikues

Kjo Marrëveshje do të drejtohet dhe interpretohet në të gjitha drejtimet sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar.

Ndarja 6.2 Juridiksioni

Secila nga Palët e këtuëshme i nënshtrohen çdo gjykate në Mbretërinë e Bashkuar në çdo akt apo seancë që del apo ka lidhje me këtë marrëveshje.

Ndarja 6.3 Arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje, grindje ose pretendim që del ose që ka lidhje me këtë Marrëveshje do të trajtohet dhe zgjidhet sipas Rregullores UNCITRAL të Arbitrazhit që është në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

Vendi i Arbitrazhit do të jetë në Londër.

NENI 7

NJOFTIMET

Çdo njoftim apo kërkesë që bëhet apo shpallet në përputhje me këtë dokument do të bëhet me shkrim, dhe do të konsiderohet që është shpallur apo bërë kur ai të jetë dërguar me postë ose telefaks Palës së destinuar apo të lejuar për t'u njoftuar apo bërë, e dërguar në adresën e një Pale të tillë siç përcaktohet më poshtë apo në ndonjë adresë tjetër të tillë e cila do të përcaktohet nga një Palë e

tillë me njoftimin dërguar Palës e cila nxjer njoftime të tilla apo bën kërkesa të tilla.

Për PSC:

Penang Shipbuilding & Construction SDN BHD
 11th Floor, Ming Building
 Jalan Bukit Nanas
 50250 Kuala Lumpur
 Malaysia
 telefax: (60) 3 2024037

Për DVE:



DI Vincenzo Estero S.r.l.
 Via Anterno, 78
 S. Giovanni Teatino (CH)
 Italy
 telefax: 0854468211

NENI 8

KOPJET DHE GJUHA

Ndarja 8.1 Kopjet

Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet në disa kopje, secila prej tyre do të trajtohet si origjinale, por të gjitha ato përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Ndarja 8.2 Gjuha

Kjo Marrëveshje është e shkruar në gjuhën angleze. Në qoftë se kërkohet për qëllime regjistrimi, një përkthim në gjuhën shqipe i Marrëveshjes së Transferimit të Aksioneve do të kryhet nga Palët. Në rast se ka mospërputhje ose kontradikta midis versionit të gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe, versioni i anglishtes do të mbizotërojë.

NE PRANI TE DESHMITAREVE, Palët e këtueshme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre ligjëshmërisht të autorizuar, e kanë firmosur këtë Marrëveshje në emrat e tyre përkatësisht në të njëjtën datë të sipërshtuar.

Për dhe në emër të

DI VINCENZO ESTERO S.r.l.

Në prani të

Për dhe në emër të

RENENG SHIPBUILDING & CONSTRUCTION

Në prani të

NE PRANINE E DESHMITAREVE

Z.-----

Z.-----

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
NR. 690 REP.

KALIOPI PULAJ
PERKTHYSESE LEHAJE
LEKES 1988/89 TIR

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Kaliopi PULAJ, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje, e cila deklaroi se ka perkthyer sa me sipër, njelloj me originalin bashkangjitur nga anglisht ne shqip dhe nenshkroi rregullisht para meje.

Tirane me 08.02, 1999



NOTER

Kupet Kurti
Kurti



MARREVESHJA E TRANSFERIMIT TE AKSIONEVE

Kjo **MARREVESHJE** bëhet në Tiranë (Republika e Shqipërisë) më 26 Janor,
1999.

MIDIS

palës **PENENG SHIPBUILDING & CONSTRUCTION SDN BHD**, një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Malajzisë dhe që e ka qendrën e biznesit të saj në Katin 11të, në ndërtesën Ming Building, Jalan Bukit Nanas, 50250 Kuala Lumpur, Malajzi (këtej e tutje do të quhet si "**PSC**");

DHE

palës tjetër **DI VINCENZO ESTERO S.R.L.**, një kompani që ekziston sipas ligjeve të Italisë dhe që e ka zyrën e saj të regjistruar në Via Aterno No. 78, S. Giovani Teatino (CH), Itali (këtej e tutje do të quhet si "**DVE**");

PSC dhe DVE këtej e tutje do të quhen individualisht si "Palë" dhe kolektivisht si "Palët",

NDERSA:

- (A) PSC dhe DVE janë përfituesë dhe pronarë të regjistruar të aksioneve që përfaqësojnë respektivisht 80% (të **Aksione të PSC**) dhe 20% (të **Aksione të DVE**) të kapitalit të aksioneve të DV-Focus Sh.p.k., një një kompani xhoint vençër që ekziston dhe është e organizuar zyrtarisht sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje do të quhet si "**DV-Focus**");
- (B) Gjatë operacionit të përbashkët të DV-Focus kanë lindur disa mosmarrëveshje midis Palëve;

- (C) Palët janë futur në një Marrëveshje Revokimi më -----, 1999 me qëllim që të zgjidhin grindjet midis Palëve (këtëj e tutje do të quhet si "Marrëveshja e Revokimit");
- (D) Palët kanë rënë dakord së bashku sipas Marrëveshjes së Revokimit që t'i transferojnë tek DVE në mënyrë të pakthyeshme të gjitha aksionet PSC në DV-Focus.

ESHTË RENË DAKORD si më poshtë:

NENI 1

PERKUFIZIME

Ndarja 1.1 Terma të përkufizuara

Kur përdoren në këtë Marrëveshje, termat e përkufizuara më sipër do të kenë të njëjtin kuptim, dhe termat dhe shprehjet e mëposhtme do të mbartin të njëjtin kuptim siç përcaktohet më poshtë:

BF Group do të thotë Business Focus Sdn Bhd, PSC dhe çdo kompani në mënyrë direkte apo indirekte e kontrolluar nga Business Focus SDN BHD e Kuala Lumpurit (Malajzi).

IGEFI Group do të thotë DVE dhe çdo kompani tjetër e kontrolluar në mënyrë direkte nga IGEFI S.r.l. e S. Giovanni Teatino (CH), Itali.

Seancat do të thotë çdo seancë gjyqësore apo arbitrazhi e hapur nga DVE, dhe/ose nga çdo kompani e Grupit IGEFI, kundër PSC, dhe /ose çdo kompanie të Grupit BF, që pret ende të zgjidhet para ndonjë gjykate ose paneli arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë, ose në çdo vend tjetër.

Marrëveshjet WTC do të thotë të gjitha Marrëveshjet e hartuara midis Palëve në lidhje me Projektin WTC, duke përfshirë amendamentet përkatëse dhe konkretisht:

- a) Marrëveshjen Xhoint Vençer me datë 29 të nëntor, 1997.
- b) Marrëveshjet e Depozitimit dhe Tërheqjeve datë 29të janar, 1997
- c) Marrëveshjen Suplementare më datën 27të mars, 1997

Ndarja 1.2 Kryeradhët-Referencat-Personat-Njëjəsi/Shumësi

- (1) Në këtë Marrëveshje, në përjashtim të rasteve kur konteksti kërkon një kuptim të ndryshëm, fjalët që tregojnë numrin njëjës do të përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas, dhe fjalët që tregojnë persona duke përfshirë korporatat, partnershipet, dhe persona të tjerë legalë.
- (2) Referencat ndaj fjalëve "Nen", "Ndarje", "Aneks" ose "Afat" do të interpretohen si referenca ndaj "Nenit", "Ndarjes", "Aneksit" apo "Afatit" të veçantë të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Nëndarjet janë bërë vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë mbi interpretimin e kësaj marrëveshjeje.

NENI 2

DETYRIMET

Palët e nënshkruara futen në këtë Marrëveshje me detyrimin e revokimit dhe të anulimit të të gjitha Marrëveshjeve WTC sipas Marrëveshjes së Revokimit të ekzekutuar midis Palëve dhe Marrëveshjeve të cilat do të jenë të pavlefshme dhe nuk do të kenë më asnjë lloj efekti dhe nuk do të ketë më pretendime nga asnjëra palë kundër palës tjetër në lidhje me Marrëveshjen WTC.

NENI 3

GARANCITE DHE PERFAQESIMI I PERGJITHSHEM

Ndarja 3.1 Garancitë dhe përfaqësimet e PSC

- (1) PSC është një korporatë e regjistruar zyrtarisht dhe që ekziston legalisht sipas ligjeve të Malajzisë dhe ka autoritetin dhe fuqinë



korporuese për ta ekzekutuar dhe për ta zbatuar këtë Marrëveshje dhe për ta vazhduar biznesin e saj si deri më sot.

- (2) Kjo Marrëveshje përbën një Marrëveshje të PSC të detyrueshme, legale dhe zyrtare dhe ekzekutimi dhe/ose kryerja nga PSC e kësaj marrëveshjeje sipas termave të përfshira në të përbën pengesë dhe shkel ndonjë angazhim ose ndërmarrje legale kontraktuale që ekziston brenda kësaj date.
- (3) Sipas të dhënave të PSC, dhe përveç Seancave, nuk ka ndonjë arbitrazh ose proces, seancë ankesë gjyqi në pritje ose që të rrezikojë, para ndonjë gjykate, agjensie administrative, organizmi qeveritar ose arbitrazhi i cili do të vendoste kundra dhe do të dëmtonte materialisht aftësinë e PSC për të kryer këtë Marrëveshje sipas termave dhe kushteve të përcaktuara dhe/ose të ndikonte negativisht mbi kapacitetin e PSC për ta ekzekutuar këtë Marrëveshje.
- (4) As ekzekutimi, bërja ose regjistrimi i kësaj Marrëveshjeje as edhe ndonjë transaksion i parashikuar këtu, as respektimi i termave të saj nuk cënon dhe nuk do të shkelë ndonjë klauzolë të ligjit, statutit, dekretit, rregullit apo rregullores ndaj të cilave PSC është subjekte as edhe të ndonjë gjykimi, dekreti apo urdhëri juridik që është i aplikueshëm ndaj PSC.
- (5) Nënshkruesi për PSC i ka të gjitha fuqitë, autoritetin, legjitimitetin dhe autorizimin që kërkohen nga ligjet dhe rregulloret e Malajzisë, dhe nga nën-aktet e PSC, për ta ekzekutuar këtë Marrëveshjeje legalisht dhe zyrtarisht në emër të PSC dhe legalisht dhe zyrtarisht ta kushtëzojë PSC sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

- (6) Nuk është dhënë asnjë e drejtë privilegjuese dhe/ose e drejtë opsioni për blerjen e Aksioneve PSC, në përjashtim të atyre të drejtave që i përkasin DVE.

Ndarja 3.2 Garancitë dhe përfaqësimet e DVE

- (1) DVE është një korporatë e organizuar, regjistruar dhe zyrtare që ekziston sipas ligjeve të Italisë dhe ka autoritetin dhe fuqinë korporuese për të ekzekutuar dhe kryer këtë Marrëveshje dhe për ta vazhduar biznesin e saj si deri më sot.
- (2) Kjo Marrëveshje përbën një marrëveshje të DVE, legale, zyrtare dhe e detyrueshme dhe ekzekutimi dhe/ose kryerja nga DVE e kësaj Marrëveshjeje sipas termave të saj nuk përbën kundravajtje dhe nuk shkel ndonjë angazhim apo ndërmarrje legale kontraktuale që ekziston në datën përfëshirëse.
- (3) Sipas të dhënave të DVE, nuk ka ndonjë çështje, proces, seancë apo arbitrazh të hapur apo që të përbëjë rrezik, para ndonjë gjykate, agjensie ose organizmi qeveritar apo arbitrazhi i cili po të vendoste kundra do të dëmtonte materialisht aftësinë e DVE për ta kryer këtë Marrëveshje sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të, dhe/ose të ndikojë negativisht mbi kapacitetin e DVE për ta ekzekutuar këtë Marrëveshje.
- (4) As ekzekutimi, bërja apo regjistrimi i kësaj Marrëveshjeje as edhe ndonjë transaksion i parashikuar në të, as përmbushja e termave të saj nuk cënon ose nuk shkel ndonjë klauzolë të ligjit, statutit, dekretit, rregullit apo rregullores ndaj të cilave DVE është subjekte, as edhe ndonjë gjykim, dekret apo urdhër juridik i aplikueshëm për DVE.
- (5) Nënshkruesi për DVE e ka të gjithë fuqinë e nevojshme, autoritetin, legjitimiteti dhe autorizimin që kërkohet nga ligjet dhe rregulloret e



Italisë, dhe nga nën-aktet e DVE, për ta ekzekutuar legalisht e zyrtarisht këtë marrëveshje në emër të DVE dhe ta detyrojë legalisht dhe zyrtarisht DVE në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 4

Transferimi i Aksioneve

Ndarja 3.1 Transferimi i aksioneve

- (1) PSC do t'i transferojë DVE, dhe DVE do të pranojë nga PSC Aksionet që përfaqësojnë (80%) tetëdhjetë për qind të kapitalit të aksioneve të DV-Focus për vlerë të Një Dollari USD (USD\$1.00) vetëm jashtë çdo detyrimi, zotimi, pengese ose çdo e drejte tjetër obliguese dhe gjithashtu duke mbajtur parasysh revokimin e DVE ndaj të gjitha Marrëveshjeve WTC që lidhen me Marrëveshjen e Revokimit të ekzekutuar nga të dyja Palët pas së cilës nuk do të ketë më pretendime të mëtejshme apo të tjera të çfarëdo lloji kundra njëra-tjetrës.
- (2) Si rezultat i një transferimi të tillë të aksioneve, DVE do të mbajë aksionet që përfaqësojnë 100% të kapitalit të aksioneve të DV-Focus.
- (3) Me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje Palët do të kryejnë të gjitha formalitetet në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë me qëllim që të finalizohet transferimi i Aksioneve të PSC. Në mënyrë të veçantë, pa paragjykim, PSC do të ofrojë asistencën e saj, në qoftë se është e nevojshme, në lidhje me regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje me Gjykatën e Tiranës dhe çfarëdo autoriteti tjetër përkatës.

NENI 5
TE NDRYSHME

Ndarja 5.1 Taksat

DVE është e gatshme të mbulojë pagesat për të gjitha taksat, tarifat ose shpenzime të tjera (duke përfshirë taksat e markave) të pagueshme sipas ligjeve Shqipëtare pas, ose në lidhje me, ekzekutimin, daljen, realizimin e kësaj Marrëveshjeje, ose shitjes, transferimit ose dërgimit të Aksioneve të PSC.

Ndarja 5.2 Njoftimet

Çdo njoftim apo kërkesë e kërkuar apo e lejuar për t'u bërë apo shpërndarë sipas kësaj, do jetë në formën e shkruar, dhe do të jetë e mirëqënë nëse është hartuar apo dhënë kur ajo të jetë dërguar me postë ose telefaks tek Pala që e kërkon apo që lejohet t'i dërgohet ose të bëhet në adresën e një Pale të tillë siç përcaktohen më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër që do të jetë përcaktuar nga një Palë e tillë me anën e një lajmërimi dërguar Palës që e bën një njoftim të tillë ose që bën një kërkesë të tillë.

Për PSC:

Peneng Shipbuilding & Construction SDN BHD
11th Floor, Ming Building
Jalan Bukit Nanas
50250 Kuala Lumpur
Malaysia
telefax: (06) 32024037

Për DVE:

Di Vincenzo Estero srl
Via Aterno, 78
S. Giovanni Teatino (CH)
Italy



telefax: (39)085 4468211

Ndaria 5.3 Juridiksioni dhe Ligji aplikues

- (1) Kjo Marrëveshje do të drejtohet dhe do të interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje dhe sipas ligjeve të Mbretërisë së Bashkuar.
 - (2) Secila nga Palët përfëshirëse në mënyrë të pakthyeshme pranon juridiksionin ekskluziv të çdo gjykate në Mbretërinë e Bashkuar në çdo padi apo proces që del apo që ka të bëjë me këtë Marrëveshje.
 - (3) Çdo grindje, debat ose pretendim që del apo që ka lidhje me këtë Marrëveshje do të trajtohet dhe zgjidhet duke u bazuar në Rregullat UNCUTRAL të Arbitrazhit që janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.
- Vendi i arbitrazhit do të jetë në Londër.

Ndaria 5.4 Kopjet dhe gjuha

- (1) Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në disa kopje, secila do të trajtohet si origjinale, por të gjitha do të përbëjnë një dhe të njëjtën Marrëveshje.
- (2) Kjo Marrëveshje është e shkruar në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në raste të mospërputhjeve ose kontradiktave midis versionit të anglishtes dhe shqipes, do të mbizotërojë versioni i anglishtes.

NE DESHMI TE SA ME SËPËR, Palët e këtueshme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre zyrtarë dhe të autorizuar, e kanë firmosur këtë Marrëveshje me emrat e tyre respektive në datën e sipërpërmendur.

Për dhe në emër të

DI VINCENZO ESTERO S.r.t.

Në prani të

Për dhe në emër të

PENENG SHIPBUILDING & CONSTRUCTION

Në prani të



NE PRANI TE DESHMITAREVE:

Z. _____

Z. _____

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
NR. 691 REP.

Kaliopi Pulaj
KALIOPI PULAJ
PERKTHYSESE INDIVIDUALE
LENA 700000000


VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Kaliopi PULAJ, banuese ne Tirane, e njohur personalisht prej meje, e cila deklaroi se ka perkthyer sa me siper, njelloj me originalin bashkangjitur nga anglisht ne shqip dhe nenshkroi rregullisht para meje.

Tirane me 08.02,1999

NOTER

Shpresa Lumbi
Smy



13264

**VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE
TE SHOQERISE**

" DI VINCENZO ESTERO ALBANIA " Sh.p.k

Me 21 Janar 1997, ne " Tirana International Hotel ", Tirane, ne prani te noteres Znj. Shpresa Kurti, notere publike e emeruar ne 1987, dhe Enyal Shukes ne cilesine e perkthyeses legale, anetaret e meposhtem te Shoqerise " Di Vincenzo Estero Albania " Sh.p.k, nje shoqeri qe egziston nen legjilacionin e Republikes se Shqiperise:

Penang Shipbuilding & Construction perfaqesuar nga: Z. Thanggaya AL Munusamy

Di Vincezo Estero s.r.l perfaqesuar nga: Z. Massimiliano Danusso dhe
Z. Antonio Napoleone ne cilesine e Administratoritte vetem te Shoqerise.

Zoti Antonio Napoleone, thirret te Kryesoje mbledhjen dhe fton edhe noteren publike ta assistoje ate dhe Z. Massimiliano Danusso te kryeje edhe detyren e sekretarit.. Kryetari i mbledhjes konstaton qe i gjithe kapitali social i perfaqesuar dhe Drejtori i vetem eshte present, dhe prandaj deklaron se mbledhja eshte e rregullt dhe mund te fillohet diskutimi si me poshte:

RENDI I Mbledhjes

1. Shtimi i kapitalit social ne sasine ne Lek qe i korrespondon 429.000 \$US me qellim qe te silltet kapitali i shoqerise ne total : 48.148.000 lek sipas kursit te kembimit te tanishem.
2. Amendamentet e statutit, duke perfshire ndryshimin e emrit te shoqerise nga " Di Vincenzo Estero Albania" Sh.p.k ne " DV - Focus " Sh.p.k.
3. Emerimin e anetareve te Bordit te Drejtoreve dhe te Kryetrit te tij.
4. Emerimin e anetareve te Bordit te Revizoreve.
5. Te tjera.

Duke filluar me piken e pare te Rendit te dites, Kryetari informon se Marreveshja e Joint - Ventures e lidhur me 29.11.1996 ndermjet Penang Shipbuilding & Construction dhe Di vincenzo Estero S.r.l, konkludoj se kapitali social i " Di Vincenzo Estero Albania " Sh.p.k do te shtohet nga 100.000 lek deri ne vleften ne lek qe i korrespondon shumes prej 7.00.000 \$ US.

Kryetari propozon:


(a) Kapitali social i " Di Vincenzo Estero Albania " Sh.p.k do te shtohet pro koute, me disa shlyerje, nga 100.000 lek deri ne vleften ne lek qe i korrespondon shumes 7.00.000

\$ US duke rënë dakort që pas kësaj rritjeje të kapitalit Penang Shipbuilding & Construction dhe Di Vincenzo Estero s.r.l do të kenë respektivisht 80% dhe 20% të kapitalit social të Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.k.

(b) Shuma prej 48.048.000 lek do të jepet pro kuota si një shlyerje e parë e shtimit të kapitalit të mesipër dhe do të shlyhet në perfundim të kësaj mbledhjeje në llogarinë bankare të Di Vincenzo Albania Sh.p.k pranë " Arab Albanian Islamic Bank" Tiranë.

(c) Bordi Drejtues autorizohet të kërkojë pagesën e metejshme të shtimit të kapitalit deri me 7.00.000\$US, në përputhje me domosdoshmerinë e operimit të Shoqërisë.

(d) Neni 7 i statutit të Di Vincenzo Albania Sh.p.k do të ndryshojë si më poshtë:



Kapitali social i shoqërisë është dyzete e tetë milion e njëqind e dyzete e tetë mijë lek (48.148.000) i ndarë në 48.148 kuota nga 1000 lek secila.

(e) Kryetari siguron për potesimin e çdo kërkesë të ligjit shqiptar në rastin e shtimit të kapitalit social, duke përfshirë dhe regjistrimin në librat e shoqërisë.

Pas një diskutimi të gjatë, mbledhja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOJE :

Propozimet e bera nga Kryetari në mënyrën e formularit prej tij.

Duke kaluar në piken e dytë të rendit të ditës, Kryetari informon se në Marrëveshjen e Joint - Ventures, PSC-ja dhe DVE-ja rënë dakort që statuti i Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.k do të ndryshojë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

Kryetari atëherë propozon:

(a) Neni I i statutit të Di Vincenzo Estero Albania Sh.p.k të ndryshojë si vijon:

Neni I

Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

" Dv- Focus " Sh.p.k (Shoqëria) ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria është person juridik nën ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe kryen aktivitetin e saj në përputhje me legjilacionin shqiptar, aktin e themelimit dhe këtë statut.

Pas një diskutimi të gjatë, asambleja e ortakeve në mënyrë unanime vendosi:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari pastaj propozon qe:

(b) Neni 2 i statutit te Di vincenzo Estero Albania Sh.p.k te ndryshoje si vijon:

Neni 2

Objekti i shoqerise

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e projektimit dhe ndertimit te konstruksioneve, perfshire dhe qendren tregtare te ndodhur ne Tirane, Republika e Shqiperise ne perputhje me licencen e ndertimit per World Trade Center (WTC Tirana); mbikqyrjen e aktiviteve investuese te mesiperme; manaxhimin e çdo ndertese te projektuar dhe/ose ndertuar nga Shoqeria; blerjen, shitjen, dhenien me gira dhe manaxhimin e pasurve te paluajtshme. Shoqeria gjithashtu do te kryeje ne Republiken e Shqiperise, direkt dhe indirekt, aktivite qe lidhen me projektimin, ndertimin dhe manaxhimin e komplekseve turistike.

Kompania gjithashtu do te kryeje te gjitha ato aktivite qe jane te domosdoshme per realizimin e objektit te siperpermendur.

Gjithashtu, Shoqeria do te manaxhoje dhe do te kete pjesemarrje ne aktivite te tjera pervec atyre te perfshira ne paragrafin e pare te ketij neni (neni 2), si direkt ashtu edhe indirekt, dhe do te kryeje investime te çdo tipi ne Shqiperi. Shoqeria ka kompetence edhe te hyje ne joint - venture me partnere Shqiptare dhe/ose te huaj, duke siguruar qe çdo aktivitet i tille nuk bie ndesh me ndonje ligj ne Shqiperi.

Brenda qellimit te ketij statuti, Shoqeria ka kompetence te kryeje, direkt ose indirekt, te gjitha operacionet tregtare, industriale dhe financiare lidhur me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme, qe shihen si te nevojshme per te plotesuar, direkt ose indirekt, projektin e siperpermendur; per kete qellim Shoqeria ka kompetence te krijojë dege ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj dhe njekohesisht te kete pjesemarrje, direkte ose indirekte, interesa, ne shoqeri tregtare, fondacione, shoqata, nderrmarje, joint - vneture shqiptare ose te huaja dhe me partnere shqiptare ose te huaj.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi:

TE APROVOHET:

propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga kryetari.

Kryetari pastaj propozon:

(c) Neni 3 i Stautit te ndryshoje si vijon:

Neni 3

Qendra e shoqerise dhe adresat e ortakeve

Qendra e shoqerise eshte ne Tirane (Republika e Shqiperise) Tirana Trade Center, Rruga e Durrësit, Nr. 34.

Shoqeria, me vendim te Bordit te Drejtoreve, ka te drejten te krijojë, transferojë dhe ose te mbyllë zyra administrative, qendren, dege, zyra perfaqesimi, agjensi, ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

Adresat e ortakeve, ne lidhje me Shoqerine , jane ato te treguara ne Librin e Ortakeve.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja ne menyre unanime vendosi:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

(d) Neni 4 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise eshte 100 vjet. Ortaket kane kompetnce te shtyjne ate dhe te vendosin per mbylljen e shoqerise.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendos unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i meisiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

(e) Neni 5 i statutit te ndryshoje si me poshte:

Neni 5

Pergjegjesia e shoqerise

Shoqeria nuk mund te jete pergjegjese per detyrimet e ortakeve.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve unanimisht vendos:

TE APROVOHET:

Propozimi i meisiperm siç eshte formuluar.

Kryetari propozon:

(f) Neni 6 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 6

Libri i Ortakeve

Çdo blerje e titullit te nje ose me shume kuotave te shoqerise duhet te shoqerohet me rregjistrim perkates ne Librin e Ortakeve. Deri ne momentin qe do te behet ky rregjistrim bleresi nuk do te konsiderohet si ortak.

Çdo rregjistrim ne Librin e Ortakeve duhet te tregojte emrin e bleresit, sasine e kuotave dhe aktin e blerjes.

Tij i mbahet nga Sekretarja e Shoqerise, e cila duhet ti leshoje kopje çdo ortaku qe e kërkon.

Çdo hyrje ne liber rregjistrohet dhe firmoset nga Kryetari i Bordit Drejtues, pas paraqitjes nga bleresi te aktit qe deshmon pronesine mbi kuotat.

Ne vijim te formaliteteve te mesiperme, çdo ortak duhet te beje rregjistrim e tij edhe ne dosjen e shoqerise prane Rregjistrimit Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, duke pasqyruar sasine e kuotave qe ai mban ne shoqeri, dhe duke depozituar nje kopje te dokumentit qe evidenton titullin e tij. E njejta procedure do te ndiqet ne lidhje me egzistencen e ndonje pengu mbi kuotat e Shoqerise.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja unanimitisht vendosi:

TE APOROVHET:

Propozimi i mesiperme, siç eshte formuluar.

Kryetari propozon:

(g) Neni 8 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 8

Transferimi i kuotave

Kushdo qe do te transferoje, per çfare do arsye, çdo kuote e shoqerise qe eshte ne zoterim te tij (te transferuesit) do te njoftoje per kete ortaket e tjere te Shoqerise, me lajmerim rekomande, duke njoftuar emrin e bleresit te mundshem dhe çmimin e rene dakort (Njoftim Transferimi).

Çdo ortak qe merr nje njoftim transferimi duhet te njoftoje pranimin ose refuzimin e tij per transferimin e kuotave, me njoftim rekomande derguar Transferuesit jo me vone se 30 (tridhjetë) dite pas dates se marrjes se Njoftimit te Transferimit.

Nese ndonje ortak qe e ka marre Njoftimin e Transferimit nuk arrin te njoftoje parnimin ose refuzimin e tij brenda 30 (tridhjetë) ditesh. atehere pelqimi do te konsiderohet i dhene, me kusht qe bleresi te pranoje me shkrim Statutin, Marreveshjen e Joint - Ventures midis Penang Shipbuilding & Construction dhe Di Vincenzo Estero S.r.l lidhur me 29.11.1996, dhe çdo marreveshje tjeter te metejshme te lidhur me ndertimin dhe projektimin e WTC Tirana.

Parashikimet e mesiperme nuk zbatohen nese:

i) transferimi behet nga njeri ortak tek tjetri; dhe

ii) transferimi i kuotave behet nga nje ortak i shoqerise tek Business Focus Group dhe ose IGEFI Group (dhe çdo shoqeri qe kontrollohet direkt ose indirekt respektisht nga Business Focus SDN BDH nga Kuala Lumpur, Malezia dhe IGEFI S.r.l nga S. Giovanni Teatono (CH) Itali), duke siguruar qe ortaku transferues merr persiper te ripleje kuotat e transferuara ne rastin e prishjes te shoqerise blerese ose ne rast se transferuesi humb interesin e tij tek bleresi dhe /ose bleresi humb interesin e tij tek transferuesi.

Transferimi i kuotave nuk mund te behet, kur transferuesit i eshte bere njoftimi i refuzimit, ne perputhje me kushtet e permendura me lart.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimitisht:

TE APROVOHET:

propozimi i mesiperme, siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

(gj) Neni 9 i statutit ndryshon si vijon:

Neni 9

Rregjistrimet kontabel

Operacionet kontabel kryhen nga Shoqeria ne perputhje me ligjin mbi kontabilitetin dhe ligjet e tjera te Republikes se Shqiperise dhe do te pasqyrohen hesnikerisht ne bilanc.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimitisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperme, siç eshte formuar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

h) Neni 10 i statutit ndryshon si me poshte:

Neni 10

Operacionet financiare

Shoqeria ka kompetence te marre financime dhe kredi nga çdo banke apo institucion shqiptar ose i huaj ose nderkombetar, shoqeri e trete ose nga ortaket e saj.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

propozimi i mesiperm, siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

i) Neni 11 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 11

Fondi rezerve dhe dokumentat financiare

Shoqeria ke kompetence te krijojë nje fond rezerve dhe fonde te tjera te veçanta.

Përdorja, sasia, burimi i fondeve, përdorimi dhe rregullimi i secilit fond do te përcaktohet nga Bordi Drejtues ne perputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë.

Pasqirite e Shoqërisë pasqyrohen ne bilanc duke pasqyruar vlerat e shprehura ne monedhen shqiptare dhe ne US\$ amerikan.

Bilanci dhe pasqyrimi i humbjeve dhe fitimeve te Shoqërisë do te pergatiten nga Bordi Drejtues ne perputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë

Viti financiar mbyllet me 31 Dhjetor te vitit ne vazhdim, dhe do te dergohet ne Mbledhjen e Asamblese se Zkonshme me 31 Mars te vitit ne vazhdim ose ne nje date te mevonshme qe Bordi i Drejtoreve do te percaktoje ne perputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht :

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm , siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

k) Neni 12 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 12

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese

Mbledhja e zakonshme e asamblese:

a) aprovon bilancin vjetor te pergatitur nga Bordi i Drejtoreve;

b) emeron anetaret e Bordit te Drejtoreve;

c) emeron kryetarin e Bordit te Drejtoreve dhe dhe zevendes kryetarin nese eshte e nevojeshme;

- d) percakton pergjegjesite e anetareve te Bordit te Drejtoreve;
- e) vendos per shperblimet e anetareve te Bordit te Drejtoreve.

Asambleja e Zakonshme thirret nga Kryetari i Keshillit Administrativ, ose Drejtori i Vetem, te pakten nje here ne vit, me njoftim me shkrim te pakten 21 - dite perpara dates se mbledhjes, ortakeve te cilet jane te rregjistruar ne Librin e Ortakeve te pakten 30 - dite perpara dates se fiksuar per mbledhje.

Ky lajmerim do te dergohet ne adresen e ortakeve te treguar ne Librin e Ortakeve.

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese se Ortakeve konsiderohet e vlefshme kur ne te perfaqesohet te pakten 1/2 e kapitalit social dhe merr vendime te vlefshme kur keto miratohen nga shumica e kapitalit te perfaqesuar ne mbledhje.

Ne mungese te formaliteteve te mesiperme mbledhja do te konsiderohet e vlefshme nese i te paktin kapitali social perfaqesohet ne mbledhje.

Çdo vendim i marre ne mbledhjen e pare apo te dyte aprovohet me shumice absolute te kapitalit social.

Çdo aksion te jep te drejten e nje vote. Ortaket kane te drejte te perfaqesohen nga perfaqesuesit e tyre te ligjshem ose nga çdo person qe nuk eshte e domosdoshme te jete ortak. nepermjet nje prokure ne forme te shkruar per mbledhjen konkrete.

Mbledhja e Zakonshme e Asamblese drejtohet nga Kryetari i Bordit te Drejtoreve.

Kryetari emerohet nje sekretare qe nuk eshte e domosdoshme te jete ortak.

Verbalet e mbledhjes firmosen nga sekretarja dhe kryetari.

Vendimet e Asamblese jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, per ata qe kane qene prezent dhe ata qe nuk kane qene.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperme, siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

1) Neni 13 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 13

Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e Jashtezakonshme vendos per keto probleme:

- a) amendamentet e kontrates dhe statutit;
- b) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit;

c) prishja e shoqerise;

d) emerimi dhe kompetencat e likuidatoreve;

e) probleme te tjera te cilat ligjet ne Republiken e Shqiperise ja njohin si ekskluzive asamblese se jashtezakonshme.

Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme behet sa here eshte e nevojshme, duke lajmeruar ne forme te shkruar te pakten 21 - dite perpara dates se fiksuar per mbledhje, ortakeve te cilet jane rregjistruar ne Librin e Ortakeve te pakten 30 dite perpara dates se fiksuar per mbledhje.

Ky njoftim duhet te dergohet ne adresen e treguar ne Librin e Ortakeve.

Mbledhja konsiderohet e vlefshme kur ne te perfaqesohet te pakten 1/2 e kapitalit social dhe merr vendime te vlefshme kur keto aprovohen nga shumica e kapitalit te pjesemarres ne mbledhje.

Çdo aksion te jep te drejten e nje vote. Ortaket mund te perfaqesohen nga çdo person, i cili nuk eshte e domosdoshme te jete ortak, nepermjet nje prokure te shkruar per mbledhjen perkatese.

Kryetari i Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme eshte Kryetari i Bordit te Drejtoreve. Kryetari emerion nje sekretare e cila mund te mos jete ortak.

Proces verbalet e mbledhjes se jashtezakonshme mbahen nga sekretarja dhe firmosen prej saj dhe kryetarit.

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim te ortakeve, kur ortaket japin miratimin me shkrim.

Vendimet e marra nga Mbledhja e Jashtezakonshme jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, si ata qe jane prezente dhe ata qe nuk jane.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperem, siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

m) Neni 14 i statutit do te ndryshoje si me poshte:

Neni 14

Proces verbalet

Mbledhja e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Asamblese se Ortakeve do te pasqyrohet ne proces verbalet perkatese.

Vendimet e marra ne Asamblene e Zakonshme ose te Jashtezakonshme, ne perputhje me ligjet ne Republiken e Shqiperise dhe kete statut, jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, prezente ose jo ne mbledhje.

Proces verhalet e mbledhjes se zakonshme ose te jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve mbahen nga sekretarja e emeruar nga Kryetari i Mbledhjes, dhe firmosen prej saj dhe Kryetarit.

Pas nje diskutimi te gjate, Asambleja e Ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm, siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

n) Neni 15 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 15 Thirrja e Mbledhjes

Asambleja e Zakonshme ose e Jashtezakonshme mund te thirren edhe me faks derguar te gjithë ortakeve, por duke derguar njekohesisht kete njoftim edhe me leter rekomande, jo me vone se nje dite me pas.

Njoftimi i thirrjes duhet te permbaje:

a) kohen dhe daten e mbledhjes, te shprehur ne numra dhe fjale;

b) vendin e mbledhjes, te shprehur ne menyre te plote;

c) problemet qe do te jene ne rendin e dites, duke i specifikuar dhe shoqeruar me numer rendor.

Njoftimi do te jete ne anglisht.

Ne rast te mosperputhjes me ndonje nga formalitet e siperpermendura, njoftimi eshte i pavlefshem. Pamvaresisht nga kjo, Mbledhja do te konsiderohet e vlefshme nese ne te perfaqesohet i tere kapitali social.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm, siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

o) Neni 16 i statutit te ndryshoje si vijon:

Kryetari ka te drejten e firmes se shoqerise., ai eshte perfaqesuesi ligjor i saj ndaj te treteve dhe organizon aktivitetin e Bordit te Drejtoreve.

Kryetari, ne lidhje me veprime te vecanta ose kategori veprimesh, ka kompetence te delegoje pjese te kompetencave te tij, perfshire edhe kompetencen per te perfaqesuar Shoqerine, Drejtoreve te Manaxhimit te Perbashket.

Kryetari ka gjithashtu kompetence ti delegoje Drejtoreve te Manxhimit te Perbashket kompetencat ;lidhur me firmen e Shoqerise. Keto kompetenca do te delegohen me referim specifik per veprime te vecanta ose kategori veprimesh dhe do te ushtrohen bashkarisht nga Drejtoret e Manxhimit te Perbashket.

Keta Drejtore te Manaxhimit te Perbashket do te jene pergjegjes per teljkalim te kompetencave te deleguara atyre.

Pas diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiper m sic eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

q) Neni 18 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 18 Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket

Veprimtaria operative e Shoqerise do te drejtohet nga Drejtore e Manaxhimit te Perbashket qe do te emerohen nga Bordi i Drejtoreve. Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket perfaqesojne instancen ekzekutive te Shoqerise dhe duhet te kryejne detyrat e tyre bashkarisht

Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket kane keto kompetenca te perbashketa:

- a) zbatojne vendimet e Bordit te Drejtoreve dhe vendimet e Asamblese se Zakonshme dhe te Jashtezakonshme;*
- b) organizojne dhe racionalizojne punen me qellim qe te realizojne synimet e Shoqerise, dhe raportojne per kete ne Bordin e Drejtoreve;*
- c) manaxhojne pasurite dhe pronat e Shoqerise, duke perfshire burimet financiare, ne perputhje me instruksionet e Bordit te Drejtoreve;*
- d) manaxhojne dhe kontrollojne aktivitetet e degeve dhe agjensive te Shoqerise;*
- e) perfaqesojne Shoqerine, me delegim te vecante te Kryetarit te Bordit te Drejtoreve, perpara autoriteteve juridike dhe te arbitrazhit dhe te treteve, si dhe perpara Autoriteteve dhe Institucioneve shqiptare dhe te huaja;*

f) t'i delegojne paleve te treta, te caktuara si perfaqesues, pjese te kompetencave te tyre, me referim specifik per veprime te vecanta ose kategori veprimesh. Keta perfaqesues do te jen pergjegjes per tejkalim te kompetencave te deleguara atyre;

g) ekzekutojne, ne mer dhe per llogari te Shoqerise, kontratat e çdo lloji;

h) te bejne çdo pagese per llogari te Shoqerise, marrin dhe shkarkojne te punesuar per Shoqerine dhe te firmosin kontratat perkatese. Drejtoret e Manaxhimit te Perbashket kane kompetence per te bere pagesas deri ne nje maksimum te percaktuar nga Bordi i Drejtoreve.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

r) Neni 19 i statutit te ndryshoje si vijon:



Neni 19

Bordi i kontrolloreve

Revizoret e brenshem dhe ata te jashtem do te emerohen nga Mbledhja e Zakonshme e Asamblese per nje periudhe 6 - vjeçare, te rinovueshme. Ata do te jene eksperte kontabel te autorizuar ne haze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

Pas nje diskutimi te gjate asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetari propozon:

s) Neni 20 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 20

Mbyllja e shoqerise

Shoqeria do te mbyllet ne rastet kur:

a) plotesohet afati i fiksuar per kohezgjatjen e saj;

b) Shoqeria nuk ka realizuar objektin e saj;

c) vendos Mbledhja e Jashrtezakonshme e Ortakeve.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht;

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Kryetar i propozon :

t) Neni 21 i statutit te ndryshoje si vijon:

Neni 21

Likuidimi

Likuidimi i shoqerise do te behet ne perputhje me legjilacion shqiptar ne fuqi ne kohen e likuidimit.

Asambleja e Jashtezakonshme do te percaktoje termat teknike te likuidimit dhe do te emerroje nje ose me shume likuidatore, dhe do te percaktoje kompoetencat dhe shperblimet e tyre.

Pas nje diskutimi te gjate, asambleja e ortakeve vendosi unanimisht:

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Me propozim te Kryetarit, nje kopje e stautit me ndryshimet e bera do te bashkengjitet ne Aneksin " A ".

- Duke kaluar ne piken 3 te rendit te dites, Kryetari propozon qe te emrohen Drejtoret dhe Drejtoret alternative si me poshte:

Dato' Amin Shah Bin Omar Shah lindur ne Malezi .

Azhar Shah Bin Omar Shah lindur ne Malezi me 30.3.1963

Hamdan Bin Aku Bakar lindur ne Malezi me .

Thanggaya A/L Munusamy lindur ne Malezi, me 13.10.1950

Antonio Napoleone , lindur ne Italy me 10.1.1950

Luciano Del Prato,lindur ne Itali me 24.3.1948

Drejtoret Alternative

Azlan Shah Bin Omar shahur ne Malezi

dhe

Dato' Shah Amin Bin Shah emerohet Kryetar i Bordit te Drejtoreve

Pas nje diskutimi te gjate Asambleja vendosi unanimisht

TE APROVOHET:

Propozimi i mesiperm siç eshte formuluar nga Kryetari.

Duke kaluar ne piken e katert te rendit te dites, Kryetari propozon Revizoret dhe Revizoret alternative si me poshte:

Aritin Abdul Majid lindur ne Malezi.
Mohd Rizal Abdul Malik lindur ne Malezi.
Giovani Del Bianco lindur ne Itali me 19.2.1943

Revizoret Alternative:
Kamil Majid lindur ne Malezi.
Aldo Gnoli lindur ne Itali me 19.2.1943

Duke mos patur gje tjeter per te diskutuar mbledhja u mbyll me _____.

KRYETARI

SEKRETARI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

Nr.....Rep

1257

V E R T E T I M

Sot, me date 29.1.1997 (netedhjete e shtate), ditën e Merkure, para meje, Noteres se Dhomes se Notereve ne Tirane, Shpresa Kurti, me seli ne Rrugen e Durresit, mu paraqiten:

1. Shoqeria Di Vincenzo Estero S.r.l, shoqeri e se drejtes Italiane, me qender ne Via Aterno, No. 78, S.Giovani Teatino (CH), Itali, perfaqesuar nga Z. Antonio Napoleone ne baze te vendimit te ortakeve te " Di Vincenzo Estero " s.r.l, me no. pasaporte : 232962 K
2. Shoqeria Penang Shipbuilding & Construction, shoqeri e se drejtes Maleziane, me qender ne Ming Building, kati i 11-te, Jalan Bukit Nanas, 50250 Kuala Lumpur, Malezi, perfaqesuar nga Z. Thangaya A/L Munusamy, ne baze te vendimit te drejtorise se kesaj shoqerie ne baze te Nenit 98 te Stautit te kesaj shoqerie, me no. pasaporte : A. 7392013. Te Jartpermendurit jane madhore e me zotesi te plote juridike, te cilet me deklaruan ne prani te perkthyeses Enyal Shuke, se sa me siper eshte Vendim i Asmblese se Jashtezakonshme te Ortakeve redaktuar jashte kesaj zyre, ne gjuhen angleze, dhe i nenshkruar perpara noteres.
Une noterja e vertetoj ate rregullisht.

Perkthyes

Notere

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES

Nr...*1486*..Rep
Nr.....*Kol*




V E R T E T I M

Vertetohet firma e perkthyeses Enyal Shuke, banuese ne Tirane, e njohur prej meje personalisht, e cila perktheu dokumentin sa me siper njelloj me origjinalin nga Anglishtja ne Shqip, dhe nenshkroi para meje rregullisht.

Tirane, me *18.02*.....1997

NOTERE

Enyal Shuke
KURTI
NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqëria " INER " Shpk



V E N D I M

I

ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "INER" SHPK

Sot më datë 15. 7. 2006, në Selinë e Shoqërisë "INER" Shpk, të ndodhur në adresën : Rruga "Perlat Rexhepi", Pallati 2+13 Kate, Kati 2, Tiranë, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të kësaj Shoqërie.

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "INER" Shpk, e mbledhur rregullisht për të vendosur me pjesëmarrjen e dy të tretave të ortakëve të shoqërisë të cilët janë vetë prezent, pasi dëgjuan relatimin e Adiministratorit Ligjor të Shoqërisë Z. Genc Dulaku, dhe shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim,

V E N D O S I :

- Pjesëmarrjen në mbledhjen e Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "EDIL AL-IT" Shpk.
- Emërimi i Z. Genc Dulaku, për të përfaqësuar Shoqërinë "INER" Shpk, në Mbledhjen e Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "EDIL AL-IT" Shpk, për çështjet e mëposhtme.
- Të lejojë Shoqërinë "Edil Al It" Shpk, të blerjë 100% (Njëqindpërqind) pjesëve të kapitalit themeltar ose 100%(nëqind përqind) kuotave, të Shoqërisë "Di Vincezo Estero Albania" shpk, kundrejt çmimit prej prej € 997,230/00(nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë Euro, prej Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie, Shoqërisë "New Paradise International" S.R.L.
- Të lejojë Shoqërinë "Edil Al It" Shpk, që me blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë të likujdojë borxhin që Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka kundrejt Shoqërisë "New Paradise International" SRL, të barabartë me një shumë prej € 1.002.770/00(një milion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë euro), e regjistruar kjo në llogarinë e të dyja shoqërive, sipas deklaratës noteriale të datës 02.10.2000.
- Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në kolonën e regjistrimit tregtar.

Shoqëria "INER" SHPK
Ortakët e Shoqërisë

Adrian DULAKU

Artan DULAKU

Genc DULAKU

RIEpublika e Shqipërisë
Dhoma e Noterisë Tiranë

Nr. 7642, REP.

Nr. 1273, Kol.

V È R T E T I M

Sot, më datë 15 Korrik 2006 (dymijë e gjashtë), përpara meje **Ruko SAKO**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Rrugën e "Durrësit", u paraqit personalisht :

1. **Z. ADRIAN DULAKU**, shtetas shqiptar, lindur me 05. 02. 1960, në Tiranë, Shqipëri, banues në adresën : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, mbajtes i pasaportes me **Nr.Z0031648**,

2. **Z. ARTAN DULAKU**, shtetas shqiptar, lindur me 30. 05. 1965, në Tiranë, Shqipëri, banues në adresën : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr.24/4, Tiranë, mbajtes i pasaportes me **Nr.Z.0031648**.

3. **Z. GENC DULAKU**, shtetas shqiptar, lindur me 19. 12. 1967, në Tiranë, Shqipëri, banues në adresën : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr.24/4, Tiranë, mbajtes i pasaportes me **Nr.Z0600471**,

të cilët më deklaruan se sa më sipër këtij vërtetimi është një Vendim i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "INER" Shpk, dhe unë, Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE
Ruko SAKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqëria "EDIL AL IT" Sh P K



V E N D I M

I

ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "EDIL AL IT" SH P K

Sot më datë ~~15.07~~ 2006, në Selinë e Shoqërisë "EDIL AL-IT" Shpk, të ndodhur në adresën : Rruga "Perlat Rexhepi", Pallati 2+13 Kate, Kati 2, Tiranë, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie.

Ortaku i Vetëm, Shoqëria "Iner" Shpk, e cila zotëron 100 % të kuotave të Shoqërisë "Edil Al-It" Shpk, nëpërmjet Vendimit të datës 15.07.2006, të Asamblesë së Ortakëve të kësaj Shoqërie, nënshkrimet e të cilëve janë vërtetuar prej Noteres Ruko Sako, me Vërtetimin Noterial Nr. Rep.7842 dhe Nr. 1273, datë 15. 07.2006, ka vendosur pjesëmarrjen e Ortakut të Vetëm, në mbledhjen e Asamblesë së Shoqërisë "Edil Al-It" shpk, duke emëruar Z. Genc Dulaku, për të përfaqësuar Shoqërinë "Iner" Shpk, në mbledhjen e ortakut të vetëm, për të shqyrtuar dhe vendosur mbi çështjet e parashikuara në vendimin e përshkruar më sipër.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Edil Al-It" Shpk, Shoqëria "Iner" Shpk, i cili zotëron 100 % të kuotave të kësaj shoqërie, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i posaçëm Z. Genc Dulaku, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim,

V E N D O S I :

- Blerjen e 100% (Njëqindpërqind) pjesëve të kapitalit themeltar ose 100%(nëqind përqind) kuotave, të Shoqërisë "Di Vincezo Estero Albania" shpk, kundrejt çmimit prej prej € 997,230/00(nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë Euro, prej Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie, Shoqërisë "Neë Paradise International" S.R.L.
- Me blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë të likujdojë borxhin që Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka kundrejt Shoqërisë "Neë Paradise International" SRL, të barabartë me një shumë prej € 1.002.770/00(një milion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë euro), e regjistruar kjo në llogarinë e të dyja shoqërive, sipas deklaratës noteriale të datës 02.10.2000.

- Të autorizojë Administratorin Ligjor të Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, Z. Genc Dulaku, për të nënshkruar para noterit kontratën e Shitblerjes, së Kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, të marrë pjesë dhe të nënshkruajë vendimin e Asamblesë së kësaj shoqërie si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi.
- Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në kolonën e regjistrimit tregtar.

**Shoqëria "EDIL AL-IT" SHPK
ORTAKU I VETËM
Shoqëria "INER" SHPK
Përfaqësuar nga :
Genc DULAKU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 7843, REP.
Nr. 1274, Kol.

V È R T E T I M

Sot, më datë 15, Korrik 2006(dymijë e gjashtë), përpara meje **Ruko SAKO**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Rugën e "Durrësit", u paraqit personalisht :

Z. GENC DULAKU, shtetas shqiptar, lindur me 19. 12. 1967, ne Tirane, Shqipëri, banues ne adresen : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr.24/4, Tirane, mbajtes i pasaportes me **Nr.Z0600471**,

i cili më deklaroi se sa më sipër këtij vërtetimi është një Vendim i Ortakut të Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, dhe unë, Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE
Ruko SAKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqëria "EDIL AL IT" Sh P K



V E N D I M

I

ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "EDIL AL IT" SH P K

Sot më datë 15.07 2006, në Selinë e Shoqërisë "EDIL AL-IT" Shpk, të ndodhur në adresën :
Rruga "Perlat Rexhepi", Pallati 2+13 Kate, Kati 2, Tiranë, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm
të kësaj Shoqërie.

Ortaku i Vetëm, Shoqëria "Iner" Shpk, e cila zotëron 100 % të kuotave të Shoqërisë "Edil Al-It"
Shpk, nëpërmjet Vendimit të datës 15.07.2006, të Asamblesë së Ortakëve të kësaj Shoqërie,
nënshrimet e të cilëve janë vërtetuar prej Noteres Ruko Sako, me Vërtetimin Noterial Nr.
Rep.7842 dhe Nr. 1273, datë 15. 07.2006, ka vendosur pjesëmarrjen e Ortakut të Vetëm, në
mbledhjen e Asamblesë së Shoqërisë "Edil Al-It" shpk, duke emëruar Z. Genc Dulaku, për të
përfaqësuar Shoqërinë "Iner" Shpk, në mbledhjen e ortakut të vetëm, për të shqyrtuar dhe
vendosur mbi çështjet e parashikuara në vendimin e përshkruar më sipër.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Edil Al-It" Shpk, Shoqëria "Iner" Shpk, i cili zotëron 100 % të
kuotave të kësaj shoqërie, i përfaqësuar nga përfaqësuesi i posaçëm Z. Genc Dulaku, pasi
shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim,

V E N D O S I :

- Blerjen e 100% (Njëqindpërqind) pjesëve të kapitalit themeltar ose 100%(nëqind përqind)
kuotave, të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" shpk, kundrejt çmimit prej prej €
997,230/00(nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë Euro, prej Ortakut të
Vetëm të kësaj shoqërie, Shoqërisë "Neë Paradise International" S.R.L.
- Me blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë të likujdojë borxhin që Shoqëria "Di
Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka kundrejt Shoqërisë "Neë Paradise International" SRL, të
barabartë me një shumë prej € 1.002.770/00(njëmilion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë
euro), e regjistruar kjo në llogarinë e të dyja shoqërive, sipas deklaratës noteriale të datës
02.10.2000.

- Të autorizojë Administratorin Ligjor të Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, Z. Genc Dulaku, për të nënshkruar para noterit kontratën e Shitblerjes, së Kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, të marrë pjesë dhe të nënshkruajë vendimin e Asamblesë së kësaj shoqërie si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi.

- Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në kolonën e regjistrimit tregtar.

**Shoqëria "EDIL AL-IT" SHPK
ORTAKU I VETËM
Shoqëria "INER" SHPK
Përfaqësuar nga :
Genc DULAKU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 7843, REP.
Nr. 1274, Kol.

V È R T E T I M

Sot, më datë 15, Korrik 2006(dymijë e gjashtë), përpara meje **Ruko SAKO**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Rrugën e "Durrësit", u paraqit personalisht :

Z. GENC DULAKU, shtetas shqiptar, lindur me 19. 12. 1967, ne Tirane, Shqipëri, banues ne adresen : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr.24/4, Tirane, mbajtes i pasaportes me **Nr.Z0600471**,

i cili më deklaroi se sa më sipër këtij vërtetimi është një Vendim i Ortakut të Shoqërisë "Edil Al It" Shpk, dhe unë, Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE
Ruko SAKO



KËRKESË

3. A. Leca
08.11.2006
 08 NENDOR 2006

KËRKUESI :

Z. Adrian DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikes i datelindjes 05, Shkurt 1960, lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. **Z0751963**, në cilësinë e Administratorit Ligjor të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" SH.P.K.

OBJEKTI :

Depozitimin e Vendimit të datës 21.07.2006, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit me Nr.Rep.8039, dhe Nr.Kol.1306, datë 21.07.2006, si dhe të dokumentave të tjera të Shoqërisë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE :

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

D R E J T U A R : GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË SEKSIONIT TREGTAR

Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, është regjistruar si person juridik me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Nr 13264, datë 10.01.1996. Kjo shoqëri ka selinë e saj në adresën : bulevardi "Bajram Curri", godina "European Trade Center", prapa Piramidës, Tiranë. Shoqëria ka një Ortak të Vetëm, Shoqërinë "New Paradise International" SRL, person juridik i së drejtës italiane, e cila zotëron 100%(njëqind përqind) të kuotave në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie, dhe aktualisht drejtohet prej Administratorit Ligjor Z. Adrian Dulaku.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, Shoqëria "New Paradise International" SRL, e cila zotëron 100%(njëqindpërqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin themeltar të saj, për arsye objektive ka vendosur të largohet prej Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, dhe nëpërmjet Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, të datës 07, Korrik 2006, nënshkrimet e të cilëve janë vërtetuar me Vërtetimin noterial Nr. 169975 repertori, datë 17.07.2006, të Noterit Giuseppe Fietta, Vicenza Itali, kanë vendosur të autorizojë Z.Giovanni Panni, për të vepruar në interes dhe për llogari të Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l., për të realizuar transferimin me anë të shitjes, të 100%(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar ose 100(njëqind) të kuotave të shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" shpk, me çmimin në Euro 997.230/0(Nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë) së bashku me borxhin e mbartuar me një vlerë prej Euro 1.002.770/0(Një milion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) pra me një vlerë totale prej Euro 2.000.000/0(dymilion) në shoqërinë e të drejtës shqiptare, "Edil Al-It" shpk.

Vërtetimi dt 03.11.06
dt 13.11.06
Mirrored
08.11.06
08.11.06

Levendur Shkruar nënotosh Nr8039 Rep, Nr1306 Kol dt 21.07.06
Transferimi i shog "New Paradise" nga an. Drejtese (Ital)
Vend i Ortakut të Edil Alit,
Vend i Asamblesë së Ortakëve dt 07.07.06
Vend i shog New Paradise
Akt- themeltar, dt 21.07.06
Vend i Asamblesë së Ortakëve
Vend i shog "Iner"

2. Shitja e borxhit që Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka ndaj Shoqërisë "New Paradise International" S.r.l, me një vlerë prej Euro 1.002.770/0(Njëmilion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë).

Me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, me Rep.8039, dhe Nr. Kol.1306, datë 21.07.2006, të hartuar dhe nënshkruar para Noteres Ruko Sako, të Dhomës së Noterisë Tiranë, është bërë shitja e 100%(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar ose 100(njëqind) kuotave, që Shoqëria "New Paradise International" S.r.l. zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" shpk, në favor të blerësit Shoqërisë Edil Al-It:Shpk, kundrejt çmimit në total prej Euro 997,230/00(nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatëdhjetë e dyqind e tridhjetë), si dhe borxhin që Shoqëria "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, ka ndaj Shoqërisë "New Paradise International" Shpk, me një çmim total në shumën prej Euro 1.002.770/00 (një milion e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë), vlera të cilat tashmë është likuajduar totalisht nga blerësi në shumën totale të tij, prej Euro 2,000,000/0(dymilion), nëpërmjet Raiffeisen Bank, e vërtetuar kjo, ashtu sikurse është parashikuar edhe në kontratës, nëpërmjet konfirmës bankare, e datës 03.11.2006, një kopje e së cilës do t' i bashkëlidhet kësaj kërkesë.

Pas transferimit të kuotave nëpërmjet kontratës së shitjes dhe likujdimimit të çmimit dhe të borxhit, Ortak i Vetëm i Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk, do të jetë :

Shoqëria "Edil Al-It" shpk, e cila bëhet Ortake e Vetme, me 10 0(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar ose 100%(njëqindpërqind), të kuotave të Shoqërisë "Di Vincenzo Estero Albania" Shpk.

Shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

